

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Integriteti  
dhe  
Korrupsioni  
Policor në Shqipëri



Kingdom of the Netherlands



*Shënim: Ky studim u realizua në kuadër të Projektit “Forcimi i integritetit policor në Shqipëri” i cili u mbështet nga një grant i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës në kuadër të Programit Matra për shoqërinë civile. Objektivat, zbatimi i plotë dhe rezultatet e këtij projekti janë përgjegjësi e organizatës zbatuese – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Çdo qëndrim apo opinion i shprehur në këtë projekt është i organizatës zbatuese dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë holandeze.*

## STUDIUES KRYESOR

Arjan Dyrmishi

## GRUPI I STUDIUESVE

Elona Dhëmbo

Gjergji Vurmo

Besjana Kuci

## KËSHILLTAR I PROJEKTIT

Sotiraq Hroni - IDM

Berti Koxha – Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

IDM, Tiranë 2014

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim i shpreh mirënjohjen Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm dhe të hapur lidhur me zbatimin e këtij Projekti dhe realizimin e objektivave të tij.

ISBN: 978-9928-4123-4-8

# Përmbajtja

Parathënie.....	7
Lista e shkurtimeve.....	8
1. Përmbledhje.....	9
2. Hyrje.....	14
3. Metodologjia e studimit.....	15
3.1. Metodologjia e anketimit me qytetarët.....	16
3.2. Metodologjia e anketimit me punonjës së PSH.....	16
3.3. Analiza cilësore.....	16
3.4. Intervista me skenarë hipotetikë.....	17
4. Korrupsioni policor.....	18
4.1. Ç’është korrupsioni.....	18
4.2. Korrupsioni policor dhe llojet e tij.....	21
4.3. Korrupsioni, devijimi dhe keqsjellja.....	26
4.4. Integriteti policor dhe korrupsioni.....	31
5. Korrupsioni policor në Shqipëri.....	32
5.1. Korrupsioni si fenomen i përgjithshëm.....	32
5.2. Llojet e korrupsionit.....	36
5.3. Korrupsioni policor në Shqipëri.....	38
6. Vlerësim i literaturës mbi faktorët e korrupsionit Policor.....	41
6.1. Kombinimi i faktorëve PESTL.....	42
6.2. Kombinimin i influencave strukturore dhe atyre kulturore.....	42
6.3. Kombinimi i faktorëve konstantë dhe të ndryshueshëm.....	43
6.4. Kombinimi i faktorëve individualë, organizativë, dhe shoqërorë.....	46
6.5. Faktorë të tjerë.....	51
7. Vlerësim i kuadrit antikorrupsion për PSH në Shqipëri.....	52
7.1. Vlerësimi i kornizës së politikave antikorrupsion.....	52
7.1.a. Strategjia Kombëtare 2008-2013.....	52
7.1.b. Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013.....	55

4	<b>Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri</b>	
	7.1.c. Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit 2009-2014.....	56
	7.2. Kuadri Ligjor.....	59
	7.3. Kuadri institucional.....	63
	7.4. Rezultatet në luftën kundër korrupsionit.....	56
8.	Përhapja dhe llojet e korrupsionit policor në Shqipëri.....	72
8.1.	Shkalla e përhapjes së korrupsionit.....	72
8.1.a.	Shkalla e përhapjes së korrupsionit sipas publikut .....	73
8.1.b.	Shkalla e përhapjes së korrupsionit sipas punonjësve të policisë.....	75
8.2.	Llojet e korrupsionit.....	76
8.2.a.	Raportet zyrtare dhe të medias.....	76
	8.2.b. Perceptimi i publikut.....	77
	8.2.c. Perceptimi i punonjësve të PSH.....	79
9.	Shkaqet e korrupsionit policor në Shqipëri.....	82
9.1.	Perceptimet e publikut .....	82
9.2.	Perceptimet e punonjësve të policisë.....	84
9.2.a.	Mjedisi i gjerë .....	84
9.2.b.	Faktorët organizative.....	86
9.2.c.	Besimi tek sistemi antikorrupsion.....	89
10.	Integriteti policor dhe korrupsioni .....	91
10.1.	Vlerësimi për shkallën e seriozitetit të sjelljes.....	94
10.2.	Mbështetja për masat disiplinore .....	95
10.3.	Gatishmëria për të raportuar shkeljet.....	96
10.4.	Përputhshmëria me politikën zyrtare .....	98
11.	Përfundime dhe rekomandime.....	100
	11.1. Përfundime.....	100
	11.2. Rekomandime për reformën.....	101
12.	SHTOJCA	
	12.1. Shtojca 1 - Raport i detajuar i gjetjeve të anketimit me publikun .....	105
	12.1.1 Përshkrimi i kampionit.....	105
	12.1.2 Njohja e organizatave policore dhe korrupsioni tek to .....	107
	12.1.3 Informimi dhe perceptimet mbi korrupsionin.....	109

12.1.4 Eksperiencat me korrupsionin.....	114
12.1.5 Llojet dhe shkalla e korrupsionit.....	117
12.1.6 Shkaqet e jashtme të korrupsionit.....	119
12.1.7 Shkaqet e brendshme të korrupsionit.....	121
12.1.9 Toleranca ndaj korrupsionit .....	122
12.1.10 Besimi për të luftuar korrupsionin .....	124
12.1.11 Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave antikorrupsion.....	127
12.2. Shtojca 2 - Raport i detajuar i gjetjeve të anketimit me punonjësit e PSH.....	130
12.2.1 Përshkrimi i kampionit.....	130
12.2.2 Njohja e organizatave policore dhe korrupsioni tek to .....	133
12.2.3 Eksperiencat mbi korrupsionin .....	140
12.2.4 Llojet dhe shkalla e korrupsionit.....	142
12.2.5 Shkaqet e jashtme të korrupsionit.....	144
12.2.6 Shkaqet e brendshme të korrupsionit.....	145
12.2.7 Toleranca ndaj korrupsionit .....	148
12.2.8 Besimi për të luftuar korrupsionin .....	150
12.2.9 Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe të politikave antikorrupsion.....	153
12.3 Shtojca 3 – Analizë krahasimore e gjetjeve të anketimit me publikun dhe punonjës të PSH..	156
12.3.1 Perceptimi mbi korrupsionin dhe organizatat policore.....	156
12.3.2 Eksperiencat mbi korrupsionin .....	161
12.3.3 Llojet e korrupsionit në PSH – Rryshfeti.....	163
12.3.4 Shkaqet e jashtme & të brendshme të korrupsionit .....	164
12.3.5 Toleranca ndaj korrupsionit & besimi në luftën antikorrupsion .....	166
12.3.6 Përshtatshmëria dhe zbatueshmëria e kuadrit ligjor/politikave antikorrupsion ....	169
12.4 Shtojca 4 - Pyetëtori i anketimit me publikun .....	172
12.5 Shtojca 5 - Pyetëtori i anketimit me punonjës të PSH.....	188
12.6 Shtojca 6– Intervistat me punonjës të PSH bazuar në skenarë hipotetikë .....	203
12.6.1 Tabela e skenarëve .....	203
12.6.2 Tabela e përgjigjeve .....	205
Bibliografia .....	206



## Parathënie

---

Organizatave policore përbëjnë një paradoks unik në demokracitë moderne. Ato janë garantuesit e sigurisë dhe mbrojtës të lirive themelore. Në të njëjtën kohë, ato janë edhe një kërcënim i madh pikërisht ndaj këtyre lirive themelore. Nuk ka ndofta asnjë nëpunës të shtetit që të ketë kaq shumë përgjegjësi dhe nevojë për kaq shumë besim të publikut. Policisë i duhet të ushtrojë një sërë kompetencash ligjore, përfshirë këtu përdorimin e forcës vdekjeprurëse, me qëllim mbrojtjen e qytetarëve dhe sigurimin e rendit publik dhe ligjit. Në të njëjtën kohë, policia duhet të veprojë duke respektuar plotësisht ligjet në fuqi, liritë themelore dhe të drejtat e njeriut. Shkalla në të cilën policia ruan baraspeshën gjatë punës së saj është një tregues i njohur i demokracisë së vërtetë për shoqërinë e sotme. Treguesi i demokracisë së vërtetë shpesh matet me nivelin e besimit të publikut tek policia.

Botimi i këtij raporti kërkimor të realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) është mjaft i mirëpritur dhe vjen në kohën e duhur si mjet për matjen e besimit të publikut tek policia shqiptare dhe për evidentimin e forcës së demokracisë në vend. Në këtë raport jepen të dhëna të bollshme për të kuptuar më mirë dhe me më shumë hollësi perceptimet e publiku për policinë sesa ç'mund të mendohej në të kaluarën e historisë së Shqipërisë. Të dhënat e këtij botimi do të shërbejnë si bazë mjaft e nevojshme faktike për të ushqyer debatin mbi integritetin mes radhëve të policisë shqiptare dhe për të informuar në lidhje me reformën dhe ristrukturimin e policisë. Informacioni i IDM-së do t'i japë shtysë rishikimit të Kodit të Etikës dhe dëshirës në rritje të qeverisë shqiptare për të çrrënjësuar korrupsionin policor me anë të zbatimit pa kompromis të parimeve morale dhe të etikës.

Dr. Frank Harris,

Departamenti i Drejtësisë Penale

Këshilltar për Përgjegjshmërinë e Policisë, Ministria e Brendshme

ICITAP, Shqipëri

## Lista e shkurtimeve

---

BE	Bashkimi Evropian
DSP	Drejtoria e Standardeve Profesionale
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IDRA	Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi
ILKDP	Inspektorati Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive
KiE	Këshilli i Evropës
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MB	Ministria e Brendshme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Aleancës së Atlantikut Verior
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PSH	Policia e Shtetit
SHKB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar



# 1. Përmbledhje

Ky botim trajton korrupsionin në Policinë e Shtetit në Shqipëri dhe nevojën e forcimit të integritetit të institucionit të policisë si mjet për të ulur korrupsionin. Gjatë viteve të tranzicionit korrupsioni është shfaqur si një ndër problemet kryesore të qeverisjes në Shqipëri dhe të dhënat tregojnë se vazhdon të mbetet i lartë dhe i përhapur.

Masat e ndërmarra gjatë dekadës së fundit për të trajtuar këtë problem nëpërmjet reformave të vazhdueshme dhe miratimit apo rishikimit të legjislacionit për konfliktin e interesit, kufizimin e imunitetit për politikanët dhe gjyqësorin, apo për të rregulluar më mirë financimin e partive politike nuk kanë pasur ndonjë efekt të qëndrueshëm, çka tregon se korrupsioni është shfaqur rezistent ndaj masave të ndërmarra.

Në këtë mjedis me korrupsion të përhapur policia ka qenë ndër institucionet më të ekspozuara ndaj këtij rreziku, për vetë faktin se policia është një ndër institucionet kryesore ligjzbatuese për hetimin e korrupsionit. Në këtë kontekst, korrupsioni policor ka përbërë edhe një ndër shkaqet për korrupsionin e përhapur edhe në sektorë të tjerë.

Ashtu si edhe në sektorë të tjerë, korrupsioni policor në Shqipëri ka qenë i përhapur dhe policia perceptohet nga publiku si ndër institucionet me korrupsionin më të lartë në vend. Edhe pse janë bërë përpjekje për ta trajtuar korrupsionin në polici, kryesisht nëpërmjet ndryshimeve të legjislacionit dhe shtimit të kapaciteteve institucionale, rezultatet tregojnë për një qëndrueshmëri të korrupsionit policor.

Përkundrajt këtij konteksti, ky botim synon të sjellë në vëmendjen e politikbërësve, drejtuesve e punonjësve të policisë, aktorëve të tjerë shoqërorë dhe publikut të gjerë problemin e korrupsionit policor si dhe rëndësinë e veçantë që ka lufta kundër korrupsionit policor. Qëllimi kryesor është që të kontribuojë në përmirësimin e masave antikorrupsion nëpërmjet njohjes sa më të thellë të korrupsionit policor dhe faktorëve që e nxisin apo që e frenojnë atë.

Në radhë të parë studimi ndalet trajtimin e korrupsionit policor si një fenomen specifik duke theksuar nevojën për hartimin e masave antikorrupsion në përputhje me specifikën që e karakterizon.

Për këtë arsye studimi është përqendruar në vlerësimin e (1) nivelit dhe formave të korrupsionit policor, (2) të faktorëve që ndikojnë në nxitjen e korrupsionit policor, dhe (3) të përshtatshmërisë, efikasitetit, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë e masave antikorrupsion.

Deri më sot korrupsioni policor është identifikuar kryesisht me rryshfetin edhe pse format e korrupsionit policor janë të shumëllojta. Në këtë aspekt ky studim synon të trajtojë problemin e korrupsionit policor përtej kuptimit të tij vetëm si marrje rryshfeti duke identifikuar dhe forma të tjera të korrupsionit si dhe duke bërë ndarjen ndërmjet korrupsionit policor dhe keqsjelljes policore. Po kështu, pak rëndësi i është kushtuar faktorëve që nxisin korrupsionin çka ka bërë që korrupsioni policor të shihet si devijim i punonjësve të veçantë të policisë apo thjesht i ndikuar nga boshllëku ligjor ndërkohë që studimi hedh dritë mbi një sërë shkaqesh të natyrës politike, ekonomike, shoqërore dhe të kulturës organizative.

Studimi i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edhe vlerësimit të kuadrit dhe masave antikorrupsion që janë zbatuar dhe po zbatohen në polici. Megjithatë, studimi nuk ka marrë parasysh ndryshimet më të fundit në legjislacionin e policisë.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet forcimit të integritetit policor i cili konceptohet si prirja për të rezistuar tundimeve për abuzim me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni. Nëpërmjet futjes së këtij koncepti synohet nxitja e ndryshimit të qasjes ndaj korrupsionit policor i cili më së shumti është trajtuar si një fenomen që shkaktohet nga sjellja individuale e një numri të kufizuar punonjësish të policisë të patrajnuar ose me prirje për të shkelur rregullat sesa një problem i organizatës së policisë.

Duke pasur parasysh vështirësinë e matjes së përhapjes së korrupsionit ashtu edhe shkaqeve të tij) studimi është përpjekur ta minimizojë këtë vështirësi duke përdorur një sërë instrumentesh metodike. Përveç analizës së literaturës mbi korrupsionin policor, kuadrit ligjor dhe nënligjor, raporteve të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, studimi bazohet në të dhëna të marra nga anketa me publikun dhe me punonjës të policisë si dhe në intervista të thelluara me punonjës të policisë dhe aktorë të tjerë institucionalë dhe shoqërorë. Vlerësimi i politikave dhe masave antikorrupsion është bërë në bazë të përshtatshmërisë, efikasitetit, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë. Përzgjedhja e kësaj qasje lidhet me premisën se efektiviteti e politikave dhe masave antikorrupsion në Shqipëri ka qenë i ulët dhe korrupsioni jo vetëm që nuk është frenuar por ka ardhur duke u rritur, edhe pse lufta kundër korrupsionit është shpallur si prioritet kryesor i qeverive shqiptare për mbi një dekadë.

Këtë e konfirmon edhe Barometri Botëror i Korrupsionit të Transparency International i vitit 2013, sipas të cilit 66% e qytetarëve shqiptarë besojnë se korrupsioni është shtuar (40% besojnë se është shtuar shumë dhe 26% besojnë se është shtuar pak) ndërsa vetëm 24% e qytetarëve mendojnë se veprimet e qeverisë në luftën kundër korrupsionit kanë qenë të efektshme.

Gjetjet tregojnë se korrupsioni policor është i lartë dhe i përhapur. Edhe pse të pjesshme dhe pa fokus të veçantë mbi policinë, sondazhet dhe studimet e ndryshme mbi korrupsionin dhe integritetin e institucioneve të kryera kryesisht që nga fillimi i viteve 2000 tregojnë nivele të larta të korrupsionit në këtë sektor. Në disa segmente të policisë siç janë shërbimi i qarkullimit rrugor, shërbimi i policisë kufitare dhe migracionit dhe shërbimi policor i antikrimin, korrupsioni rezulton të jetë më i përhapur sesa në të tjerë.

Korrupsioni në polici nuk kufizohet vetëm tek përfitimi financiar, por edhe tek forma të tjera si dhënia dhe marrja e favoreve, përfitimet nga mjetet dhe buri-  
met e policisë, manipulimi i provave, përdorimi i tepruar të forcës, etj. Shkalla e përhapjes së korrupsionit në radhët e policisë nuk duket se ndikohet nga grada dhe nivelet brenda shërbimit policor, çka ndikon edhe në format e korrupsionit, të cilat janë të shumëllojta.

Përsa i përket shkaqeve, korrupsioni policor lidhet në radhë të parë me kontekstin politiko-shoqëror dhe kryesisht me tranzicionin nga regjimi komunist.

Gjatë viteve të tranzicionit, gërshetimi i problemeve politike, ekonomike dhe sociale me boshllëkun institucional dhe ligjor bënë që korrupsioni të merrte përmasa galopante në të gjitha nivelet. Boshllëku moral dhe pasiguritë njerëzore kontribuan në identifikimin e korrupsionit si një fenomen normal të shoqërisë kapitaliste dhe shpesh të pranuar si legjitim.

Mostrajtimi i efektshëm i korrupsionit në vite ka bërë që ai të marrë përmasa sistemi duke shpënë në kapjen e vetë institucioneve shtetërore. Kjo ka pasur pasojë të rënda mbi policinë e cila është përdor shpesh për të mbështetur aktivitete të paligjshme si thyerja e embargos së Kombeve të Bashkuara ndaj ish Jugosllavisë, pjesëmarrja në manipulimin e proceseve zgjedhore, luajtja e rolit të lehtësuesit të trafiqeve të ndryshme si drogës dhe qenieve njerëzore por dhe të mallrave të ligjshme për të shmangur detyrimet doganore.

Së dyti, korrupsioni policor lidhet me boshllëkun ligjor dhe institucional të trashëguar nga regjimi komunist, i cili nuk e pranonte korrupsionin si fenomen

shoqëror, por e trajtonte atë me mjete ideologjike. Me dobësimin e regjimit komunist dhe të forcës ideologjike të sistemit që në vitet 1980 u vu re edhe vakuumi i krijuar nga mungesa e qasjes institucionale. Reformat e menjëhershme në fillim të viteve 1990 për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional nuk u zbatuan dhe korrupsioni policor ngeli pothuaj i patrajtuar deri në fillim të viteve 2000 duke ndikuar thellësisht qasjen ndaj korrupsionit në vitet e mëvonshme.

Së treti, korrupsioni policor lidhet me veçoritë që kanë shërbimet policore dhe me kulturën e tyre organizative. Liria e veprimit e punonjësve të policisë në ushtrimin e funksionit të tyre, organizimi pothuaj ushtarak dhe sekreti, kultura e heshtjes dhe e solidaritetit ndërmjet kolegëve për të mos denoncuar aktet e veprimet e njëritjetrit përbëjnë vetëm disa nga këta faktorë. Këto veçori organizative, të kombinuara edhe me faktorët e sipërpërmendur si dhe me një shkallë relativisht të lartë të tolerimit të korrupsionit në nivel shoqëror, përbëjnë ndër faktorët kryesorë nxitës të korrupsionit në fazën aktuale.

Reformat antikorrupsion në polici kanë rezultuar në përgjithësi të paefektshme. Në radhë të parë, reformat kanë qenë të pjesshme dhe kryesisht të fokusuar në problemet e dukshme të momentit duke mos prodhuar zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme. Reformat kryesisht kanë qenë të natyrës së ndryshimeve ligjore, por u ka munguar reflektimi i dimensionit të mjedisit shoqëror dhe politik.

Sistemi dhe mekanizmat antikorrupsion janë të ndërtuara mbi premisën se shkak i korrupsionit janë punonjës të veçantë të policisë dhe jo rreziqet që vijnë nga mjedisi organizativ dhe mjedisi më i gjerë shoqëror. Për pasojë sistemi antikorrupsion është kryesisht reagues dhe i bazuar mbi hetimin dhe penalizimin e individëve që përshihen në korrupsion, ndërsa masat për forcimin e integritetit policor janë të dobëta. Për shkak të inefektivitetit të masave antikorrupsion integriteti policor është dobësuar dhe kjo përbën premisë për më shumë korrupsion.

Nga ana tjetër, me gjithë fokusin ndaj hetimit dhe ndëshkimit, rezultatet tregojnë për një efektivitet të ulët të tyre. Numri i punonjësve të policisë të hetuar dhe dënuar është i mjaft i ulët dhe pothuajse i pakonsiderueshëm është numri i zyrtarëve të lartë të hetuar për korrupsion. Po kështu, numri i punonjësve të ndëshkuar me masa disiplinore për keqsjellje apo vepra të tjera të dënueshme administrativisht është mjaft i ulët.

Korrupsioni i lartë dhe pandëshkueshmëria kanë çuar në një rënie të besimit të publikut por dhe vetë punonjësve të policisë në sistemin antikorrupsion. Numri i ankesave të publikut ndaj punonjësve të policisë të përfshirë në korrupsion apo

që shkelin rregullat është mjaft i ulët. Po kështu, numri i raportimeve të punonjësve të policisë, të cilët sipas legjislacionit janë të detyruar të raportojnë shkeljet e kolegëve të tyre, është pothuajse i papërfillshëm.

Në këtë kontekst, krijimi i një sistemi antikorrupsion të mirëbalancuar ndërmjet masave parandaluese dhe masave reaguese përbën dhe sfidën kryesore të reformave. Kjo kërkon një përfshirje më të gjerë të aktorëve institucionalë dhe shoqërorë dhe harmonizimin e përpjekjeve të një sërë institucionesh dhe aktorësh si parlamenti, institucionet e pavarura, shoqëria civile dhe qarqet akademike, media dhe publiku i gjerë.

Në mënyrë të veçantë reformat duhet të synojnë një përfshirje më të madhe të publikut dhe një menaxhim më të mirë të pritshmërive të tij për bërë të mundur që publiku të luajë një rol më të madh kundër korrupsionit policor si nëpërmjet mostolerimit të korrupsioni ashtu edhe nëpërmjet denoncimit të vazhdueshëm të akteve korruptive. Po kështu, meqenëse shkalla e lartë e politizimit të policisë përbën një nga rreziqet kryesore të korrupsionit, reformat duhet të synojnë rritjen e pavarësisë drejtuese të policisë.

Ky është publikimi i parë i cili i kushtohet tërësisht korrupsionit policor në Shqipëri dhe si i tillë përbën një bazë të mirë për të kuptuar dhe trajtuar këtë sfidë komplekse. Megjithatë, studimi ka edhe kufizimet e veta që burojnë pikërisht nga boshllëku i mëparshëm në hulumtimin e kësaj fushe dhe vështirësitë e studimit të korrupsionit policor. Sidoqoftë, këto vështirësi minimizohen kur hulumtimet kryhen në mënyrë më sistematike, çka parashtron nevojën për kërkime të mëtejshme në këtë fushë.

## 2. Hyrje

Korrupsioni në Shqipëri është shfaqur si një nga sfidat kryesore shoqërore dhe institucionale. Në një mjedis me korrupsion të lartë policia është një ndër institucionet më të ekspozuara. Siç e tregojnë edhe sondazhet e opinionit publik dhe studimet e ndryshme mbi korrupsionin, të kryera në Shqipëri gjatë 15 viteve të fundit, policia është ndër tre apo katër institucionet më të korruptuara në vend.

Masat antikorrupsion kanë rezultuar të paefektshme duke bërë që shkalla e përhapjes së korrupsionit të qëndrojë pothuaj konstante ose me luhajtje të vogla. Sipas Indeksit të korrupsionit i Transparency International i vitit 2013, korrupsioni policor në Shqipëri ka qëndruar konstant në shkallën 3.7, aq sa ishte në vitin 2007.

Megjithatë, studimet e thelluara mbi korrupsionin policor në Shqipëri kanë munguar. Kjo mangësi ka ndikuar negativisht në luftën ndaj korrupsionit pasi institucionet janë përpjekur të ndërmarrin masa dhe politika antikorrupsion duke u mbështetur kryesisht mbi të dhëna të pakta.

Përkundrajt këtij konteksti ky studim synon të ofrojë një trajtim të thelluar të korrupsionit policor në Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi është që të kontribuojnë në përmirësimin e masave antikorrupsion dhe në diskutimin më të gjerë akademik mbi korrupsionin duke kontribuar në plotësimin e boshllëkun e deritanishëm të studimeve empirike mbi korrupsionin policor në Shqipëri.

Studimi është rezultat i një projekti të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) për të kontribuar në zvogëlimin e korrupsionit dhe në forcimin e integritetit të policisë në Shqipëri. Studimi synon të kryejë një vlerësim korrupsionit në Policinë e Shtetit në Shqipëri duke u fokusuar në shkallën e përhapjes së korrupsionit në policinë shqiptare, në llojet e korrupsionit policor dhe në shkaqet që ndikojnë në nxitjen apo frenimin e korrupsionit policor.

Në radhë të parë studimi ndalet në një rishikim të literaturës ndërkombëtare mbi korrupsionin policor, si dhe të llojeve dhe shkaqeve të tij. Më tej studimi mbështetet në të dhëna empirike për të analizuar shkallën e përhapjes së korrupsionit, llojet e korrupsionit dhe shkaqet që nxisin korrupsionin në Policinë shqiptare.

Studimi mbyllet me një vlerësim të politikave dhe instrumenteve antikorrupsion dhe rreket të japë disa rekomandime për përmirësimin e kuadrit antikorrupsion duke e theksuar nevojën e forcimit të integritetit policor dhe adresimit të korrupsionit duke e trajtuar si problem të organizatës policore dhe jo thjesht si sjellje të punonjësve të korruptuar.

### 3. Metodologjia e studimit

Për eksplorimin e një tematike delikate, siç është ajo e korrupsionit, si dhe për realizimin e një qëllimi kompleks për të kontribuar në përmirësimin e masave antikorruption nëpërmjet njohjes sa më të thellë të korrupsionit policor dhe faktorëve që e nxisin apo që e frenojnë atë, nevojitet një ndërthurje metodash dhe teknikash të kërkimit. Në këtë kontekst, përjasja metodologjike që u përzgjedh dhe u aplikua në kuadër të këtij studimi ishte ajo e trekëndëzimit të të dhënave. Në këtë studim është zbatuar trekëndëzimi metodologjik, trekëndëzimi teorik dhe trekëndëzimi i burimeve të të dhënave. Trekëndëzimi metodologjik ka përfshirë përdorimin e metodave cilësorë (intervista, analizë e dokumentacionit) dhe sasiore (sondazhe dhe statistika) në shtjellimin e të njëjtave pyetje për studimin.

Në këtë studim, trekëndëzimi është përzgjedhur jo vetëm për të bërë të vlefshme gjetjet e studimit, por edhe për të ndihmuar në një analizë më të thelluar dhe më të gjerë të problematikës nën studim.

Në themel të trekëndëzimit të burimeve qëndron avantazhi i një saktësie më të madhe si pasojë e kombinimit të këndvështrimeve të ndryshme gjë që shkon përshtat me synimin tonë për të vlerësuar: (1) nivelet dhe format e korrupsionit policor, (2) faktorët që ndikojnë në nxitjen e korrupsionit policor, dhe (3) përshtatshmërinë, efikasitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e masave antikorruption si në këndvështrimin politik, ekonomik, shoqëror dhe të kulturës organizative. Për interpretimin e gjetjeve të studimit është përdorur trekëndëzimi teorik, ku teori të ndryshme, si dhe diagrama dhe skema interpretuese të përdorura gjerësisht në studime të tjera ndërkombëtare, janë përdorur për të rritur besueshmërinë në analizën që i bëhet të dhënave të këtij studimi.

Burimet e këtij studimi kanë qenë studime të mëparshme mbi korrupsionin policor, kuadri ligjor dhe nënligjor, raporte të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe të dhëna të tjera dytësore, të cilat janë analizuar në fazën e parë të studimit. Gjatë kësaj faze janë vlerësuar politikat dhe masat antikorruption, që janë marrë deri tani duke aplikuar katër kriteret të përcaktuar nga Banka Botërore: përshtatshmërinë, efikasitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.

Më pas studimi ka gjeneruar të dhëna parësore përmes anketimeve me publikun dhe me punonjës të Policisë së Shtetit.

### 3.1. Metodologjia e anketimit me qytetarët

Anketimi me publikun në nivel kombëtar përfshiu rreth 1.100 të anketuar – mbi moshën 18 vjeç ku përbërja gjinore është në raportet 54% meshkuj dhe 46% femra – të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Pyetësi i përdorur për këtë anketim u hartua me 60 pyetje të ndara në 10 seksione dhe synoi të mbledhë të dhëna mbi perceptimet dhe përvojat e drejtpërdrejta të përjetuara në lidhje me korrupsionin në polici. (Shih Shtoja 4)

Masa e kampionit të përzgjedhur ofron një interval besueshmërie prej +/-2.95% brenda një niveli besueshmërie prej 95%. Për analizimin e të dhënave dhe prezantimin e gjetjeve janë përdorur statistikat përshkruese.

### 3.2. Metodologjia e anketimit me punonjës së PSH

I njëjti instrument anketimi (pyetësor) u përshtat për anketimin me punonjës të Policisë së Shtetit i cili përfshiu 370 të intervistuar në nivel kombëtar. Pyetësi i administruar me punonjësit e policisë (shih Shtojca 5) përfshin rreth 44 pyetje të organizuara në 9 seksione. Masa e kampionit të përzgjedhur ofron një interval konfidence prej +/-4.98% brenda një niveli konfidence prej 95%. Për përzgjedhjen e tyre u aplikua metoda rastësore.

Kampioni i përzgjedhur në mënyrë rastësore u dominua nga të anketuar meshkuj (83%). Nga pikëpamja e gradave shumica e pjesëmarrësve në sondazh përbëhej nga Inspektorë (41.7%) dhe kryeinspektorë (26.3%), ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve mbanin gradat drejtues i parë, komisar dhe kryekomisar. Në lidhje me shërbimin brenda policisë, 68.3% e kampionit janë punonjës të shërbimit të sigurisë publike, 14% nga shërbimi kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda dhe 12.6% e të anketuarve nga Policia Kufitare dhe Migracionit, 4.2% nga shërbimet mbështetëse dhe 0.9% nga trajnimi policor.

Të dhënat e krijuara nga ky anketim u analizuan më vete, por u krahasuan edhe me gjetjet e pyetësorit për publikun.

### 3.3. Analiza cilësore

Pas evidentimit të problematikave përmes metodave sasore, u përdorën metodat cilësore për të shqyrtuar më në thellësi perceptimet e punonjësve të policisë në lidhje me korrupsionin, shtetin ligjor dhe marrëdhëniet e policisë me qytetarin. Për këtë qëllim u zhvilluan disa intervista të thelluara, gjysmë të strukturuar,



individuale por edhe në grup (grupe të fokusuara). Gjatë këtyre intervistave u synua që të eksploroheshin në thellësi arsyet që ndikojnë në problematikën e evidentuara përmes sondazheve.

### 3.4. Intervista me skenarë hipotetikë

Krahas këtyre intervistave, me disa punonjës policie u zhvilluan intervista të thelluara. Këto intervistime u bënë përmes skenarëve të caktuar, të cilët synonin eksplorimin e perceptimeve, njohurive dhe praktikave të punonjësve të policisë (Shih Shtojca 5). Në këtë seri intervistash u përfshinë 90 punonjës të Policisë së Shtetit, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, nëpërmjet një kampionimi me kuota, si vijon – 6 komisariatet e kryeqytetit, komisariati i policisë në Kavajë, Drejtoria e Policisë Rrugore dhe Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit.

Qasja me skenarë hipotetikë është përzgjedhur me synimin për të marrë përgjigje sa më të sinqerta dhe për të shmangur rezistencën e mundshme për t’iu përgjigjur pyetjeve mbi raste reale të përfshirjes në korrupsion të vetë punonjësve të policisë apo të kolegëve të tyre. Qasja për ta kryer sondazhin vetëm në qarkun Tiranë lidhet me tre arsye të kryera nga grupi i studiuesve. Së pari, është marrë në konsideratë fakti që Policia e Shtetit është institucion i organizuar vertikalisht dhe me rregulla unike që aplikohen njëtrajtësisht në të gjithë territorin e vendit, kështu që gjetjet e pyetësorit në Tiranë mund të konsiderohen të vlefshme për Policinë e Shtetit në tërësi. Së dyti, Tirana është njësi më e madhe administrative në vend dhe ku punonjësit e policisë kanë më shumë gjasa për t’u ballafaquar me një shumëllojshmëri situatash dhe mundësish për t’u përfshirë në sjellje korruptive. Së treti, nga analiza e të dhënave të sondazheve të kryera me publikun dhe policinë ndryshimet sipas qarqeve kanë qenë të mjaft të vogla, kështu që përfundimet e nxjerra mund të jenë të aplikueshme për Policinë e Shtetit në tërësi. Megjithatë, kjo nuk përjashton rëndësinë e kryerjes së pyetësorit edhe në qytete të tjera në raste të mëvonshme për të parë ndryshime të mundshme dhe për të analizuar shkaqet e ndryshimeve eventuale

Punonjësve të anketuar iu kërkua të japin mendimet e tyre mbi 11 skenarë hipotetikë të keqsjelljes policore ku përfshihen i konflikti i interesit, marrja/pranimi ryshfetit, keqpërdorimi i kompetencave, dhe vjedhja. Në thelb 10 skenarë përshkruajnë situata në të cilat qëllimi për të përfutur ndikon mbi sjelljen e punonjësit të policisë dhe një skenar përfshin përdorimin e forcës. Secilit nga punonjësit e anketuar iu kërkua të vlerësojnë skenarët duke iu përgjigjur shtatë pyetjeve. Gjashtë

nga pyetjet e parashtruara përqendrohen në pasqyrimin e integritetit policor si prirje për t'i rezistuar tundimeve për abuzim me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni.

Nga këto, dy pyetje lidhen me faktin se sa të rëndë e perceptojnë punonjësit e policisë secilin skenar për veten e tyre dhe për punonjësit e tjerë të policisë.

Dy pyetje lidhen me masën disiplinore që punonjësit e policisë mendojnë se do të jepet dhe masën disiplinore që ata mendojnë se duhet të jepet për secilën shkelje të parashikuar në skenarë dhe dy pyetjet e tjera lidhen me gatishmërinë për të raportuar rastet e sjelljes korruptive nga vetë punonjësi i anketuar dhe mendimin e tij për gatishmërinë për të raportuar të punonjësve të tjerë.

Pyetja e tjetër (nr. 3) synon të marrë përgjigje nëse punonjësit e policisë mendojnë se sjellja e përshkruar në skenar përbënte shkelje të politikës zyrtare të institucionit të policisë.

Së fundi, vlen të theksohet një nga kufizimet kryesore të këtij studimi. Më konkretisht, kufizimi ka të bëjë me vështirësinë për të gjeneruar analiza krahasuese nga viti në vit apo nga sektori në sektor, gjë që më shumë se sa nga ky studim buron nga mungesa e studimeve me metodologji të ngjashme të aplikuara në këtë sektor.

## 4. Korrupsioni policor

### 4.1. Ç'është korrupsioni

Korrupsioni është një fenomen për të cilin akoma nuk ka ndonjë përkufizim të pranuar në mënyrë universale. Origjina e fjalës vjen nga latinishtja '*corruptus*' që do të thotë '*i prishur*' dhe '*corrumpere*' që do të thotë '*shkatërroj*'.<sup>1</sup>

Përpjekjet për të zhvilluar një përkufizim më të saktë hasin në probleme të natyrës ligjore, kriminologjike, dhe në shumë vende dhe politike. Për shembull disa qeveri konsiderojnë se forma të caktuara të korrupsionit si nepotizmi mund të adresohen nëpërmjet legjislacionit civil dhe jo atij penal.<sup>2</sup>

Në kushtet kur nuk ka një përkufizim universal për korrupsionin, korrupsioni ka kuptim të ndryshëm në vende të ndryshme.

1 United Nations Handbook On Practical Anti-Corruption Measures For Prosecutors And Investigators, Vienna, September 2004

2 Po aty

Konventa e OKB kundër korrupsionit e përkufizon korrupsionin si: *‘premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare’*, dhe si *‘kërkimi ose pranimi nga nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër, apo një subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare’*.<sup>3</sup>

Këshilli i Evropës e ka përkufizuar korrupsionin si *‘të kërkuarit, ofrimin, dhënies ose pranimit drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë të një mitmarrje ose çdo lloj tjetër avantazhi ose përfitimi që deformon kryerjen e çdo detyre ose sjellje të kërkuar nga pranuesi i mitmarrjes, për pasojë dhe të avantazhit e përfitimit të padrejtë’*.<sup>4</sup>

Përkufizimet akademike për korrupsionin janë më të gjera. Khan e përkufizon korrupsionin si *‘një sjellje e cila devijon nga rregullat zyrtare të sjelljes të cilat udhëheqin veprimet e dikujt me pozitë dhe autoritet publik për motive private që lidhen me pasurimin, pushtetin ose statusin’*.<sup>5</sup>

Ndërsa Nye e përkufizon korrupsionin si *‘sjellje e cila devijon nga detyrimet zyrtare të sjelljes të një zyrtari publik për shkaqe që lidhen me përfitime financiare ose statusi, ose që shkel rregullat përkundrejt ushtrimit të influencave private’*.<sup>6</sup>

Veprimtaritë korruptive më të ndëshkuara janë ryshfeti, konflikti i interesit, mashtrimi, nepotizmi, dhuratat, etj. Ryshfeti mund të jetë në formë pasive ose aktive dhe mund të ketë në formën e parave, sendeve me vlerë, favoreve, etj. Korrupsioni mund të jetë individual, në nivel institucioni ose korrupsion në nivel sistemi (sistemik). Disa nga format më të njohura të korrupsionit përshkruhen më poshtë.<sup>7</sup>

*Korrupsion i madh dhe i vogël.* Korrupsion i madh është korrupsioni i cili gjendet i përhapur në nivelet më të larta të qeverisë nga ku burojnë dhe abuzime të mëdha me pushtetin. Në këtë rast mund të flitet dhe për ‘kapje të shtetit’ nga korrupsioni. Korrupsioni i vogël përbën shkëmbimin e sasive të vogla të parave dhe dhënien e favoreve të vogla nga ata që synojnë të përfitojnë trajtim të veçantë apo punësimi i

4 Ligj Nr.8635, datë 6.7.2000, Për Ratifikimin e Konventës Civile ‘Për Korrupsionin’

5 Mushtaq H Khan, (1996), ‘A Typology of Corrupt Transactions in Developing Countries’,

6 Joseph S. Nye, *Corruption and Political Development: A Cost-Benefit Analysis*, American Political Science Review, vol. 61, (1967)

7 Zyra e Kombeve kundër Drogës dhe Krimit, Instrumenti i Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Botimi i 3-të, Vjenë, Shtator 2004

miqve dhe të afërmeve në pozicione të ulta administrative.

*Korrupsioni aktiv dhe pasiv.* Korrupsioni aktiv quhet dhënia e ryshfetit ndërsa korrupsioni pasiv quhet marrja e ryshfetit. Ky dallim shërben kryesisht për të evidencuar rastet kur korrupsioni është kryer por jo rastet kur është synuar nga njëra nga palët por ka ngalur në tentativë.

*Ryshfeti.* Është forma më e përhapur dhe e njohur e korrupsionit dhe përfitimet e ryshfetit mund të jenë në para, sende me vlerë, favore të ndryshme, informacion, punësim apo thjesht premtimin e një stimuli. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit e përkufizon ryshfetin si: 'a) premtimi, ofrimi ose dhënia një nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër apo subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij ose të saj zyrtare; dhe b) kërkimi ose pranimi nga nëpunësi publik, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i një avantazhi të parregullt për vetë nëpunësin ose një person tjetër, apo një subjekt, me qëllim që nëpunësi të veprojë ose të mos veprojë në ushtrim të funksioneve të tij zyrtare.<sup>8</sup>

*Përvetësimi, vjedhja ose mashtrimi.* Këto forma përfshijnë marrjen ose tjetërsimin e parave, pasurisë dhe mjeteve me vlerë nga një individ i cili nuk ka të drejta pronësie mbi to duke përfituar nga e drejta e dhënë për ti përdorur ato për shkak të aksesit si rezultat i pozicionit të punës.

*Zhvatja.* Në ndryshim nga ryshfeti i cili bazohet në pagesë apo forma të tjera të nxitjes pozitive, bazohet tek frikësimi nëpërmjet forcës apo kërcënimit për të nxitur bashkëpunimin në një akt korruptiv.

*Abuzimi me të drejtën për të marrë vendime.* Kjo është një formë korrupsioni e cila përdoret nga punonjës të administratës për përfitime personale. Abuzime të tilla ndodhin kur mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies mungojnë ose janë të dobëta.

*Favoritizmi, nepotizmi dhe klientelizmi.* Këto forma përfshijnë edhe abuzimin me të drejtën për të marrë vendime por në këto raste abuzimi nuk lidhet me përfitimin për interesa vetjake të një zyrtari por për interesat e një personi tjetër, si anëtarë të familjes, fisit, grupit, racës, fesë, partisë politike apo përkatësive të tjera.

## 4.2. Korrupsioni policor dhe llojet e tij

Ashtu si edhe me përkufizimin e korrupsionit si fenomen i përgjithshëm, përkufizimi i korrupsionit policor ka sfidat e veta. Është i njohur fakti se punonjësit e policisë gjenden të përfshirë në një sërë veprimtarish korruptive.<sup>9</sup>

Njohja e korrupsionit policor dhe formave të ndryshme të tij janë e nevojshme pasi forma të ndryshme korrupsioni kërkojnë forma të ndryshme ndërhyrje për t'i trajtuar ato. Pasja e një njohje dhe vlerësimi sa më të thellë dhe të gjerë të shfaqjeve të korrupsionit policor përbën hapin e parë në procesin e hartimit të strategjive të efektshme kundër tij.<sup>10</sup>

Termi korrupsion policor është përdorur për të përshkruar një sërë veprimesh, si ryshfeti, përdorimi i dhunës, fabrikimi dhe dëmtimi i provave, racizmi, favoritizmi apo nepotizmi,<sup>11</sup> të cilat jo domosdoshmërisht mund të kategorizohen të gjitha si akte korrupsioni.

Sipas Newburn, llojet dhe dimensionet e korrupsionit policor, të cilat përfshijnë në mënyrë progresive që nga shkelja e rregullave deri tek sjellja e paligjshme, janë si më poshtë.

*Korrupsioni me autoritetin.* Kur një punonjës policie përfiton nga pozita si një polic përfitime material (p.sh. pranimi i pijeve, ushqimit dhe shërbimeve falas) por pa shkelje të ligjit në vetvete.

*Komisionet ose përqindjet.* Marrja e mallrave, shërbimeve ose të hollave për krijimin e ndërmjetësisë ndërmjet individëve ose kompanive.

*Vjedhja duke përfituar nga rasti.* Vjedhja e të arrestuarve, e viktimave të aksidenteve të trafikut rrugor, e viktimave të krimit dhe apo nga trupat e qytetarëve të vdekur.

*Zhvatja.* Pranimi i një ryshfeti në këmbim të mosndjekjes së një çështje kriminale.

*Mbrojtja e aktiviteteve të paligjshëm.* Mbrojtja nga punonjës të policisë e perso-

9 Mark A Lauchs and Shannon Merrington. "Noble cause corruption: the Wood Inquiry." (2012).

10 Marie Chêne, 'Anti-Corruption and police reform', U4 Expert Answer, Anti-Corruption Resource Centre, 31 May 2010, Number: 247

11 Tim Newburn and Barry Webb. Understanding and preventing police corruption: lessons from the literature. No. 110. Home Office, Policing and Reducing Crime Unit, Research, Development and Statistics Directorate, 1999.

nave të përfshirë në veprimtari të paligjshme (prostitucion, drogë, etj) duke bërë të mundur vazhdimin e aktivitetit të tyre.

*Ndërmjetësimi.* Dëmtimi i hetimeve kriminale, ‘humbja’ me qëllim e gjobave, etj.

*Përfshirja në veprimtari kriminale.* Kur një punonjës policie kryen një krim kundër personit ose pronës për përfitime personale duke shkelur si rregullat e policisë ashtu edhe ligjin.

*Abuzimi me privilegjet dhe shpërblimet.* Shitja, këmbimi apo tjetërsimi i privilegjeve të destinuara për punonjësit e policisë (pushimet, shpërblimet, rritja në detyrë, etj)

*‘Mbushja’.* Futja ose vendosja e provave të paqena (kryesisht për rastet e narkotikëve)

Prenzler sugjeron një tipologji të ndarë në gjashtë kategori, e cila synon të fiksojë sa më në gjerësi keqsjelljen policore por dhe të dallojë ndërmjet llojeve të ndryshme të tyre.<sup>12</sup>

*Korrupsioni klasik.* Ky lloj korrupsioni ndodh kur punonjës të policisë abuzojnë më detyrën për qëllime përfitimi personal. Ryshfeti, marrja e shpërblimeve në mënyrë të rregullt nga kundërvajtës të ligjit si trafikante prostitucioni, apo droge në këmbim të mosveprimit janë disa nga format e korrupsionit klasik. Po kështu në këtë kategori hyjnë forma të korrupsionit duke përfituar nga rasti si, për shembull, marrja e parave aty për aty nga një shpërndarës i vogël droge në këmbim të mosarrestimit apo nga një kundërvajtës trafiku rrugor në këmbim të mosvënies së gjobës apo masave të tjera. Në disa raste, korrupsioni klasik mund të përfshijë edhe ‘korrupsionin e vogël’, siç është marrja e dhuratave apo privilegjeve, që edhe pse në vlera të vogla përmbajnë pritshmërinë e trajtimit të favorshëm si këmbim.

*Korrupsioni gjatë procesit.* Ky lloj korrupsioni përfshin ndërhyrjen në prova apo fabrikimin e tyre për t’u paraqitur gjatë proceseve gjyqësore. Viktimat e këtij lloj korrupsioni mund të jenë të pafajshëm apo mund të mos jenë fajtorë, por që policia ndjek dënimin e tyre në gjykatë përmes mënyrës së mashtrimit. Korrupsioni gjatë procesit gjyqësor përfshin çdo përpjekje për të penguar dhënien

12 Tim Prenzler, Police corruption: Preventing misconduct and maintaining integrity. CRC Press, Taylor & Francis Group 2009

e drejtësisë, si dhënia e dëshmisë së rreme, mosparaqitja e plotë e provave, frikësimi i të dyshuarve që të japin dëshmi të rreme. Ky lloj korrupsioni mund të ndodhë edhe gjatë fazës së hetimit paragjyqësor kur provat mund të mblidhen duke shkelur proceduat e parashikuara në ligje, si kontrole apo përgjime të paligjshme, pengimi i të arrestuarve për të marrë ndihmë ligjore, etj.

*Përdorimi i forcës së tepruar ose 'brutaliteti'.* Ky mund të përfshijë që nga trajtimi i ashpër, gjatë kontrolleve fizike, deri tek sulmi fizik, tortura apo vrasja. Në këtë kategori përfshihen edhe abuzimi verbal, frikësimi, kërcënimet me përdorim të dhunës, ndjekja me shpejtësi të lartë nga patrullat e lëvizshme, të qëlluarit me armë ndaj të dyshuarve që tentojnë të largohen, etj. Normalisht, kompetenca e policisë për të përdorur forcë në rastet e ndërhyrjes për të mbrojtur qytetarët, për të arrestuar të dyshuar që rezistojnë apo për vetëmbrojtje, kufizohet në 'minimale', 'e arsyeshme' ose 'proporcionale'.

*Sjellja joprofesionale ose sjellja e pahijshme.* Kjo është një kategori e gjerë në të cilën grupohen lloje të tjera të sjelljes devijuese ndaj publikut. Kjo kategori, e cila njihet ndryshe edhe si 'keqsjellje' apo 'shkelje e disiplinës', dallohet nga korrupsioni pasi nuk përmban ndonjë përfitim të qartë apo të drejtpërdrejtë nga ana e punonjësit të policisë të përfshirë. Sjellja joprofesionale mund të përfshijë ngacmime dhe vrazhdësi, diskriminim racial apo seksual, mosveprimin dhe dembelizëm, keqpërdorim të informacionit konfidencial (p.sh. duke shfrytëzuar të dhëna policore për arsye që nuk lidhen me punën), neglizhimin e viktimave të krimit ose të arrestuarve, apo dhe refuzimin për të bashkëpunuar me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Po ashtu, kjo kategori përfshin vendimet për të hetuar dhe ndjekur penalisht që qëllimisht favorizojnë të afërmit apo miqtë – 'nepotizmi' dhe 'miqësia – dhe diskriminojnë kundërshtarët, përfshirë edhe partitë politike, organizata apo grupe shoqërore. Përdorimi i statusit të policisë për të ndjekur çështje administrative ose ligjore private përfshihet gjithashtu në këtë kategori.

*Korrupsioni i brendshëm ose devijimet në vendin e punës.* Këtu përfshihen ngacmimi i punonjësve të policisë (përfshirë dhe ngacmimin seksual), diskriminimi apo favorizimi në emërimet dhe në gradimet, abuzimi me pagesat për pushimet mjekësore, dehja gjatë punës dhe përdorimi lëndëve narkotike, keqmenaxhimi i kohës së punës, keqpërdorimi apo përvetësimi i burimeve dhe mjeteve të policisë.

*Sjellja e papërshtatshme ose joprofesionale jashtë orarit të punës.* Këtu përfshi-

hen vepra kriminale dhe sjellja e të papërshtatshme të kryera jashtë detyrës, por mendohet të reflektojnë negativisht në punën-të tilla si drejtimi i automjetit në gjendje të dehur, sulmet dhe gjuhën abuzive të oficerit.

Një tjetër qasje për të analizuar llojet dhe format e korrupsionit policor është ajo e programit të USAID mbi Antikorrupsionin dhe Integritetin Policor (Neild 2007).<sup>13</sup> Sipas kësaj qasjeje, ka katër kategori korrupsioni.

<p><i>Korrupsioni i vogël</i></p>	<p>Marrja e ryshfeteve të vogla nga qytetarët e zakonshëm (në mënyrë të veçantë nga punonjës të policisë së trafikut)</p> <p>Pranimi i dhuratave dhe shërbimeve falas</p> <p>Shitja informacionit nga dosjet penale</p> <p>‘Humbja’ me qëllim e provave, dëshmime, etj</p> <p>Vjedhja gjatë kontrolleve</p> <p>Marrja e mallrave të konfiskuar nga kontrabandës</p> <p>Dhënia e ndihmës të burgosurit për tu arratisur</p> <p>Përdorimi i burimet policore për qëllime personale (përdorimi i automjeteve të policisë të shëtitur me familjen, dhënia në përdorim armëve të shërbimit të policisë kriminelëve, etj)</p>
-----------------------------------	---

13 Rachel Neild, “USAID program brief: anticorruption and police integrity.” *Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar*, 2007



<p><i>Korrupsioni zyrtar (burokratik)</i></p>	<p>Kontraktimi dhe blerjet e privileguara, etj</p> <p>Vjedhja e aseteve dhe burimeve të policisë (nga pagat, sistemi i shpërblimeve, etj)</p> <p>Shitja informacionit nga dosjet penale</p> <p>‘Humbja’ me qëllim e provave, dëshmime</p> <p>Dhënia e licencave dhe lejeve në mënyrë të parregullt</p> <p>Prishja e disiplinës së brendshme të hetimeve</p> <p>Marrja apo kërkimi i ryshfeteve për rekrutimin, diplomimin, trajnimin, emërimin, etj.</p>
<p><i>Korrupsioni kriminal</i></p>	<p>Marrja e ryshfeteve apo përqindjeve nga të kriminelë të njohur</p> <p>Zhvatja e pagesave në mënyrë të rregullt nga grupe kriminale, etj.</p> <p>Dhënia e mbështetjes për aktivitetet kriminale me pajisje, informata, mbulim të aktivitetit, etj</p> <p>Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në krim apo veprimtari krimi të organizuar (trafikimi i drogës, grupe pengmarrësish, etj)</p> <p>Vjedhja e mallrave kontrabandë të konfiskuara</p> <p>Mbrojtja e aktiviteteve ekonomike të paligjshme</p>
<p><i>Korrupsioni politik</i></p>	<p>Manipulimi i hetime penale</p> <p>Inicimi i hetimeve të rreme</p> <p>Dhënia e informacionit konfidencial politikanëve</p> <p>Shkelja e lirisë së të shprehurit dhe të protestës (demonstratës publike, grevës dhe aktiviteteve të tjera opozitare)</p> <p>Kryerja ose mbulimi i vrasjeve politike</p> <p>Shkelja e lirive politike, e të drejtës së informimi dhe e aktivitetit të ligjshëm të partive politike</p> <p>Dhënia e informacionit grupeve të armatosura të paligjshme</p>

### 4.3. Korrupsioni, devijimi dhe keqsjellja

Siç shihet nga përkufizimet e autorëve dhe institucioneve të ndryshme, një vështirësi e mëtejshme në përkufizimin e korrupsionit është bërja e dallimit ndërmjet llojeve të korrupsionit policor si dhe dallimi ndërmjet devijimit nga rregullat administrative të policisë me shkeljen e ligjit por dhe lidhja që këto veprimtari mund të kenë ndërmjet tyre. Vështirësia për të dalluar ndërmjet keqsjelljes, korrupsionit dhe kriminimit të kryer nga punonjës të policisë bëhet më domethënëse në rastet kur korrupsioni policor ka të bëjë me dështimin për të vepruar më shumë sesa me një veprim të caktuar.

Është e vështirë të dallohet, për shembull, nëse një hetim policor nuk është duke u kryer siç duhet për arsye objektive apo për arsye se punonjës të policisë janë duke penguar me qëllim hetimin. Për më tepër, kur qëllimi mund të jetë i natyrave që variojnë nga qëndrime që shkelin rregullat dhe etikën policore, si, për shembull, dëshira për t'u hakmarrë ndaj një kolegu apo eprori që ka përgjegjësi mbi çështjen, dëshira për të shmangur ngarkesën e mëtejshme në punë, etj, deri tek akte penale si bashkëpunimi me kriminelët për të prishur hetimet.

Nga ana tjetër, çështja bëhet më e ndërlikuar kur duhet sqaruar nëse qëndrime të tilla janë të kufizuara tek punonjës policie të veçantë apo janë marrëveshjeve kolektive ndërmjet shumë prej tyre.

Kutnjak Ivkovic jep një përkufizim të korrupsionit ku përfiqet të mundësojë vendosjen e kufijve ndërmjet korrupsionit policor dhe sjelljes etike nga njëra anë dhe ndërmjet korrupsionit policor dhe formave të tjera të keqsjelljes policore.

*'Korrupsioni policor është një veprim ose mosveprim, një premtim për veprim ose mosveprim, ose një përpjekje për të vepruar apo mosvepruar, i shkaktuar nga një punonjës policie apo një grup punonjësish të policisë, i cili karakterizohet nga abuzimi i pozicionit zyrtar të punonjësit të policisë, i motivuar në masë të konsiderueshme prej përfitimit personal'* (Kutnjak Ivkovic 2005: 16).<sup>14</sup>

Bazuar në katër faktorë (1) aktin e korrupsionit, (2) marrëveshjen ndërmjet korruptuesit dhe të korruptuarit, (3) kohën e pagesës, dhe (4) mundësinë e përfitimit personal, Kutnjak Ivkovic jep një matricë që ndihmon për të dalluar ndërmjet korrupsionit dhe formave të tjera të keqsjelljes policore.

14 Sanja Kutnjak Ivkovic, 'Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption: Controlling Police Corruption', Oxford University Press, Sep 30, 2005

Abuzimi me detyrën	Marrëveshja	Përdorimi i forcës	Përfitimi i paligjshëm	Klasifikimi
+	+	-	+	Korrupsion policor
+	+	-	-	Forma të tjera të keqsjelljes policore
+	-	+	+	Korrupsion policor
+	-	+	-	Përdorim i tepruar i forcës
+	-	-	+	Korrupsion policor
+	-	-	-	Forma të tjera të keqsjelljes policore

*Tabela 1. Kombinim i faktorëve kryesorë që përcaktojnë korrupsionin*

Përkufizimi dhe tabela e mësipërme ndihmojnë në dallimin ndërmjet korrupsionit policor dhe formave të tjera të keqsjelljes. Kur abuzimi me detyrën dhe marrëveshja çojnë në përfitim personal, atëherë një punonjës policie ka kryer një akt korrupsioni. Po kështu, kur abuzimi me detyrën dhe përdorimi i forcës së tepruar sjellin përfitim personal, edhe në këtë rast një punonjës policie ka kryer një akt korruptiv. Dhe së fundi, edhe kur abuzimi me detyrën rezulton në përfitim personal pa marrëveshje apo përdorimin e tepruar të forcës, një punonjës policie ka kryer një akt korruptiv.

Edhe Punch dhe Karp bëjnë dallimin ndërmjet keqsjelljes policore dhe korrupsionit policor. Karp specifikon se keqsjellja, e cila përfshin keqpërdorimin e kompetencave, përbën, po ashtu, korrupsion duke përfshirë si akt korruptiv edhe rastin kur një punonjës policie nuk raporton një akt korruptiv të kryer nga një punonjës tjetër (Foreman dhe Turner 2011).<sup>15</sup>

Punch, i cili dallon katër kategori të sjelljes deviante të punonjësve të policisë, ofron dhe mjetet me të cilat duhet të trajtohet secila kategori. Të gjitha kategoritë përmbajnë elementë të abuzimit, por kanë ndryshim në shkallën e peshës dhe rëndësisë së kundërvajtjes (Gunev et al: 2012).<sup>16</sup>

15 Mark E Foreman and James T. Turner. "Comparative review." *Policing: An International Journal of Police Strategies & Management* 34, no. 1 (2011).

16 Philip Gunev, Rositsa Dhekova, and Tihomir Bezlov. "Anti-Corruption Measures in EU Border Control." *CSD Occasional Papers* III (2012): 1-165.

Lloji i shpërdorimit të detyrës	Përshkrimi	Mjetet për ta adresuar
Devijim	Të gjitha llojet e veprimtarive policore të cilat shkelin rregullat e brendshme dhe pritshmëritë e ligjeve dhe të publikut për sjellje etike dhe ligjore nga policia.	Rregullore të brendshme, Kode të sjelljes
Keqsjellje ose devijim profesional	Përdorimi i alkoolit gjatë kryerjes së detyrës, mungesa e korrektësisë, neglizhenca në kryerjen e detyrës, mosrespektimi i eprorëve	Kode dhe rregullore të disiplinës së brendshme
Korrupsion	Marrja e ryshfetit, krijimi i pengesave në dhënien e drejtësisë, marrja e pagesave ose favoreve në këmbim të shërbimeve, dhënia e informacionit sekret, marrja dhe përdorimi i mallrave të konfiskuara, si drogë, armë, etj.	Kodi penal
Krim	Përdorimi i tepruar i dhunës, grabitje me armë, përdhunim, vrasje	Kodi penal

*Tabela 2: Kategoritë e sjelljes devijuese nga punonjës të policisë si dhe mjeteve për t'i adresuar sipas Punch<sup>17</sup>*

Megjithëse keqsjellja dhe korrupsioni policor dallojnë nga njeri tjetri, ato nuk duhet të shihen të shkëputura plotësisht nga njëra tjetra, pasi nga momenti që punonjësit e policisë përfshihen në një shkëlqje sado të vogël të rregullave administrative, si pranimi i pijeve falas apo uljes së çmimit, atëherë këta punonjës kanë ndërmarrë hapat e parë drejt formave të tjera të keqsjelljes policore, të cilat do t'i bëjnë të rrëshqasin gradualisht drejt formave më të rënda të keqsjelljes (Dean et al 2012).<sup>18</sup> Siç shihet në Figurën 1, devijimi policor fillon me përkeqësimin gradual të vetëpërmbytjes nga punonjësit e policisë, i shoqëruar nga perceptimi i një ndjenje të lejueshmërisë drejt devijimit të mëtejshëm. Matrica e devijimit policor tregon se 'korrupsioni policor' qëndron diku në mes ndërmjet 'keqsjelljes policore' nga njëra anë dhe 'policimit grabitqar' nga ana tjetër. Koncepti i policimit grabitqar

17 Po aty

18 Geoff Dean, Peter Bell, and Mark Lauchs. "Conceptual framework for managing knowledge of police deviance." *Policing & Society* 20, no. 2 (2010): 204-222.

është i rëndësishëm pasi kjo formë e bën korrupsionin policor proaktiv duke bërë që punonjësit e policisë të kalojnë nga pranimi i ryshfetit në këmbim të mosveprimit drejt një roli më aktiv, duke kërkuar para apo përfitime të tjera në këmbim të shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve apo kriminelëve. Ndër llojet e korrupsionit të diskutuara më sipër, zhvatja nga qytetarët apo nga organizatat kriminale, janë forma të policimit grabitqar.




Figura 1. Matrica devijimit policor sipas Dean et al

## 4.4. Integriteti policor dhe korrupsioni

Me integritet policor në këtë studim do të kuptojmë prirjen e punonjësve të policisë ‘për t’i rezistuar tundimit për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni i tyre.’<sup>19</sup>

Nisur nga ky përkufizim, nëse e shohim korrupsionin si një pasqyrim të integritetit, sa më shumë integritet aq më pak korrupsion dhe anasjelltas, atëherë matja e korrupsionit mund të kryhet edhe nëpërmjet matjes së integritetit.

Matja e korrupsionit nëpërmjet integritetit policor bazohet në qasjen e trajtimit të korrupsionit si problem organizativ, ndryshe nga qasja tradicionale e cila e trajton korrupsionin si problem të punonjësve me prirje për të shkelur rregullat. Për këtë arsye integriteti policor i përdorur në këtë studim është i ndryshëm nga ‘testi i integritetit’, të cilin organizatat policore e përdorin mjet për të identifikuar punonjës të policisë të përfshirë në korrupsion apo keqsjellje.

Për shkak të vështirësive për të matur korrupsionin, koncepti i integritetit policor është i vlefshëm, pasi shërben edhe si një instrument shtesë për të matur korrupsionin. Integriteti policor sipas kësaj qasje bazohet në katër dimensione të natyrës organizative dhe profesionale.<sup>20</sup>

Rregullat organizative – Dimensioni i parë ka të bëjë më së shumti se si hartohen, miratohen, komunikohen dhe si kuptohen rregullat antikorrupsion. Kjo është e rëndësishme, pasi punonjësit e policisë kanë nevojë të dinë se cilat veprimtari ndalohen nga rregulloret dhe aktet e tjera të hartuara nga institucioni. Ndodh shpesh që në mungesë të njohjes së këtyre rregullave punonjësit e policisë i nënshtrohen rregullave të pashkruara.

Mekanizmat e parandalimit dhe kontrollit – Dimensioni i dytë përbën tërësinë e mekanizmave që institucionet policore përdorin për të parandaluar dhe kontrolluar korrupsionin si trajnimi i etikës, hetimi proaktiv dhe reagues, testet e integritetit, frenimi i korrupsionit nëpërmjet masave disiplinore. Megjithatë, shkalla në të cilën shërbimet policore i përdorin këto mekanizma ndryshon.

Heshtja – Dimensioni i tretë i korrupsionit, i cili përbën një tipar të brendshëm të kulturës profesionale të organizatave policore është kodi i heshtjes. Në mënyrë

19 Carl B. Klockars, Sanja Kutnjak Ivković, Maria R. Haberfeld. ‘Enhancing police integrity’. Springer 2006. f.1

20 Kjo qasje është aplikuar në ShBA nga një grup studiuesish, të cilët e kanë përdorur këtë qasje për të matur integritetin policor në SHBA por dhe në disa vende të tjera.

informale kodi i heshtjes ndalon ose shkurajon punonjësit e policisë të raportojnë sjelljet korruptive të kolegëve të tyre. Në një institucion policie me integritet nuk tolerohen ata punonjës që abuzojnë me të drejtat dhe privilegjet që ofron profesioni.

Pritshmëritë e publikut – Ky dimension i katërt e vendos theksin tek ndikimi i mjedisit shoqëror, ekonomik dhe politik në të cilin vepron institucioni i policisë. Një institucion policie me integritet është i vetëdijshëm për mundësitë dhe rreziqet që ofron mjedisi i jashtëm dhe ndërmerr masa për t’i rezistuar trysnisë së korrupsionit që vjen nga ky mjedis. Nga ana tjetër, korrupsioni i përhapur për një kohë të gjatë tregon se pritshmëritë e publikut ndaj policisë luajnë rol të rëndësishëm, pasi tregojnë se policia nuk ka qenë e suksesshme për t’i rezistuar trysnisë së korrupsionit.

## 5. Korrupsioni policor në Shqipëri

### 5.1. Korrupsioni si fenomen i përgjithshëm

Që nga rënia e regjimit komunist, korrupsioni ka qenë dhe vazhdon të ngelet një nga problemet kryesore të Shqipërisë. Matjet periodike të perceptimit të publikut dhe studimet kanë treguar në vazhdimësi përhapjen e korrupsionit pothuajse në të gjitha nivelet dhe sektorët e veprimtarisë së shtetit.

Megjithatë, edhe pse korrupsioni filloi të trajtohet si problem pas rënies së komunistit, ky nuk është një fenomen kaq i ri. Korrupsioni ka qenë një tipar i theksuar i shoqërisë Osmane,<sup>21</sup> dhe kultura e korrupsionit e trashëguar nga Perandoria Osmane ka pasur ndikimin e saj edhe në dekadat e mëvonshme. Termat si ‘bakshish’ apo ‘ryshfet’, pjesë e fjalorit të përditshëm në ditët e sotme janë tregues të vazhdimësisë së ndikimit të asaj kulture.

Korrupsioni vazhdoi të ishte një praktikë e përhapur gjerësisht edhe në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore dhe një nga shkaqet kryesore të mbështetjes jo të gjerë popullore ndaj qeverisjes së Mbretit Zog.<sup>22</sup>

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe me instalimin e regjimit komunist, sistemi ekonomik shoqëror u transformua rrënjësisht. Sistemi i ekonomisë së centralizuar, forma e organizimit të institucioneve të shtetit dhe zbatimi i parimit të barazisë në të ardhura sollën ndryshime strukturore, të cilat e dekurajonin korrupsionin në format e njohura tradicionalisht. Për më tepër, regjimi komunist e ktheu luftën

21 Michael E. Meeker, ‘A nation of empire: the Ottoman legacy of Turkish modernity’. University of California Press, 2002

22 Bernd J. Fischer, ‘Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri’, Çabej, Tiranë 1996



kundër korrupsionit në një ndër prioritetet kryesore të luftës ideologjike, duke e trajtuar si mbetje të së kaluarës osmane dhe zogiste, periodha me të cilat identifikoheshin me prapambetjen e vendit, por dhe si fenomen të lidhur me borgjezinë dhe kapitalizmin.

Por nga ana tjetër, trajtimi i korrupsionit me mjete ideologjike, që e konsideronte korrupsionin si sjellje individuale dhe jo si fenomen shoqëror, bëri që regjimi komunist të dështojë në krijimin e kapaciteteve administrative për ta luftuar atë në mënyrë të përshtatshme. Kjo pasqyrohej edhe në ligjin penal, ku mungonte përcaktimi i korrupsionit si veprë penale dhe në vend të tij përcaktoheshin si vepra penale ryshfeti, abuzimi me detyrën, pakujdesia në punë, etj., edhe pse dënimet e parashikuara për këto lloj veprash ishin të larta.<sup>23</sup>

Por nga ana tjetër, vetë sistemet komuniste krijuan kushtet për zhvillimin e korrupsionit. Mundësitë e vogla për konkurrencë ndërmjet elitave dhe një nivel institucionalizimi i lartë i administratës bënë që vetë sistemi komunist të bazohej në struktura hierarkike të bazuara tek raportet e vartësisë ndërmjet drejtuesve të institucioneve dhe njerëzve të afërt që i rrethonin të cilat raporte përforcoheshin nga rrjete të gjera klienteliste.<sup>24</sup>

Edhe në kontekstin shqiptar kultura e korrupsionit e trashëguar nga sistemet e mëparshme politike u përshtat me sistemin e ri që u krijua. Shkëmbimi i favoreve në formë financiare apo në mallrave, edhe pse në vlera jo të konsiderueshme, vazhdoi të ishte i pranishëm në shumë sektorë por kryesisht në shërbimet shëndetësore, të transportit, të mallrave të konsumit, etj. Nga ana tjetër, korrupsioni administrativ ishte i përhapur në formën e krijimit të favoreve dhe lehtësirave për të përfituar nga sistemi si emërimet në pozicione të privilegjuara, shpërndarja e të drejtave studimore për në universitet, etj. Me thellimin e krizës ekonomike të viteve 1980, sidomos në periudhën e racionimit të ushqimeve, këto forma korrupsioni morën trajta më të theksuara derisa tjetërsimi i pronës publike gradualisht u kthye në një fenomen sistematik, ndërkohë që për shkak edhe të dobësisë të vazhdueshme të regjimit komunist shteti gjithnjë e më shumë po e humbiste forcën e tij reaguese.<sup>25</sup>

Rritja e shkallës së korrupsionit gjatë dekadës së fundit të diktaturës vuri në pah

23 Kodi Penal i vitit 1952 dhe i vitit 1977 parashikonte dënime me burgim deri në 10 vjet për marrje ryshfeti dhe deri në 3 vjet për dhënie ryshfeti. Ligji Nr. 1470, datë 23.5.1952, Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Neni 204 dhe 205. Ligj Nr. 5591, datë 15.6.1977, Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Neni 109.

24 Herbert Kitschelt, "Formation of Party Cleavages in Post-Communist Democracies Theoretical Propositions." *Party politics* 1, no. 4 (1995): 447-472.

25 SIDA, 'Albania Anti-Corruption Study', Rambøll Management, Copenhagen, December 2007

edhe dështimin e qasjes së shtetit komunist për ta trajtuar korrupsionin me mjete gjerësisht ideologjike. Me rënien nga njëra anë e aftësisë goditëse të diktaturës dhe daljen gjithnjë e më shumë në pah të falsitetit ideologjik të sistemit dhe, nga ana tjetër, me paaftësinë për ta trajtuar problemin në mënyrë administrative bënë që korrupsioni të merrte përmasa të mëdha.<sup>26</sup>

Përkundrejt këtij konteksti, rënia e regjimit komunist krijoi premisa të shumta për përhapjen e korrupsionit në përmasa akoma më të mëdha për shkak të ndryshimeve strukturore në marrëdhëniet ekonomike dhe të ndryshimeve në marrëdhëniet shoqërore.

Në aspektin strukturor sistemi ekonomik jofunksional kishte nevojë për transformime të shpejta dhe këto nevoja u shfrytëzuan nga elitat politike për qëllime përfitimi personal dhe partiak.<sup>27</sup> Ky ishte një tipar i përgjithshëm i vendeve post komuniste në të cilat gjatë proceseve të tranzicionit dhe privatizimeve në ekonomi u krijuan mundësi akoma edhe më të shumta për korrupsion.<sup>28</sup>

Në aspektin njerëzor vendet ish komuniste hynë në fazën e tranzicionit politik, ekonomik dhe shoqëror me një sërë pasigurish. Një nga këto ishte dhe pasiguria që krijonte mungesa e vlerave monetare. Një nga tiparet e shoqërisë komuniste ishte se mungesa e pronës private kompensohej me pushtet dhe pozicionin në shoqëri. Një drejtues partie apo ndërmarrje shtetërore nuk kishte në pronësi as shtëpinë ku banonte, por pozicioni i jepte mundësi të përfitonte nga prona kolektive në mënyrë të privilegjuar. Duke qenë se kjo përbënte një pasiguri, pasi me humbjen e pozicionit humbnin dhe privilegjet, me dobësimin e sistemit u shfaq dhe prirja për të kthyer privilegjet në para apo vlera të tjera materiale. Kështu, interpretimi i mungesës së të drejtave ekonomike të periudhës komuniste, si e drejtë për liri të pakufizuar, bëri që qytetarët që ta shihnin tranzicionin si mundësi për të përfituar me çdo mënyrë, përfshirë dhe korrupsionin.<sup>29</sup>

Rënia e bazës ideologjike të sistemit komunist dhe boshllëku moral i krijuar gjatë tranzicionit bënë që të krijohej perceptimi i gjerë së korrupsioni është një fenomen normal i sistemit kapitalist. Edhe investitorët e huaj, të cilët e justifikonin korrupsionin si mjet për të vënë në lëvizje burokracinë e ndryshkur shqiptare ndikuan negativisht duke ndikuar në interpretimin e fenomenit nga qytetarët shqiptarë si

26 Rozario Rica, "Measures against corruption in Albania." (2012).

27 Andres Åslund, Peter Boone, Simon Johnson, Stanley Fischer, and Barry W. Ickes. "How to stabilize: lessons from post-communist countries." *Brookings papers on economic activity* (1996): 217-313

28 Wayne Sandholtz and Rein Taagepera. "Corruption, culture, and communism." *International Review of Sociology* 15, no. 1 (2005): 109-131.

29 Daniela Irrera, *Is Albania ready for Europe yet?* Jean Monnet Working Papers in Comparative and International Politics no. 68, 2013

praktikë e cila ishte në përputhje me normat dhe rregullat e kapitalizmit (SIDA 2007). Nga ana tjetër, institucionet shtetërore u shfaqën të dobëta për të ridimensionuar sjelljen shoqërore dhe për t'ia përshtatur kushteve të reja të krijuara.<sup>30</sup>

Korrupsioni i lartë në të gjithë sektorët e jetës së vendit shumë shpejt u kthye në një sfidë kryesore për qeveritë post-komuniste. Korrupsioni në privatizime ishte mjaft i përhapur dhe perceptimi se pasuria po shpërndahej në mënyrë të padrejtë shkaktoi pakënaqësi të gjerë ndaj qeverisjes.<sup>31</sup> Vetë Presidenti Berisha do ta justifikonte humbjen në referendumin për miratimin e Kushtetutës në fund të vitit 1994 si rezultat i dështimit të qeverisë në luftën ndaj korrupsionit.<sup>32</sup>

Shfaqja e skemave piramidale bëri që korrupsioni të merrte përmasa akoma më të mëdha. Sasitë e konsiderueshme të parave dhe shkalla e lartë përfshirjes politike krijuan një çoroditje akoma më të madhe morale të publikut duke sjellë dhe një përshkallëzim më të madh të korrupsionit në administratën publike.

Në këtë periudhë, por në mënyrë më të theksuar mbas rënies së skemave piramidale, filloi të konsolidohej edhe imazhi i politikanit biznesmen, pasi shumë ish qeveritarë u kthyen në biznesmenë dhe sipërmarrës të mëdhenj.<sup>33</sup> Kjo praktikë ka ardhur duke u bërë edhe më e përhapur, siç e tregon edhe numri gjithnjë në rritje i përfaqësuesve të zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë përgjatë viteve 2000 e në vazhdim.

Edhe qeveria e ardhur në pushtet pas krizës së shkaktuar nga rënia e firmave piramidale nuk arriti të sillte ndonjë ndryshim në këtë drejtim. Dorëheqja e Kryeministrit Fatos Nano në vitin 1998 u parapri nga kritika të forta për paaftësi në adresimin e korrupsionit si dhe dorëheqjen e vetë Ministrit të Brendshëm për angazhim të pamjaftueshëm të qeverisë në luftën ndaj korrupsionit.<sup>34</sup>

Në vitet e mëvonshme, kryesisht me hapjen e perspektivës së integritimit në BE dhe në sajë të presionit ndërkombëtar, problemi i korrupsionit filloi të trajtohej në mënyrë më të institucionalizuar. Sidoqoftë, korrupsioni vazhdoi të ngelej fenomen i përhapur dhe ishte një nga shkaqet kryesore që çuan në rotacionin politik të vitit 2005.

Qeveria e ardhur në pushtet mbas zgjedhjeve të vitit 2005, duke qenë e vetëdijshme për problematikën e korrupsionit, ndërmori një sërë reformash në fushën ligjore

30 Daniela Irrera, 'Is Albania ready for Europe yet?', Jean Monnet Working Papers in Comparative and International Politics no. 68, 2013

31 Aleks Luarasi, "Legal and institutional reform in Albania after the democratic revolution." *NATO Report* (1997)

32 Louis Zanga, Albania: Corruption Takes its Toll on the Berisha Government, *Transitions Online*, 12 May 1995


33 SIDA 2007

34 BBC World, 'Albania Gets Europe's Youngest PM', 29 September 1998

dhe institucionale me miratimin e institucioneve dhe agjencive të reja, miratimin e kuadrit ligjor për lehtësimin e biznesit dhe shërbimeve dhe rritjen e shkallës së dënimeve për përfshirjen në korrupsion, etj.<sup>35</sup>

Këto reforma dhanë rezultate pozitive të cilat u reflektuan edhe në Indeksin e organizatës Transparency International. Gjatë 2008-2010 Shqipëria pati një përmirësim të ndjeshëm duke u ngritur nga vendi i 105 në vitin 2007 në vendin e 85 në vitin 2008.

Megjithatë, në vitet e mëvonshme u shënua një rënie e ndjeshme. Në vitin 2012 Shqipëria zbriti përsëri në vendin e 113, dhe në vitin 2013 ra edhe tre vende më poshtë se një vit më parë, në vendin 116. Me rezultatin 31 (3.1) nga 100 pikë Shqipëria renditet si një nga vendet më të korruptuara në Evropë dhe me korrupsionin më të lartë edhe se vendet e tjera të rajonit.



Grafiku 1: Perceptimi i korrupsionit në Shqipëri për periudhën 2002-2013

## 5.2. Llojet e korrupsionit

Shumica e studimeve të cilat kanë trajtuar korrupsionin në Shqipëri janë përqendruar kryesisht tek marrja e ryshfetit nga ana e zyrtarëve publikë prej qytetarëve. Megjithëse ryshfeti është ndoshta forma më e përhapur, studimet e korrupsionit në vendet postko-

35 Banka Botërore 2008. 'Doing Business 2009: country profile for Albania - comparing regulation in 181 economies'. Washington, DC: World Bank. <http://documents.worldbank.org/curated/en/2008/09/9894666/doing-business-2009-country-profile-albania-comparing-regulation-181-economies>

muniste tregojnë për një tipologji të larmishme të korrupsionit (Tabela 3).<sup>36</sup>

<p>Korrupsioni administrativ i nivelit të ulët</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Marrja/dhënia e ryshfetit për të anashkaluar rregullat</li> <li>– Miratimi i qëllimshëm i rregullave që krijojnë burokraci të lartë, konfuzion dhe çorganizim.</li> <li>– Zhvatja nëpërmjet licencimit</li> </ul>
<p>Vjedhja e asetëve publike nga zyrtari publik</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Devijimi i burimeve publike për spekulim nga zyrtari publik</li> <li>– Keq-menaxhimi dhe spekulimi i burimeve publike</li> <li>– Spekulimi nga privatizimi</li> <li>– Praktika korruptive në prokurim</li> <li>– Nepotizëm, klientelizëm, dhe “shitblerja” e vendit të punës</li> </ul>
<p>‘Kapja e shtetit’</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Kapja de facto e institucioneve të shtetit për qëllime biznesi dhe/ose aktivitetit kriminal</li> <li>– Krijimi i rrjeteve të fshehta të cilat zvogëlojnë konkurrencën politike</li> <li>– Minimi i proceseve zgjedhore nëpërmjet financimeve të fshehta, reklamimit jo transparent</li> <li>– Keqpërdorimi i pushtetit legjislativ</li> <li>– Korrupsioni në proceset gjyqësore</li> <li>– Keqpërdorimi i kompetencave të auditimit, hetimit dhe kompetencave të mbikëqyrjes</li> <li>– Përdorimi i kompromentimit për qëllime detyrimi dhe shantazhi politik</li> <li>– Korrupsioni në media dhe korruptimi i medias</li> </ul>

*Tabela 3. Tipologjia e korrupsionit në vendet post komuniste*

Në Shqipëri studimet tregojnë se korrupsioni më i përhapur gjendet në format si dhënia e ryshfetit zyrtarëve publikë, abuzimi me tenderat, privatizim i padrejtë, shpërblimi për dhënien e kontratave publike, krijimi i monopoleve për mallrat kryesorë, zbatim i diskriminues i legjislacionit për taksat, financimi i paligjshëm

36 Karklins, Rasma. “Typology of post-communist corruption.” *Problems of Post Communism* 49, no. 4 (2002): 22-32.

i partive politike, apo dhe vjedhja e drejtpërdrejtë e pronës dhe të ardhurave shtetërore.<sup>37</sup>

Një nga format më të përhapura është edhe korrupsioni në rekrutimin e punonjësve të sektorit publik, i cili, megjithëse është zvogëluar gjatë dekadës së fundit, përsëri përbën rreth 20% të tregut të punës. Për shkak të madhësisë dhe ndryshimeve të shpeshta rekrutimi në administratën publike është i ndikuar nga korrupsioni në formën e nepotizmit dhe miqësisë por edhe ryshfetit. Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, 36% e të pyeturve në Shqipëri në vitin 2010 mendonin se punësimet në administratë ishin rezultat i miqësive dhe nepotizmit, ndërsa 25% mendonin se kishin paguar për t'u punësuar. Vetëm 15% e të pyeturve mendonin se të punësuarit plotësonin kushtet e kërkuara.<sup>38</sup>

Edhe pse mungojnë të dhëna nga studime të thelluara mbi tipologjinë e korrupsionit në Shqipëri, raportet e mediave dhe të institucioneve ndërkombëtare tregojnë ekzistencën edhe të formave të korrupsionit të përshkruara në kategorinë 'kapja e shtetit'.<sup>39</sup> Për më tepër, këto të dhëna flasin edhe për ndërthurje të korrupsionit me krimin e organizuar, ku shumë zyrtarë të lartë përfshihen në trafikë, kontrabandë, evazion fiskal, përvetësim tokash, etj.<sup>40</sup>

Një raport i Transparency International thekson se korrupsioni politik në Shqipëri përbën një nga problemet më serioze të vendit dhe një pengesë kryesore për integrimin e mëtejshëm të vendit në BE.<sup>41</sup> Masat e ndërmarra gjatë dekadës së fundit për të trajtuar këtë problem nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit për konfliktin e interesit, kufizimin e imunitetit për politikanët dhe gjyqësorin, apo për të rregulluar më mirë financimin e partive politike nuk kanë pasur ndonjë ndikim pozitiv. Raporti konstaton se në Shqipëri, korrupsioni rrezikon të 'kapë shtetin' për shkak të 'ndarjes së dobët të pushteteve, ndërhyrjes së përditshme politike në veprimtarinë e shërbimit civil dhe për shkak se 'elitat e kanë zbehur ndjeshëm kufirin ndërmjet sferës publike dhe asaj private'.<sup>42</sup>

### **5.3. V.2. Korrupsioni policor në Shqipëri**

Për arsye se regjimi komunist nuk e pranonte korrupsionin si fenomen shoqëror

37 Aiste Skardziute, Corruption in Albania. Hertie School of Governance, 2010.<http://www.againstcorruption.eu/wp-content/uploads/2012/09/WP-23-TGG-Albania-new.pdf>

38 United Nations Office on Drugs and Crime, 'Corruption in Albania: Bribery as experienced by the population', Vienna 2011, f.29

39 Matthew Jenkins, 'Albania: Overview of Political Corruption', Transparency International, 2014

40 Aiste Skardziute, Corruption in Albania. Hertie School of Governance, 2010.<http://www.againstcorruption.eu/wp-content/uploads/2012/09/EP-23-TGG-Albania-new.pdf>

41 Matthew Jenkins, 'Albania: Overview of Political Corruption', Transparency International, 2014

42 Matthew Jenkins, 'Albania: Overview of Political Corruption', Transparency International, 2014

të përhapur nuk ka të dhëna për korrupsion policor gjatë periudhës së regjimit komunist. Megjithatë, favoritizmi ishte një fenomen i përhapur pothuaj në të gjithë sferat e administrimit publik gjatë periudhës komunist. Kështu që, në këtë aspekt edhe policia nuk bënte përjashtim. Në nivel institucioni, gjatë viteve 1980 policia u ekspozua ndaj dukurisë së korrupsionit, kur vetë shteti komunist, megjithëse në mënyrë të fshehtë, u përfshi në lehtësimin e veprimtarisë së kontrabandës.<sup>43</sup>

Rënia e regjimit komunist, me ndryshimet e thella politike, ekonomike, dhe shoqërore që pasuan, e ekspozoi policinë ndaj mundësive të shumta për korrupsion. Mundësitë e shumta për përfitim si në nivel individual ashtu edhe në nivel organizate bënë që policia të kthehej në një ndër institucionet më të prekura nga korrupsioni.

Meqenëse sistemi komunist nuk e pranonte korrupsionin si fenomen shoqëror, por e trajtonte atë më së shumti me mjete ideologjike, policia nuk trashëgoi ndonjë përvojë në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Për më tepër, si një nga institucionet më të politizuara në vend korrupsioni politik përbën ndoshta një nga trashëgimitë kryesore të atij regjimi. Rekrutimi në polici pa kriteret e qarta profesionale por bazuar mbi përkatësi partiake si dhe përdorimi i policisë për të manipuluar procese zgjedhore dhe për të frikësuar opozitën përbëjnë disa nga aspektet më të dukshme të kësaj trashëgimie.<sup>44 45</sup>

Gjatë viteve 1990, policia u gjend e përfshirë në trekëndëshin ndërmjet krimit të organizuar, politizimit dhe dobësisë organizative për të reaguuar ndaj korrupsionit dhe në këtë mënyrë u përfshi në korrupsion në shkallë të gjerë. Mediat perëndimore raportonin se ‘...korrupsioni në Shqipëri është i përhapur në të gjitha nivelet dhe një ekonomi e mbështetur në modelin e gangsterizmit gjendet nën kontrollin e rreptë klientelist të partisë në pushtet’.<sup>46</sup>

Raportimet për përfshirje ministrash dhe zyrtarësh të tjerë të lartë në aktivitete të trafikut të armëve gjatë luftës në Bosnje,<sup>47</sup> apo si ‘organizatorë të trafikut të drogës’,<sup>48</sup> tregojnë se policia ishte bërë pjesë e një sistemi të kapur nga korrupsioni.

43 Xhudo, Gus. “Men of purpose: The growth of Albanian criminal activity.” *Transnational Organized Crime* 2, no. 1 (1996): 1-20.

44 Biberaj, Elez dhe Robin Alison Remington. ‘Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990 - 2010. Boulder, CO: Westview Press, 1998.

45 Vickers, Miranda, and James Pettifer. *Albania: from anarchy to a Balkan identity*. NYU Press, 2000.


46 Andrew Gumbel, ‘The Gangster Regime We Support’, *The Independent*, 14 February 1997 <http://www.independent.co.uk/news/the-gangster-regime-we-fund-1278436.html>

47 Xhudo, Gus. “Men of purpose: The growth of Albanian criminal activity.” *Transnational Organized Crime* 2, no. 1 (1996): 1-20.

48 Andrew Gumbel, ‘Albania in crisis: Why has Europe turned a blind eye to the corruption that has poisoned a nation?’, *The Independent* 14 February 1997 <http://www.independent.co.uk/news/world/albania-in-crisis-why-has-europe-turned-a-blind-eye-to-the-corruption->

Korrupsioni policor vazhdoi të ngelej pothuaj i patrajtuar përgjatë viteve 1990 dhe masat e para filluan të merren vetëm në fillim të viteve 2000, me fillimin e proceseve integruese dhe shtimin e presionit ndërkombëtar. Përkundrejt këtij konteksti, edhe të dhënat deri diku sistematike mbi korrupsionin policor në Shqipëri filluan të shfaqen vetëm mbas kësaj periudhe.

Nga vlerësimi i të dhënat të sondazheve dhe indekseve të ndryshme të kryer në këto vite rezulton se perceptimi mbi shkallën e korrupsionit policor ka qenë vazhdimisht i lartë (Grafiku 2).



Grafiku 2. Shkalla e perceptimit të korrupsionit policor në Shqipëri sipas sondazheve të SELDI (2001, 2002), IDRA (2005, 49 2008 50 2009 51), IDM (2013) 52.

Sidoqoftë, në analizimin e korrupsionit policor bazuar mbi këto të dhëna duhet pasur parasysh fakti se ato mbështeten kryesisht në perceptime të publikut në ndërveprimin me administratën publike dhe kryesisht të fokusuar tek ryshfeti. Nga ana tjetër, ka pak të dhëna për forma të tjera të trajtuara, si korrupsion policor, ndërkohë që siç trajtohet në kapitullin për korrupsionin policor dhe llojet e tij, format dhe tipologjia korrupsionit policor janë të larmishme.

[that-has-poisoned-a-nation-1278494.html](http://that-has-poisoned-a-nation-1278494.html)

49 Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA, 'Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja' Sondazhi 2005

50 Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA, 'Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja' Sondazhi 2008

51 Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA, 'Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja' Sondazhi 2009

52 Anketim me qytetarët i realizuar në kuadër të këtij studimi (IDM 2013).



Sidoqoftë, me gjithë korrupsionin e përhapur policia nuk hyn ndër institucionet me besimin më të ulët të publikut, pavarësisht se ky fakt i atribuohet më shumë mungesës së besimit tek institucionet në përgjithësi sesa performancës së policisë. Në vitin 2009, publiku e perceptonte policinë si të tretën pas medias dhe shoqërisë civile në kontributin në luftën kundër korrupsionit (Media 63.6, Shoqëria civile 48.3, dhe Policia 45.5).<sup>53</sup> Po kështu policia nuk hynte tek institucionet me besimin më të lartë të publikut duke u rreshtuar e gjashta (me 47.8 nga 100 pikë) por linte mbrapa institucione të tjera të rëndësishme, si prokurorinë, qeverinë, parlamentin, etj.<sup>54</sup>

## 6. Vlerësim i literaturës mbi faktorët e korrupsionit Policor

Siç janë të shumëllojshme format e korrupsionit, po ashtu janë edhe shkaqet e devijimit, keqsjelljes apo korrupsionit policor . Nga ana tjetër, identifikimi i shkaqeve të korrupsionit është i rëndësishëm, pasi kontribuon në gjetjen e strategjive dhe mjeteve sa më të përshtatshme për ta trajtuar atë në mënyrë të përshtatshme. Pikërisht për këtë arsye shkaqet e korrupsionit përbëjnë një çështje mjaft të diskutuar nga studiuesit.

Për një kohë të gjatë korrupsioni policor shpjegohej me karakteristikat vetjake të punonjësve të policisë, të cilët përfshiheshin në korrupsion për shkak të sjelljes së punonjësve të policisë të pandershëm apo të kriminalizuar dhe dështimit të sistemit të rekrutimit dhe trajnimit.<sup>55</sup> Ky kuptim i korrupsionit ishte përcaktues edhe për qasjen ndaj trajtimit të korrupsionit, e cila bazohej në identifikimin dhe dënimin e individëve të korruptuar ose ndryshe të ‘mollëve të kalbura’.<sup>56</sup>

Komisionet hetimore të ngritura për të hetuar korrupsionin policor në departamente të policisë në SHBA gjatë viteve 1970 hodhën dritë mbi fakte të reja për shkaqet e korrupsionit.<sup>57</sup> Gjetjet e komisioneve hetimore vërtetuan se korrupsioni

53 Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA, ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja’ Sondazhi 2009

54 Instituti për Kërkime dhe Alternative Zhvillimi, IDRA, ‘Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja’ Sondazhi 2009

55 Newburn 1999: 14

56 Maurice Punch, ‘Rotten Orchards: “Pestilence”, Police Misconduct and System Failure’, *Policing and Society* 13, no. 2 (2003): 171–196.

57 Komisioni Knapp, që ishte një panel me pesë anëtarë për të hetuar rastet e përfolura të korrupsionit në polici, u krijua në prill të vitit 1970 për të hetuar korrupsionin në Drejtorinë e Policisë në Qytetin e Nju Jorkut. Komisioni i Krimit dhe Shkeljeve në Pensilvani u krijua në vitin 1978 dhe kishte si mision përmirësimin e sistemit penal të drejtësisë në Pensilvani.

policor vetëm në raste të rralla mund të shpjegohet nëpërmjet ‘mollëve të kalbura’. ‘Mollët e kalbura’ gjenden në ‘kosh’ apo në ‘pemë’, dhe janë ato të cilat lejojnë që mollët të kalben ose të ngelen të kalbura. ‘Mollët e kalbura’ dhe ‘koshat e kalbur’ shpesh gjenden brenda një mjedisi organizativ ose socio-politik më të gjerë.

Në rastet e policëve të korruptuar dhe organizatave policore neglizhente ose bashkëfajtoreshë është mjedisi ai që mjedisi luan një rol të madh duke mundësuar ekzistencën e korrupsionit dhe keqsjelljes, përfshirë edhe korrupsionin politik, ose ndryshe ‘pema e kalbur’, i cili mbështet korrupsionin e policisë.<sup>58</sup> Studimet e mëvonshme tregojnë për një dakordësi të përgjithshme se shkaqet e korrupsionit duhen kërkuar përtej modelit të ‘mollës së kalbur’.

## **6.1. Kombinimi i faktorëve PESTL**

Një qasje e gjerë është kombinimi i faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë dhe ligjore (PESTL), të cilët ndikojnë pozitivisht ose negativisht në nivelin dhe llojet e korrupsionit.<sup>59</sup>

*Faktorët politikë:* përfshijnë presionin mbi policinë nga politikanët (ekzekutivi, legjislativi, partitë politike) për të përfituar favore për veten e tyre dhe/ose të tjerët.

*Faktorët ekonomike:* presioni për favore dhe përfitime nga grupet ose lobet ekonomike. Korrupsioni që lidhjet me situata ekonomike të cilat e shtyjnë policinë të zhvatë ryshfete nga pjesëtarët e publikut.

*Faktorët sociale:* vlerat shoqërore janë të tilla që në masa të ndryshme e tolerojnë korrupsionin e institucioneve zyrtare.

*Faktorët ligjore:* boshllëqet ligjore, roli i gjyqësorit ndaj disa shkeljeve të caktuara mund të bëjë që policia të mos ndjekë zbatimin e ligjit. Po kështu vetë korrupsioni në gjyqësor mund të ketë pasoja për policinë

*Faktorët teknologjike:* teknologjitë dhe sistemet të cilat mund të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e formave të caktuara të korrupsionit.

## **6.2. Kombinimin i influencave strukturore dhe atyre kulturore**

Një qasje tjetër i lidh shkaqet e korrupsionit policor me kombinimin e (1) influencave strukturore dhe (2) influencave kulturore.<sup>60</sup> *Influencat strukturore* kanë të

58 Pierre Aepli, (Ed) ‘Pakoja e Instrumenteve mbi Integritetin e Policisë’, DCAF 2012

59 Po aty

60 Tim Prenzler 2009, f.20

bëjnë me faktin se shërbimet policore janë të strukturuar në mjedisin shoqëror dhe roli institucional i tyre u krijon mundësinë punonjësve dhe strukturave të policisë që të përfshihen në korrupsion.<sup>61</sup> Raportet ekonomike kërkesë ofertë me të cilat ndeshen shërbimet policore gjatë kryerjes së funksioneve të tyre krijojnë mundësinë si për korrupsion të individëve që ‘përfitojnë nga rasti’, ashtu edhe për korrupsion afatgjatë, kryesisht të njëjësive kundër trafikut të narkotikëve, prostitucionit, etj. Një aspekt strukturor është natyra e punës së punonjësve të policisë, të cilët gjenden të shpërndarë në terren, atje ku niveli i mbikëqyrjes së tyre është i ulët ndërsa shkalla a vendimmarrjes është e lartë. Për shembull, njësitë që merren me dhënien e licencave gjenden të përfshira në korrupsion të organizuar, për shkak të natyrës komplekse të proceseve të licencimit. Njësitë e hetimit të krimeve po ashtu gjenden të përfshirë në korrupsionin e proceseve gjatë mbledhjes së dëshmimeve dhe provave gjyqësore. Për shkak të vështirësisë për të përpunuar provat me të dyshuarit, sidomos gjatë proceseve të apelimit gjyqësor, punonjësit e policisë përpunon të gjejnë mënyra për të lehtësuar këto vështirësi nëpërmjet korrupsionit.

*Influencat kulturore* lidhen me kulturën organizative të shërbimeve policore, kulturë që lidhet ngushtë me sekretin dhe solidaritetin ndërmjet kolegëve.<sup>62</sup> Duke qenë se shërbimet policore janë organizata të mbyllura, heshtja, ose ‘muri blu i heshtjes’ është zhvilluar si një formë vetëmbrojtëse, e cila bazohet në rregullin e pashkruar për të mos i raportuar gabimet, shkeljet apo krimet e një kolegu. Kjo kulturë zhvillohet, pasi policët janë të varur nga njëri-tjetri për sigurinë dhe mirëqenien e tyre dhe nga kushtet e vështira ku ata punojnë, të cilat i ballafaqojnë shpesh me anët më të errëta të shoqërisë. Këto rrethana krijojnë shumë presion mbi ta dhe nxisin zhvillimin e solidaritetit mes kolegëve dhe për pasojë gënjeshtren apo mënyra të tjera si forma për të mbrojtur kolegët.<sup>63</sup> Praktika ka treguar se edhe kur teknikat e rekrutimit kanë funksionuar mirë, dhe për pasojë janë rekrutuar punonjës policie me standarde të larta, me kalimin e kohës këto standarde janë përkeqësuar.<sup>64</sup>

### 6.3. Kombinimi i faktorëve konstantë dhe të ndryshueshëm

Newburn sugjeron një qasje e cila bazohet në kombinimin e 13 faktorëve të ndarë në dy kategori, në (1) faktorë konstantë dhe (2) faktorë të ndryshueshëm. Faktorët konstantë janë ata faktorë të cilët krijojnë mundësinë për korrupsion ndërsa fak-

61 Pakoja 2012, f.21

62 Tim Prenzler 2009, f.23

63 Pierre Aepli, (Ed) ‘Pakoja e Instrumenteve mbi Integritetin e Policisë’, DCAF 2012. f.230

64 Prenzler 2009, f.24

torët e ndryshueshëm ndikojnë në shkallën e korrupsionit.<sup>65</sup>

Në faktorët konstantë hyjnë: *Liria e veprimit* që kanë punonjësit e policisë në ushtrimin e funksionit të tyre është një ndër më kryesorët. Format e punës së policisë, mjetet që u vihen në dispozicion dhe liria e veprimit për të marrë vendime nëse duhet të zbatojnë apo jo ligje të caktuara krijon mundësinë që vendimet e punonjësve të policisë të mund të motivohen prej përfitimit personal. Një aspekt tjetër i lirisë së veprimit qëndron tek ekzistenca e kontradiktave të brendshme dhe të jashtme mbi objektivat e policimit. Nga pikëpamja ligjore, objektivi i policimit është zbatimi i të gjitha ligjeve, por në praktikë gjithmonë vendosen prioritete se cilat ligje do të gjejnë zbatim primar. Meqenëse këto prioritete vendosen nga grupe të caktuara që evoluojnë vazhdimisht, prirja është që të krijohen koalicione (që mund përbëhen nga individë brenda dhe jashtë policisë) të cilët adoptojnë sjellje devijuese. Është pikërisht reagimi ndaj sjelljeve devijuese që përbën kufirin ndarës ndërmjet devijimit individual dhe organizativ.

*Vizibiliteti ulët i drejtuesve.* Meqenëse punonjësit e policisë janë të shpërndarë në terren, dhe siç u tha më sipër kanë liri veprimi në marrjen e vendimeve, është e vështirë për drejtuesit e policisë të kontrollojnë vendimet që marrin punonjësit e policisë. Në rastet kur edhe niveli drejtues është i korruptuar, atëherë mund të flitet edhe për mbështetje nga lart të praktikave devijuese, të cilat mund të përforcohen më tej nga vizibiliteti i ulët. Por edhe kur drejtuesit e policisë nuk e mbështesin sjelljen devijuese për shkak të vizibilitetit të ulët drejtues, ata mund të pranojnë suksese të punës policore edhe kur këto janë arritur nëpërmjet sjelljes devijuese, si për shembull përdorimi i tepruar i forcës, manipulimi i provave, etj.

*Vizibiliteti i ulët i publikut* gjithashtu ndikon në korrupsionin policor pasi një pjesë e mirë e punës së policisë zhvillohet përtej syve të publikut dhe policia ka në dispozicion hapësira të mbrojtura ku nuk mund të ketë akses askush tjetër, si skenat e krimit, prova të mbledhura, mallra të konfiskuara etj.

*Ruajtja e sekretit të grupit* është një tjetër faktor konstant dhe përbën një nga rregullat e pashkruara të njëjësive të korruptuara policore, të cilat e shfrytëzojnë këtë lloj sekreti për t'u mbrojtur nga ndikimet jashtë grupit të policëve të korruptuar por dhe për të mbajtur nivelin e korrupsionit në një nivel të caktuar. Ky lloj rregulli, i quajtur nga autorë të tjerë dhe '*muri blu i heshtjes*', është i vlefshëm edhe për ata punonjës policie, të cilët nuk pranojnë të përfshihen në veprimtari korruptive.

*Sekreti menaxherial.* Heshtja si pjesë e kulturës policore nuk kufizohet vetëm tek rangjet e ulta të policisë. Drejtues të policisë shpesh zgjedhin ta mbajnë sekret kor-

ruptionin me arsyetimin se bërsa publike e korrupsionit mund ta dëmtojë policinë më shumë sesa vetë korrupsioni.

*Statusi ekonomik i punonjësve të policisë shpesh përbën shkak për korrupsion që përfshin përfitimin material dhe financiar në rastet kur punonjësit e policisë paguhën në mënyrë të pabarabartë. Por pagat e ulta përbëjnë shkak për korrupsion në të gjitha nivelet e shërbimit policor në ato shoqëri, të cilat janë të orientuara nga konsumizmi ndërkohë që pagat janë të ulta.*

*Kontakti me shkelësit e ligjit. Interesi i organizatave kriminale për të ndërvepruar me policinë si mënyrë për të realizuar objektivat e tyre është një nga shkaqet kryesore të korrupsionit. Organizatat kriminale kanë mjete të konsiderueshme në dispozicion dhe nëpërmjet korrupsionit mund të fitojnë shumë më tepër se ç' mund të humbasin, kështu që presioni ndaj punonjësve të policisë është i lartë. Rreziku i korrupsionit bëhet akoma më i madh i kombinuar me lirinë e veprimit dhe vizibilitetin e ulët të drejtimit. Për këtë arsye, studiues të korrupsionit policor mendojnë se rreziku i krijimit të lidhjeve ndërmjet punonjësve të policisë dhe kriminelëve është i përhershëm.<sup>66</sup>*

Në faktorët e ndryshueshëm hyjnë: *Struktura e komunitetit*, ose konteksti në të cilin shërbimet policore operojnë. Ato kanë ndikim të madh në natyrën dhe stilin e punës së tyre, përfshirë dhe shkallën e përfshirjes në korrupsion. Mjedisi politik dhe kultura politike, toleranca apo në disa raste mbështetja e komunitetit ndaj korrupsionit, ndikojnë në shkallën e korrupsionit policor, i cili shihet tashmë si një praktikë legjitime.

*Veçoritë organizative janë një tjetër faktor i ndryshueshëm, i cili ndikon në shkallën e korrupsionit. Një institucion policie që bën gjithçka për të mbajtur moral të lartë, që nxit zhvillimin individual dhe profesional dhe që arrin të shmangë inatin, stresin dhe cinizmin dhe që nga na tjetër ndërton praktika dhe udhëzime që lidhen me etikën dhe integritetin ka më pak gjasa që të ketë probleme serioze me korrupsionin.*

*Mundësitë që lindin gjatë zbatimit të legjislacionit ndikojnë gjithashtu në shkallën e korrupsionit. Ka ligje të cilat kriminalizojnë aktivitete të cilat mund të mos gjejnë gjithmonë mbështetje të gjerë publike. Zbatimi i legjislacionit mbi prostitucionin, lojërat e fatit por edhe narkotikëve shpesh bëhen të pazbatueshëm, pasi numri i njerëzve që përfshihen në shkeljen e tyre është i madh dhe gjithmonë ka një vlerë mbi të cilën mund të negociohet. Për këtë arsye dekriminalizimi i disa*

66 Newburn 1999, f.21

veprave penale mund të ndikojë në uljen e shkallës së përfshirjes së punonjësve të policisë në korrupsion.

*Kontrolli i korrupsionit.* Është vënë re se struktura apo njësi policore, të cilat përballen me të njëjtin rrezik ndaj korrupsionit, kanë nivele të ndryshme korrupsioni në varësi të mekanizmave antikorrupsion. Kështu, dobësia institucioneve antikorrupsion, mungesa e financimit, e kapaciteteve dhe mbështetjes së nevojshme ndikojnë në shkallën e korrupsionit të një institucioni policie.

*Mënyra e organizimit të veprimtarive korruptive* të punonjësve të policisë përbën një faktor tjetër që ndikon në shkallën e korrupsionit. Aktet korruptive mund të jenë ose ‘ngjarje të veçuara’ ose ‘ujdi’. Në rastet kur përbëjnë ujdi aktet korruptive janë më të lehta të identifikohen dhe të trajtohen në mënyrë proaktive, pasi kryhen sipas disa rregullave. Por që kjo të ndodhë duhet që mekanizmat e kontrollit të korrupsionit të kenë vullnetin dhe mjetet e duhura për të luftuar aktet korruptive.

*Cinizmi moral.* Në punën e tyre të përditshme punonjësit e policisë ballafaqohen me raste të shumta të përfshirjes në veprime të pandershme dhe korrupsion jo vetëm të keqbërësve por edhe të njerëzve me reputacion të mirë. Me kalimin e kohës punonjësit e policisë zhvillojnë brenda vetes ndjenjën se korrupsioni është ‘një lojë në të cilën të gjithë janë të përfshirë dhe ku edhe policët duhet të marrin atë që u takon’. Një tjetër fushë, e cila ndikon në zhvillimin e cinizmit moral tek punonjësit e policisë, është vetë sistemi i drejtësisë, i cili nëpërmjet korrupsionit, padrejtësisë dhe mungesës së efektivitetit i shtyn ata drejt përcmimit të ligjit dhe përfshirjes në korrupsion, kryesisht në korrupsion procesesh.

## **6.4. Kombinimi i faktorëve individualë, organizativë dhe shoqërorë**

Një qasje tjetër sugjeron klasifikimin e shkaqeve të korrupsionit policor bazuar në kombinimin dhe ndërveprimin e faktorëve: (1) faktorët individualë, (2) faktorët organizativë, dhe (3) faktorët shoqërorë.<sup>67</sup>

Ndikimi i faktorëve individualë bazohet në premisën e studimeve kriminologjike sipas së cilës shpërndarja e prirjes ndaj shkeljes së ligjit në shoqëri është e çrregullt dhe individë të ndryshëm në shoqëri kanë prirje të ndryshme ndaj shkeljes së ligjit. Kjo do të thotë se edhe punonjësit të policisë, si pjesëtarë të shoqërisë, kanë prirje të ndryshme për të shkelur ligjin. Punonjës të policisë, të cilët para se të hynë në shërbimin policor kanë qenë të përfshirë në shkelje serioze të ligjit, kanë *prirje më*

67 Sanja Kutnjak Ivkovic, ‘Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption’, Oxford University Press, Sep 30, 2005, f.64-94

*të lartë ndaj korrupsionit.*

Një tjetër dimension është *prirja e individëve ndaj rreziqeve*. Njerëzit janë qenie racionale të cilët për çdo veprim që ndërmarrin përlllogarisin kostot dhe përfitimet. Meqenëse pasojat e kryerjes së një shkelje të ligjit përmbajnë përfitime dhe humbje, nëse përfitimi është më i madh, atëherë edhe gjasat e përfshirjes në shkelje të ligjit do të jenë më të larta. Në të njëjtën mënyrë, vendimi i disa punonjësve të policisë për t'u përfshirë në korrupsion është rezultat edhe i përlllogaritjes së rreziqeve nga ana e tyre. Sa më i lartë të jetë përfitimi nga kryerja e një veprimi korruptiv kundrejt përfitimit nga mos kryerja e një veprimi korruptiv, aq më e lartë do të jetë prirja e një punonjësi policie për t'u përfshirë në korrupsion.

Përveç faktorëve individualë, ka një sërë faktorësh organizativë që ndikojnë në korrupsionin policor.

*Një nga këtë faktorë është organizimi pothuaj ushtarak* i institucioneve të policisë *i cili përbën dhe një nga karakteristikat kryesore të tyre*. Me gjithë ndryshimet në modelet e policimit dhe theksin kohët e fundit ndaj policimit në komunitet, parimet e organizimit ushtarak vazhdojnë të jenë dominuese në institucionet policore. Njësoj si në ushtri, punonjësit e policisë i nënshtrohen proceseve të rekrutimit, trajnimit dhe mbikëqyrjes, për të brendësuar mënyrën e vendosjes së rregullave, të komunikimit dhe zbatimit, të cilat mund t'i nxisin ose pengojnë policët për të kthyer prirjen për korrupsion në veprim konkret korruptiv. Po kështu, edhe vepërmtaria tyre drejtohet nga një sërë rregulloresh dhe aplikohen parimet e hierarkisë dhe të sekretit. Për më tepër, njësoj si ushtria, policia ka të drejtën legjitime për përdorimin e forcës.

Një nga pasojat e organizimit pothuaj *ushtarak* të policisë është të marrja e një qëndrimi armiqësor ndaj publikut, i cili shihet si kundërshtar. Një pasojë që mund të rezultojë nga kjo është përdorimi i tepruar të forcës. Një tjetër pasojë është vështirësia në zbatimin me përpikmëri të të gjitha rregullave, ndërkohë që gjatë karrierës së tyre të gjithë policët gjenden në situata ku ata mund t'i shkelin rregullat. Në këtë mënyrë, pashmangshmëria praktike e shkeljes së rregullave i bën punonjësit e policisë që të zhvillojnë një shkallë tolerance ndaj shkeljes së rregullave.

*Udhëheqja*. Pavarësisht ligjeve dhe rregullave kufizuese, në praktikë drejtuesit e policisë kanë pushtet dhe kompetenca kontrolluese të rëndësishme. Ata mund të ndikojnë në standardet e rekrutimit, mekanizmat e kontrollit të brendshëm, disiplinën dhe shpërblimet. Ka një dakordësi të gjerë për faktin se qëndrimi i drejtuesve të policisë ndaj korrupsionit është përcaktues në efektivitetin e adresimit të këtij

problemi. Edhe pse drejtuesit e policisë mund të mos dalin hapur në mbrojtje të korrupsionit, ata mund të zgjedhin që të mos flasin kundër korrupsionit, ta mohojnë atë, apo të marrin në mbrojtje policë të korruptuar. Po kështu, në procesin e planifikimit një drejtues mund ta vendosë luftën kundër korrupsionit ndër prioritetet e ulta të punës.

*Burimet.* Vendimet për madhësinë e buxhetit dhe mënyrën e shpenzimit të tij mund të kenë ndikim në luftën kundër korrupsionit. Për shembull, nëse gjatë procesit të rekrutimit burimet në dispozicion janë të pamjaftueshme atëherë personeli i ngarkuar me këtë funksion mund të jetë i mbingarkuar dhe të bëjë zgjidhje të caktuara që anashkalojnë procedurat. Po kështu, drejtuesit mund të mos kenë burime të mjaftueshme për të mbikëqyrur këtë proces. Burimet e pamjaftueshme mund të ndikojnë edhe në veprimtarinë dhe efektivitetin e njësive të kontrollit të brendshëm.

*Rregullat që lidhen me korrupsionin.* Për të rregulluar veprimtarinë e tyre shërbimet policore miratojnë rregulla, të cilat shpesh shkojnë deri në detajet më të vogla. Megjithatë, këto rregulla mund të mos jenë të qarta dhe studimet kanë treguar sa ekziston një lidhje e qëndrueshme ndërmjet qartësisë së rregullave antikorrupsion dhe korrupsionit. Por nga ana tjetër, edhe kur rregullat mund të jenë formuluar dhe komunikuar qartë, rregulla joformale të terrenit mund të mbizotërojnë mbi ato të shkruara. Kështu, edhe kur rregullat shkruajnë se punonjësit e policisë nuk duhet të pranojnë dhurata nga publiku rregullat e pashkruara për atë se çfarë përbën favor mund të jenë të interpretueshme.

*Rekrutimi dhe përzgjedhja.* Përveç problemeve që lidhen me kontrollin e paefektshëm, mbikëqyrjen e dobët, etj., është vënë re se shërbimet policore që kanë dështuar në mënyrë të vazhdueshme në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit kanë edhe korrupsion më të përhapur, etj. Në disa nga dështimet e procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes përfshihen mungesa në kriteret e përzgjedhjes të treguesve mbi prirjet për shkeljen e ligjit nga aplikanti, vendosja e më shumë theksit tek cilësitë e duhura për të kryer punën e punonjësit të policisë duke anashkaluar kriteret e vlerësimit të integritetit dhe ndershmërisë, etj.

Mungesa ose papërshtatshmëria e programeve të *trajnitit të etikës dhe integritetit*, si një nga elementët kryesorë të edukimit policor, i cili i përgatit rekrutët e rinj për të përballuar dilemat etike me të cilat ata pritet të përballen në punën e tyre dhe që komunikon si pritshmëritë ndaj tyre ashtu edhe pasojat për sjellje devijuese. Programet e trajnitit të etikës mund të jenë të papërshtatshme për *mënyrën se si*



*janë konceptuar.* Së pari ato mund të jenë mbi koncepte të papërshtatshme, si për shembull mbi konceptin e ‘mollës së kalbur’. Së dyti, programet mund të jenë ndërtuar vetëm si leksione teorike duke mos përfshirë module të ndërveprimit në praktikë në situata të ndryshme. Së treti, ato mund të jenë konceptuar vetëm si trajnim në kurset fillestare dhe jo përgjatë gjithë karrierës dhe të përshtatura me situata nga jeta reale.

*Kolegët.* Për shkak të natyrës së punës punonjësit e policisë kanë prirje të zhvillojnë ndjesinë e izolimit nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe perceptimin se askush nuk i kupton ata. Ky perceptim shoqërohet me ndjenjën e mosbesimit ndaj pjesëtarëve të komunitetit dhe solidaritetin ndaj kolegëve policë, të cilët janë të vetmit me të cilët mund të kuptohen. Në formën më të lartë kjo ndjenjë merr formën e kodit të heshtjes – ose ‘murit blu të heshtjes’ – si një nënkulturë e cila në thelb ka mosraportimin e kolegëve. Kodi i heshtjes transmetohet në mënyrë të vazhdueshme nga policët më të vjetër tek rekrutët më të rinj në formën e shoqërizimit. Në këtë mënyrë, kodi i heshtjes bëhet pjesë e pandashme e kulturës policore dhe për pasojë edhe punonjësit e ndershëm të policisë vendosin të mos e raportojnë korrupsionin, pasi e shohin raportimin si më të urryer se vetë korrupsionin. Megjithëse shkalla e kodit të heshtjes mund të ndryshojë në varësi të shërbimeve policore apo edhe njësive policore, kodi i heshtjes është më i përhapur në ato njësi apo shërbime policore që kanë shkallë më të lartë korrupsioni.

*Eprorët.* Një nga ndikimet e organizimit ushtarak të policisë është ndikimi i eprorëve mbi vartësit. Eprorët e linjës, të cilët janë ajo pjesë e administratës policore që ka dhe përgjegjësitë më të shumta mbikëqyrëse, luajnë një nga rolet kryesore në frenimin e perceptimeve mbi korrupsionin nga ana e punonjësve të policisë. Gjetjet e komisioneve hetimore dhe studimet kanë treguar se eprorët të linjës shpesh i nënshtrohen rregullave informale dhe ose bëhen pjesë e korrupsionit dhe përfitojnë prej tij, ose e kanë të vështirë të disiplinojnë kolegët me të cilët deri pak kohë më parë kanë ndarë të njëjtat vlera dhe me të cilët edhe mund të jenë përfshirë në shkelje të rregullave. Për rrjedhojë, eprorët e linjës kanë pak arsye që të hetojnë dyshimet për korrupsion dhe të dënojnë rregullisht dhe në vazhdimësi policët e korruptuar.

Por edhe në rastet kur nuk janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në korrupsion, eprorët mund të ndikojnë negativisht duke krijuar një mjedis që e toleron korrupsionin ose duke mos arritur që të mbajnë një qëndrim serioz dhe të reagojnë apo marrin masat e duhura.

*Sistemi i kontrollit të brendshëm.* Sistemi i kontrollit të brendshëm në përgjithësi përfshin strukturat për marrjen e ankesave, të hetimit dhe vendimmarrjes. Kur një shërbim policor karakterizohet nga korrupsioni i përhapur dhe i organizuar, ky shërbim ka pësuar një rrënim të përgjithshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në këto raste, edhe vetë sistemi i kontrollit të brendshëm është i përfshirë në korrupsion. Dështimet e sistemit të kontrollit të brendshëm shpesh janë pasojë e mosveprimit pa paramendim nga drejtuesit e policisë dhe njësive të kontrollit por edhe pasojë e përpjekjeve me paramendim për t'i bërë më të vështira hetimin dhe zbulimin e korrupsionit.

*Faktorët shoqërorë.* Çdo shërbim policor në mënyrë të pashmangshme është pjesë e mjedisit më të gjerë politik dhe shoqëror. Cilësitë e këtij mjedisi ndikojnë në nivelin/shkallën e korrupsionit policor në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Në të njëjtën kohë, edhe mjedisi më i gjerë mund të ndikohet nga korrupsioni në shërbimin policor në shumë mënyra, si për shembull mospranimin të ryshfetit nga qytetarët apo nëpërmjet hetimit më efektiv të korrupsionit në sektorë të tjerë.

*Mundësia për korrupsion* është një nga faktorët e jashtëm që ndikon në korrupsionin policor. Jeta e shtrenjtë dhe pagat e ulta dhe mundësia për të ndërvepruar me qytetarët janë disa nga shkaqet që i nxisin punonjësit e policisë të korruptohen për përfitime financiare apo materiale.

*Pikëpamjet e publikut mbi korrupsionin* gjithashtu mund të kontribuojnë në rritjen apo uljen e shkallës së korrupsionit policor. Edhe kur parlamentet miratojnë ligje që ndalojnë sjellje të caktuara, ato ligje nuk gjejnë zbatim, nëse publiku i gjerë nuk i miraton ato dhe për pasojë krijon kërkesë për korrupsion, shprehimisht apo duke e nënkuptuar. Shërbimet policore dhe publiku shpesh gjenden në konfuzion edhe prej standardeve të dyfishta të cilat e pranojnë bakshishin për disa shërbime dhe disa profesione (si kamerierët, berberët, etj) duke bërë që segmente të caktuara të shoqërisë ta shohin si të justifikueshëm shpërblimin kundrejt shërbimit edhe për policinë. Kështu, pronarët e bareve, restoranteve e shohin si një mënyrë normale të të bërit biznes duke i ofruar shpërblim punonjësve të policisë për shërbimin e sigurisë që ata kryejnë.

*Niveli i korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe më gjerë në shoqëri.* Punonjësit e policisë janë pjesëtarë të shoqërisë dhe të shoqërizuar me normat e saj. Kur një shoqëri e pranohet ryshfetin si normë dhe formë shpërblimi për shërbime të ndryshme është e vështirë për punonjësit e policisë ta refuzojnë atë, pasi qytetarët mund të mendojnë se nuk janë duke paguar mjaftueshëm ose sepse polici mund të

jetë duke u sjellë djallëzisht. Për më tepër, kur korrupsioni është i përhapur gjerësisht në sistem, gjasat janë që vetë policët të jenë rekrutuar dhe ngritur në detyrë mbi baza të lidhjeve politike apo nëpërmjet ryshfetit. Në kushte të tilla, punonjësit e policisë mund të shpëtohen prej këtyre normave vetëm nëse do të perceptohen nga vetë ata dhe shoqëria si njësi elitare me integritet të lartë.

*Mekanizmat e kontrollit të jashtëm* përfshijnë institucione si legjislativi, institucionet e pavarura të auditit, të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, prokurorinë, mediat dhe shoqëria civile. Nëse këto mekanizma do të funksiononin siç duhet, ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm, pasi i tregojnë punonjësve të policisë rreziqet me të cilat mund të përballen nëse përfshihen në korrupsion. Por nëse niveli i korrupsionit është i lartë dhe në fund të fundit numri i punonjësve të policisë që janë dënuar është i ulët, atëherë kjo tregon se mekanizmat e jashtëm të kontrollit nuk janë duke funksionuar siç duhet.<sup>68</sup>

## 6.5. Faktorë të tjerë

Por ka dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në llojet dhe shkallën e korrupsionit si faktorë *historikë* apo *gjeografikë*. Në SHBA, korrupsioni policor është trashëgimi e penetrimit të organizatave policore nga pushteti lokal me dhe kryetarët e bashkive të lidhur me organizatat kriminale që kontrollojnë lojërat e fatit, prostitucionin dhe trafikun e narkotikëve. Në vendet e Evropës veriore korrupsioni policor lidhet më së shumti me përpjekjet e organizatave policore për të shpënë përpara drejtësisë kriminelet me çdo kusht duke u përfshirë në korrupsionin në procese.

Në vendet postkomuniste korrupsioni policor lidhet me ndryshimet e thella jo vetëm politike por edhe ekonomike si dhe me boshllëkun moral që u krijua me rënien e falsitetit të ideologjisë komuniste.<sup>69</sup>

Pozita gjeografike e një vendi ndikon gjithashtu në korrupsionin policor kur një vend ndodhet në rrugët e tranzitit pasi i ekspozon forcat policore ndaj mundësive që ofrohen për korrupsion në pikat e kalimeve kufitare dhe përgjatë rrugëve të transportit. Edhe flukset e emigrantëve të paligjshëm përbëjnë një nga shkaqet kryesore të përfshirjes së policisë në korrupsion në këto vende. Po kështu punonjësit e policisë në qytetet turistike apo qendra të mëdha urbane janë të ekspozuar më shumë ndaj rrezikut të korrupsionit.

68 Sanja Kutnjak Ivkovic, 'Fallen Blue Knights: Controlling Police Corruption', Oxford University Press, Sep 30, 2005, f.64-94

69 Pierre Aepli, (Ed) 'Pakoja e Instrumenteve mbi Integritetin e Policisë', DCAF 2012. f.46

## 7. Vlerësim i kuadrit antikorrupsion për PSH në Shqipëri

Ky kapitull vlerëson masat anti-korrupsion, ku përfshihen strategjia antikorrupsion, legjislacioni, kapacitetet administrative dhe rezultateve të arritura në luftën antikorrupsion, burimet e vëna në dispozicion si dhe kontrolli dhe mbikëqyrja e këtij sistemi.

Vlerësimi është kryer duke u mbështetur në *përshtatshmërinë, efikasitetin, efikasitetin, dhe qëndrueshmërinë* e masave anti-korrupsion, kriteret të gjeneruar dhe të aplikuara nga Banka Botërore.<sup>70</sup> Në këtë kuadër *përshtatshmëria* i referohet masës në të cilën masat anti-korrupsion janë të përshtatshme për të arritur objektivat në kontekstin ligjor institucional dhe politik të vendit. *Efikasiteti* i referohet masës në të cilën objektivat e përcaktuara janë arritur ose pritet të arrihen, duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre relative. *Eficienta* i referohet uljes në masë të konsiderueshme të korrupsionit me koston më të ulët,<sup>71</sup> dhe *qëndrueshmëria* i referohet masës në të cilën masat antikorrupsion kanë krijuar rezistencë ndaj korrupsionit në nivel afatgjatë dhe kanë sjellë ndryshime në mënyrën se si zyrtarët publik e perceptojnë llogaridhënien.<sup>72</sup>

Vlerësimi mbështet në analizën e të dokumenteve strategjike, akteve ligjore dhe nënligjore, të dhënave nga raporte të institucioneve shqiptare dhe ndërkombëtare, si dhe të anketave dhe sondazheve të kryera dhe intervistave.

### 7.1. Vlerësimi i kornizës së politikave antikorrupsion

#### 7.1.1. Strategjia Kombëtare 2008-2013

Dokumenti më gjithëpërfshirës i politikës shtetërore antikorrupsion është ‘Strategjia ndërsektoriale për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente, 2008-2013’ (në vijim Strategjia Kombëtare). Përpara miratimit të kësaj strategjie, politikat antikorrupsion kanë qenë kryesisht sektoriale dhe nuk ka pasur ndonjë dokument apo qasje strategjike ndaj problemit të korrupsionit.

70 Jeff Huther & Anwar Shah, “Anti-corruption Policies and Programs: A framework for Evaluation”, Policy Research Working Paper 2501, World Bank, Washington, 2000, p.8

71 Ibid., pp.10-11

72 Ibid., p.11

Strategjia kombëtare është miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2008 si një instrument politik shumëvjeçar (për periudhën 2008-2013) me qëllimin për të adresuar problemin e korrupsionit në nivel politik dhe sektorial. Strategjia kombëtare bazohet në një qasje të trefishtë: (1) parandalimin, (2) hetimin dhe dënimin, dhe (3) llogaridhënien dhe monitorimin, si dhe përfshin një listë me reforma sektoriale thelbësore. Vizioni i Strategjisë kombëtare është *‘reduktimi progresiv e i qëndrueshëm i korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje’*.

Megjithëse Strategjia kombëtare shënon një përpjekje të mëtjshme për të adresuar problemin e korrupsionit, vlerësimi *a posteriori* i saj tregon se kontributi ka qenë minimal ose i papërfillshëm.

Disa nga mangësitë kryesore të Strategjisë kombëtare, të vëna në pah edhe nga raportet ndërkombëtare, janë mungesa e burimeve të mjaftueshme për zbatimin e saj, mungesa e treguesve të matshëm dhe mungesa e mekanizmave realiste të zbatimit si dhe afatet kohore të zbatimit.<sup>73</sup>

Por përveç sa më sipër, një nga dështimet kryesore të Strategjisë kombëtare është mungesa e adresimit të shkaqeve themelore të korrupsionit. Kjo përbën një mangësi thelbësore në miratimin e strategjive antikorrupsion pasi nuk mund të ndërmerren masa të përshtatshme nëse shkaqet e korrupsionit dhe format e ndryshme të tij nuk njihen ose injorohen.<sup>74</sup> Në këtë aspekt Strategjia kombëtare duhet të ishte paraprirë nga një vlerësim më i thelluar i kontekstit dhe rreziqeve specifike të korrupsionit në Shqipëri. E miratuar tre vjet pas ardhjes në pushtet nga qeveria e koalicionit të udhëhequr nga Partia Demokratike, Strategjia kombëtare e trajton korrupsionin si një problem i lidhur pothuaj tërësisht me qeverinë paraardhëse.

Strategjia kombëtare në fakt përmend sektorë me shkallë të lartë korrupsioni si shëndetësia, arsimit dhe drejtësia por nuk shtjellon rrethanat specifike se përse korrupsioni është i lartë në këta sektorë. Po kështu nuk ka të dhëna mbi karakteristikat specifike territoriale ose kulturore të vendit, apo qasjes së qytetarëve dhe sjelljes së tyre ndaj korrupsionit. Mostrajtimi i këtyre elementëve shpie në përfytyrimin e një realiteti të tjetërsuar dhe për pasojë edhe në miratimin e masave joefikase antikorrupsion .

Në lidhje me policinë, Strategjia kombëtare pranon vlerësimet e raporteve

73 Commission of the European Communities, Commission Staff Working Document, Albania 2009 Progress Report

74 Sanjay Pradhan, “Anticorruption in Transition. A Contribution to the Policy Debate”, World Bank, Washington D.C., 2000

ndërkombëtare për nivelin e lartë të korrupsionit, ku policia identifikohet ndër sektorët më të korruptuar së bashku me doganat, tatimet, gjykatat dhe shëndetësinë. Për më tepër Strategjia kombëtare parashikon rolin thelbësor të policisë në hetimin dhe dënimin e korrupsionit, si dhe parashikon rritjen e mekanizmave të kontrollit e të vetëkontrollit të strukturave të policisë.

Prirja e përgjithshme e strategjisë është fokusi tek sektorë të veçantë dhe zgjidhjet teknike standarde - si miratimi i kuadrit ligjor - ndërsa mungon vlerësimi i kapaciteteve dhe forcimi i llogaridhënies. Kjo dobësi vërehet edhe në vlerësimet e raporteve të BE ku theksohet ‘zbatimi i pjesshëm i kuadrit ligjor’.<sup>3</sup> Po kështu, këto raporte vendosin theksin mbi dimensionin politik të korrupsionit kur nënvizojnë se ‘institucionet shtetërorë që janë të përfshira në luftën kundër korrupsionit nge-len të dobëta ndaj influencës dhe presionit politik’.<sup>4</sup>

Për më tepër, një strategji efikase për të luftuar korrupsionin duhet të marrë parasysh edhe se si forma të ndryshme të korrupsionit lehtësojnë ose pengojnë kapacitetet e shtetit në zbatimin e reformave të nevojshme. Ky element mungon në strategjinë kombëtare antikorrupsion pasi në fazën e hartimit mund të kishte qenë më e përshtatshme të vlerësohej prirja e llojeve të korrupsionit (si p.sh. korrupsioni politik, korrupsioni administrativ, etj.) sesa vlerësimi sipas shkallës së renditjes globale në perceptimin e korrupsionit (p.sh. strategjia kombëtare mbështetet fort në premisën se Shqipëria në krahasim me vitin 2005 kur vendosej në grupin e 24 vendeve më të korruptuara në vitin 2008 që kishte lënë prapa 95 vende të botës).

Me gjithë mangësitë e identifikuara, një nga aspektet më të vlerësuara të strategjisë kombëtare është shprehja e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin. Sidoqoftë, edhe ky dimension është kompromentuar nga mospërputhja ndërmjet retorikës politike dhe realitet në terren. Kështu korrupsioni është përdorur si mjet në fushatat elektorale – me gjithë deklaratimet e përsëritura kundër korrupsionit - dhe qeveria është përpjekur të manipulojë të dhënat për të treguar që korrupsioni nuk ekziston.<sup>6</sup>

Kjo tregon nivelin e lartë të korrupsionit politik i cili sipas Transparency International ‘përbën një nga problemet më serioze të vendit dhe një pengesë kryesore për integrimin e mëtejshëm të vendit drejt BE’.<sup>75</sup>

Në përfundim mund të thuhet se Strategjia antikorrupsion është e papërshtatshme për të adresuar sfidat e vendit në luftën kundër korrupsionit pasi nuk është në përputhje me mjedisin dhe karakteristikat specifike të tij, sikurse ekziston një mo-

75 Matthew Jenkins, ‘Albania: Overview of Political Corruption’, Transparency International, 2014

spërputhje ndërmjet prioriteteve dhe sfidave të perceptuara. Ky dështim lidhet deri në një masë të caktuar me përcaktimin jo realist të prioriteteve, ndërkohë që është shmangur tërësisht vlerësimi i shkaqeve të korrupsionit. Për më tepër, strategjia kombëtare mbështetet në deklarime të përgjithshme si ‘për suksesin e mëtejshëm të luftës kundër korrupsionit janë të domosdoshme zbatimi me rigorozitet i kuadrit ligjor ekzistues, konsolidimi i të gjitha institucioneve të kontrollit administrativ dhe gjyqësor’ të cilat nuk janë masa të mjaftueshme dhe vetë-përmbushëse, që çojnë automatikisht në uljen e korrupsionit .

### 7.1.2. Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013

Policia e Shtetit miratoi për herë të parë një strategji afatgjate për periudhën 2007-2013 me synimin e garantimit të zbatimit të ligjit, rritjes së *performancës së strukturave të Policisë*, duke përdorur forma bashkëkohore të vlerësimit të performancës policore, dhe ndryshimit të mendësisë drejtuese nëpërmjet aplikimit të koncepteve moderne të menaxhimit.

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie 7-vjeçare konsiston në forcimin e pozitës së drejtpërdrejtë të Policisë së Shtetit në luftën ndaj krimit në tërësi dhe në parandalimin e goditjen e fenomenit të korrupsionit.

Në linja të përgjithshme Strategjia e Policisë ndjek një përjasje reaguese ndaj krimit në vend dhe kjo vërehet në përmendjen e vazhdueshme të nevojës për një rritje të performancës së Policisë në fushën e evidentimit dhe raportimit të veprimtarive kriminale, sikurse për një “përmirësim të mënyrës dhe metodikës së raportimit të krimit nëpërmjet formimit të statistikave të sakta, në raport dhe me institucionet e tjera të drejtësisë, pasi ky fenomen ndikon ndjeshëm dhe në besimin e publikut tek policia”.<sup>76</sup>

Meqenëse kjo strategji identifikon prioritetet kryesore në përputhje me ligjin e Policisë së Shtetit, politikat e Qeverisë si dhe me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, *atëherë në listën e prioriteteve të identifikuar, korrupsioni duhej të zinte një vend kryesor. Në fakt, lufta ndaj korrupsionit lakohet vetëm në vazhden e luftës kundër pastrimit të parave dhe krimeve ekonomiko-financiare. Korrupsioni përmendet vetëm si një faktor me ndikim negativ në zhvillimin ekonomik të vendit dhe “lufta ndaj tij kërkon një zhvillim të koordinuar të masave gjurmuese policore, sigurimit të provave ligjore dhe sekuestrimit të*

76 Policia e Shtetit – Shqipëria, “Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013”, Tiranë, 2007, fq. 15.

pasurive që rrjedhin nga veprimtari të tilla”.<sup>77</sup>

Ndërkohë që Policia e Shtetit është ndër institucionet kryesore në luftën ndaj korrupsionit në nivel kombëtar dhe duke pasur parasysh shkallën e lartë të korrupsionit në polici, në Strategjinë e Policisë lufta ndaj korrupsionit policor duhet të përbënte një nga prioritetet kryesore, pasi një polici më nivel të lartë korrupsioni nuk mund të jetë e efektshme në luftën ndaj korrupsionit në sektorë të tjerë.

Nga ana tjetër, Strategjia e Policisë krijon konfuzion, pasi pothuaj nuk i ndan krimin e organizuar dhe korrupsionin, ndërkohë që, megjithëse të dy këto fenomene mund të shkaktojnë pasoja të ngjashme, ato përbëjnë dy fenomene krejt të ndryshme dhe që *zgjidhen me mjete të ndryshme*.

Si përfundim, mund të thuhet se duke mos e trajtuar korrupsionin policor dhe luftën kundër korrupsionit në polici si problem parësor, Strategjia e Policisë është e një dokument jo i përshtatshme në këtë drejtim.

### **7.1.3. Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit 2009-2014**

Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit 2009-2014 (në vijim plani kombëtar) shpreh një vizion më të qartë mbi nevojën e luftimit të fenomenit të korrupsionit në vend. Plani kombëtar vendos si qëllim “reduktimin progresiv e të qëndrueshëm të korrupsionit, ndjekur nga forcimi i integritetit të institucioneve dhe ndryshimin rrënjësor të mendësisë qeverisëse”.

Plani kombëtar trajton luftën ndaj korrupsionit në mënyrë një-dimensionale, pra vetëm mjedisin e tij të brendshëm, me një fokus unik mbi institucionin e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm (SHKB). Në fakt, SHKB ngarkohet me detyrën e “konsolidimit, pastërtisë dhe shëndoshjes së efektivit policor, duke larguar prej saj punonjës të veçantë policie nga strukturat e Policisë së Shtetit, të cilët kryejnë veprime të kundërligjshme dhe korruptive, duke cenuar etikën dhe imazhin e policisë, si ruajtëse e rendit dhe sigurisë publike, për ta bërë atë më efektive, të besueshme dhe më pranë problemeve të komunitetit”.<sup>78</sup>

Por ndërsa plani kombëtar i jep një rëndësi primare SHKB-së dhe hetimit të veprave kriminale të kryera nga punonjësit e policisë ndërmarrja e masave parandaluese zë një vend të vogël edhe pse kjo qasje reaguese ndaj korrupsionit bie ndesh

<sup>77</sup> Policia e Shtetit – Shqipëria, “Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013”, Tiranë, 2007, fq. 19.

<sup>78</sup> Këshilli i Ministrave, “Plani kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit 2009-2014”, Tiranë, 2009, fq. 40-41.



me vetë rekomandimet e Komisionit Evropian, i cili rekomandon forcimin dhe zbatimin e masave proaktive.

Më tej, Plani kombëtar specifikon në mënyrë të detajuar prioritetet dhe masat që do të ndërmerren në një periudhë kohorë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Por disa prej këtyre prioritetëve bien ndesh me aktivitetet e tyre zbatuese. Nëse prioriteti afatshkurtër është “forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit”, aktivitetet zbatuese (Tabela 4) – kryesisht trajnime të punonjësve të SHKB nuk ka gjasa të sigurojnë një zbatim efektiv të këtij prioriteti, sepse forcimi i masave parandaluese, dhe si rrjedhim rritja e integritetit, duhet të aplikohen fillimisht në radhët e punonjësve të policisë.

Sikurse përmendet në planin kombëtar, krijimi i Drejtorisë së Inspektimit, si një strukturë administrative të shërbimeve mbështetëse me personel tërësisht civil, do të lejojë inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit dhe nëpërmjet tyre do të matet efektivitetit dhe efikasiteti i punës së policisë. Ndërkohë, hartimi i kodit të etikës dhe sjelljes anti-korrupsion për punonjësit e Policisë së Shtetit përbën një prioritet afatgjatë, pra do adoptohet pas rreth 4 vitesh nga adoptimi i vet planit kombëtar. Deri atëherë, roli i Drejtorisë së Inspektimit në forcimin e efektivitetit dhe efikasitetit të punës së policisë shihet si tejet i kufizuar.

Përparësitë e përcaktuara nga plani kombëtar do të duhet të fillonin më hartimin e kodit të etikës për punonjësit e policisë dhe të mbaronin me forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të SHKB-së. Kjo skemë e sugjeruar do të mundësonte një forcim të integritetit midis punonjësve të policisë dhe do t'i lehtësonte Drejtorisë së Inspektimit ndarjen e ‘mollëve të kalbura’ mes këtyre efektiveve.

Si përfundim, skema e parashikuar nga Plani kombëtar për të luftuar korrupsioni nuk sjell ndonjë vlerë të shtuar dhe nuk mund të konsiderohet si relevante.

<b>Lufta kundër korrupsionit</b>			
	<b>Prioritetet</b>	<b>Nismat Ligjore</b>	<b>Aktivitetet Zbatuese</b>
<b>Afat-shkurtra (2009-2010)</b>	<p>Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit;</p> <p>Zbatimi i legjislacionit për parandalimin e korrupsionit, duke u mbështetur siç duhet në bashkërendimin ndër-institucional;</p> <p>Për parandalimin e korrupsionit, duhet të organizohen programe trajnimi për zyrtares përkatës.</p>	<p>Hartimi dhe miratimi i VKM për shtimin e strukturës së inspektimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHKB</p> <p>Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen gjatë kryerjes së “testit të integritetit” të punonjësve të Policisë së Shtetit;</p>	<p>Zbatimi i dy llojeve të “testit të integritetit”, testit të rastësishëm dhe atij të planifikuar.</p> <p>Trajnimi 2-javor me temë “Hetimet e kontrollit të Brendshëm dhe inspektimet në lidhje me respektimin e akteve në fuqi”.</p> <p>Pjesëmarrja e SHKB-së në aktivitete (forume rajonale dhe ndër-rajonale, seminare e konferenca) kombëtare dhe ndërkombëtare në trajtimin dhe analizimin e çështjeve që lidhen me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.</p> <p>Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të SHKB, mbi hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe përdorimin e teknikave dhe mjeteve speciale të hetimit.</p>

<b>Lufta kundër korrupsionit</b>			
	<b>Prioritetet</b>	<b>Nismat Ligjore</b>	<b>Aktivitetet Zbatuese</b>
<b>Afat-mesme (2011-2012)</b>	<p>Të përmirësohet dukshëm infrastruktura logjistike e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm;</p> <p>Të rritet përdorimi i mjeteve speciale të hetimit, interceptimi i telekomunikimeve dhe përdorimi i informacionit të inteligjencës;</p>	<p>Hartimin e një Urdhri të Ministrit të Brendshëm “Për krijimin e një rrjeti të brendshëm ndërlidhjeje të agjenteve operacionale të SHKB”.</p> <p>Hartimin e një Urdhri të Ministrit të Brendshëm “Për lejimin e informatizimit tërësor të informacioneve që disponohen nga ky shërbim”.</p>	<p>Krijimin e një rrjeti të brendshëm për ndërlidhjen e agjenteve operacionale të SHKB.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve të grumbullimit dhe analizimit të informacionit nga njësitë e analizës së këtij shërbimi.</p>
<b>Afat-gjata (2013-2014)</b>	<p>Të arrihen rezultate të dukshme në luftën kundër korrupsionit të evidentuar në të gjitha strukturat e Policisë Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme;</p> <p>Rritjen e sensibilizimit të punonjësve të policisë së shtetit në lidhje me shkaqet dhe masat parandaluese për veprat korruptive.</p>	<p>Hartimi i Kodit të Etikës dhe sjelljes anti-korrupsionit për punonjësit e policisë së shtetit.</p>	<p>Sensibilizimi i punonjësve të policisë, pasurimi i materialeve të përgjithshme arsimore, lidhur me temën e korrupsionit;</p> <p>Krijimin e temave dhe dhënie leksionesh punonjësve të policisë, në qendrat e trajnimit, për fushën e parandalimit të korrupsionit.</p>

Tabela 4. Masat e parashikuara për SHKB-në nga plani kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asocimit 2009-2014.

## 7.2. Kuadri Ligjor

Veprimtaria e Policisë së Shtetit rregullohet nga një paketë aktesh ligjore dhe nënligjore të miratuara gjatë periudhës 1998–2008. Ligji themelor që parashikon organizimin dhe funksionimin e Policisë në Shqipëri është ligji për Policinë e Shtetit,<sup>79</sup>

79 Ligji nr. 9749, date 4.6.2007 ‘Për Policinë e Shtetit’, Nenet 1 dhe 6. dhe Neni 1, Ligji Nr. 9749, date 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

ndërsa kuadri bazë forcimin e integritetit dhe për të luftuar korrupsionin janë ligji për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, Ligji për Kodin e Etikës së Policisë si dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për rregulloren e disiplinës dhe të personelit (Figura 4).<sup>80</sup>

Ligji për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme është ligji bazë për të luftuar korrupsionin në Policinë e Shtetit (PSH).<sup>81</sup> Ligji parashikon si mision bazë të SHKB që ‘t’i garantojë komunitetit një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent’.<sup>82</sup> Sipas ligjit, SHKB ka kompetenca si për parandalimin ashtu edhe për zbulimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e PSH. Përveç kësaj, SHKB është përgjegjëse edhe për të inspektimin e zbatimit të ligjeve nga PSH, ‘për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre’.<sup>83</sup>



Figura 4: Kuadri ligjor dhe nënligjor bazë i Policisë së Shtetit

Megjithatë ligji për SHKB nuk i referohet në veçanti korrupsionit si problem për t’u trajtuar. Ligji për Kodin e Etikës së Policisë (Kodi i Etikës) i referohet termit ‘korrupsion’ dhe parashikon që punonjësit e policisë të ‘luftojnë me vendosmëri ndaj korrupsionit’.<sup>84</sup> Kodi i Etikës parashikon edhe detyrimin që punonjësit e poli-

80 Ligji “Për Policinë e Shtetit dhe Ligji “Për shërbimin për ankesat dhe çështjet e brendshme”, në Ministrinë e Punëve të Brendshme të miratuara në Korrik 2014 nuk janë analizuar në këtë kapitull për shkak se nuk kanë efekt mbi praktikat e deritanishme.

81 Ligji Nr.10002, date 6.10.2008 Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme

82 Ligji SHKB, Neni 2

83 Ligji SHKB, Neni 3

84 Ligji nr.8291, date 25.2.1998, Kodi i Etikës së Policisë, Neni 5

cisë të denoncojnë ‘çdo akt të shfaqjes’ së korrupsionit dhe abuzimeve.<sup>85</sup>

Një mangësi themelore e akteve ligjore dhe nënligjore është se nuk parashikojnë ndonjë përkufizim të korrupsionit policor, kështu që përkufizimi i përdorur në sistemin ligjor dhe administrativ është përkufizimi i dhënë në Kodin Penal. Kodin Penal e përkufizon korrupsionin si ‘*premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij*’.<sup>86</sup> Po kështu Kodi penal parashikon edhe dënimet ‘*me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë*’ për përfshirje në akte korrupsioni.<sup>87</sup>

Formë tjetër e shkeljes ligjore e parashikuara në Kodin e Etikës është detyrimi për përdorimin e forcës sipas dispozitave ligjore.<sup>88</sup> Ligji për Policinë e Shtetit e përkufizon përdorimin e forcës mbi personat si ‘*veprimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve të tjera apo armëve të zjarrit*’.<sup>89</sup> Po kështu ligji parashikon përdorimin e forcës në ‘*nivelin minimal të forcës së nevojshme*’ dhe ‘*në përputhje me parimin e përpjesëtueshmërisë*’.<sup>90</sup>

Rregullorja e Disiplinës e cilëson ‘përdorimin e paligjshëm ose i paarsyeshëm i forcës’ si shkelje të rëndë,<sup>91</sup> për të cilën ‘punonjësi i policisë mund ndëshkohet me të gjitha masat disiplinore përfshirë dhe përjashtimin nga policia’.<sup>92</sup>

Kodi i Etikës parashikon gjithashtu edhe ‘detyrimin [e punonjësve të policisë] për të luftuar abuzimin në kryerjen e detyrave shtetërore’.<sup>93</sup> Megjithatë ‘abuzimi në kryerjen e detyrave’ është një klauzolë tepër e gjerë dhe nuk gjendet e detajuar në ndonjë akt tjetër ligjor apo nënligjor. Në këtë drejtim më specifik është ligji për Policinë e Shtetit i cili parashikon detyrimin e punonjësve të policisë për të raportuar shkeljet e disiplinës,<sup>94</sup> si dhe kufizimet për kryerjen e një aktiviteti të dytë fitimprurës (punë ose biznes).<sup>95</sup>

85 Kodi i Etikës, Neni 5

86 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Shtator 2011. Neni 244

87 Kodi Penal, Neni 244

88 Kodi i Etikës, Neni 10

89 Ligji PSH, Neni 118

90 Ligji PSH, Neni 118

91 VKM nr. 786, date 4.6.2008 Për Miratimin e rregullores së disiplinës së Policisë së Shtetit, Neni 11

92 Rregullorja e Disiplinës, Neni 10

93 Kodi i Etikës, Neni 5

94 Ligji PSH, Neni 71, 72

95 Ligji PSH, Neni 73

Në mënyrë specifike ligji për PSH parashikon përcaktimin në Rregulloren e Disiplinës të ‘kategorive dhe llojeve të shkeljeve disiplinore’.<sup>96</sup> Po kështu ligji për PSH parashikon procedurat e brendshme disiplinore.<sup>97</sup>

Rregullorja e Disiplinës jep përkufizimin e shkeljes disiplinore si ‘çdo veprim, mosveprim, sjellje apo qëndrim që bie në kundërshtim me etikën e punonjësit, me këtë rregullore, si dhe me aktet normative që parashikojnë kryerjen e detyrave nga personeli i Policisë së Shtetit’.<sup>98</sup> Rregullorja e Disiplinës parashikon një katalog të detajuar të llojeve të shkeljeve të disiplinës të ndara në detyrime të përgjithshme për punonjësit e policisë (15 detyrime),<sup>99</sup> ndalime të përgjithshme (40 ndalime),<sup>100</sup> detyrime dhe norma të sjelljes gjatë detyrës/shërbimit (33 detyrime dhe norma),<sup>101</sup> si dhe detyrime dhe norma të sjelljes jashtë detyrës/shërbimit (33 detyrime dhe norma).<sup>102</sup> Rregullorja e Disiplinës parashikon edhe kategoritë e shkeljeve disiplinore të cilat ndahen në të shkelje rënda (28 shkelje)<sup>103</sup> dhe në shkelje të lehta ku përfshihen të gjitha shkeljet e tjera të kataloguara.<sup>104</sup> Shkeljet e lehta disiplinore janë të dënueshme me masë disiplinore ‘vërejtje, ‘vërejtje me paralajmërim’, ‘gjobë në masën sa paga e punonjësit për pesë ditë pune’. Shkeljet e rënda mund ndëshkohen me të gjitha masat disiplinore përfshirë dhe ‘përrjashtimin nga policia’.<sup>105</sup>

Rregullorja e Disiplinës e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme ka përshtatur të njëjtat terma me Rregulloren e Disiplinës së PSH si për llojet e shkeljeve ashtu edhe për masat ndëshkimore.<sup>106</sup>

Një formë tjetër shkelje ligjore e parashikuar në Kodin e Etikës është detyrimi për ruajtjen e sekretit.<sup>107</sup> Ashtu si për korrupsionin edhe për shkeljen e sekretit Kodi Penal parashikon dënime ‘me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet’ për përhapjen dhe informimin e ‘fakteve, shifrave, përmbajtjes së dokumenteve apo materialeve që, sipas ligjit të njohur publikisht, përbëjnë sekret shtetëror’.<sup>108</sup>

Megjithatë, asnjë nga aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e PSH

96 Ligji PSH, Neni 80

97 Rregullorja e Disiplinës, Neni 74-81

98 Rregullorja e Disiplinës, Neni 8

99 Rregullorja e Disiplinës, Neni 4

100 Rregullorja e Disiplinës, Neni 5

101 Rregullorja e Disiplinës, Neni 6

102 Rregullorja e Disiplinës, Neni 7

103 Rregullorja e Disiplinës, Neni 11

104 Rregullorja e Disiplinës, Neni 11

105 Rregullorja e Disiplinës, Neni 10

106 VKM no.646, datë 11.6.2009, ‘Për miratimin e rregullores së disiplinës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme’

107 Kodi i Etikës, Neni 11

108 Kodi Penal i RSH, Neni 294

nuk përmban ndonjë përkufizim se çfarë përbën ‘sekret policor’ si dhe procedurat dhe nivelet e klasifikimit, ruajtjes, deklasifikimit, etj. Ndërsa ligji për ‘Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror”’ rregullon informacionin e klasifikuar, ‘eksponimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar’ i cili përkufizohet si ‘mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë’.<sup>109</sup> Vetë misioni i PSH që ‘është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut’ e përjashton policinë nga zbatimi i ligjit për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror”’.

Këtë boshllëk deri diku e plotëson Rregullorja e Disiplinës së Policisë së Shtetit,<sup>110</sup> e cila parashikon si shkelje të rëndë disiplinore ‘dhënien ose publikimin e paautorizuar të informacioneve që [punonjësi i policisë] disponon gjatë kryerjes dhe për shkak të detyrës,<sup>111</sup> e cila mund të ndëshkohet me masa të gjitha masat disiplinore të parashikuara, ‘përfshirë dhe përjashtimin nga policia’.<sup>112</sup> Nga ana tjetër, Kodi Penal parashikon dënim me ‘burgim nga një deri në pesë vjet’ për zbulimin e ‘akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore’.<sup>113</sup>

Analiza e mësipërm tregon se kuadri ligjor për përcaktimin dhe mbrojtjen e sekretit policor është i paqartë dhe i paplotë, çka krijon mundësi për liri vendimmarrje të gjerë dhe abuzimi me informacionin në të gjitha nivelet e policisë.

Si përfundim, mund të thuhet se një nga mangësitë kryesore të kuadrit ligjor dhe nënligjor është se nuk jep ndonjë përkufizim të qartë të korrupsionit policor dhe të ndarjes ndërmjet keqsjelljes dhe korrupsionit. Kjo mangësi përbën një problem thelbësor për luftën kundër korrupsionit policor, pasi krijon konfuzion tek punonjësit e policisë dhe e bën të vështirë reagimin e përshtatshëm si të vetë punonjësve të policisë, kur u duhet të raportojnë akte të kolegëve të tyre, ashtu edhe dhe strukturave antikorrupsion në PSH dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) por edhe të qytetarëve.

### 7.3. Kuadri institucional

Kuadri institucional antikorrupsion në Ministrinë e Brendshme është i përbërë nga dy shtylla kryesore: SHKB, e cila operon në varësi të Ministrit të Punëve të Brend-

109 Ligj Nr. 8457, Për Informacionin e Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, Datë 11.02.1999 (Ndryshuar me Ligjin Nr.9541, Datë 22.5.2006) (Ndryshuar me Ligjin 25/2012), Neni 2

110 Rregullorja e Disiplinës

111 Rregullorja e Disiplinës, Neni 11, pika 7

112 Rregullorja e Disiplinës, Neni 10

113 Kodi Penal i RSH, Neni 295/a

shëm dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP), e cila operon në varësi të Drejtorit të PSH. Megjithëse këto struktura funksionojnë në mënyrë të pavarur, ato bashkërendojnë veprimtarinë e tyre gjatë hetimit të shkeljeve disiplinore dhe korrupsionit.<sup>114</sup>

Funksioni i hetimit është të evidentojë dhe hetojë shkeljet që përbëjnë vepra të dënueshme penalisht. Funksioni i inspektimit është vlerësimi i mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Shtetit, duke siguruar arritjen e qëllimeve, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara.<sup>115</sup> Inspektimi zë një fushë të gjerë të kontrollit të që përfshin infrastrukturën ligjore, menaxhimin strukturor, funksional, organizativ, të burimeve njerëzore dhe logjistike e deri tek udhëheqja, etika, sjellja individuale dhe kolektive e policisë. Praktika e punës ka treguar se produkti i inspektimit i ka shërbyer SHKB-së si premisë për fillimin e hetimeve penale ndaj punonjësve të policisë.<sup>116</sup>

DSP është struktura përgjegjëse për evidentimin e ankesave dhe ndjekjen e shkeljeve disiplinore në PSH.<sup>117</sup>

Ankesat janë format kryesore për evidentimin dhe trajtimin e keqsjelljes dhe akteve korruptive në polici si nga SHKB ashtu edhe nga DSP. Ankesat në DSP mund të paraqiten nga eprorët e punonjësve të policisë, nga vetë punonjësit e policisë, nga qytetarët, nga institucionet e tjera dhe nga SHKB. Kanalet e marrjes së ankesave nga janë të shumfishta,<sup>118</sup> ku përfshihen:

- Ministri i Brendshëm
- Avokati i Popullit
- Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun në MB
- Drejtori i Përgjithshëm i SHKB-së
- Zyra e Ankesave e SHKB-së
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit
- E-mail i SHKB-së
- Linja telefonike pa pagesë
- Strukturat e SHKB-së në qarqe

114 Udhëzim nr. 114, datë 12.04.2010 i Ministrisë të Brendshëm, ‘Për procedurat e mbledhjes së të dhënave dhe bashkërendimin e punës së SHKB me Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme’

115 Ligji SHKB, Neni 28

116 Raporti vjetor ‘Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm’ 2013, p.15

117 Regullorja e Disiplinës

118 Raportet vjetore ‘Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm’: 2010, 2011



Format e paraqitjes së ankesave janë paraqitja në zyrat e policisë dhe SHKB në nivel komisarati, telefonatat në linjën jeshile 08009090, letra, posta elektronike. Megjithatë, forma më e përdorur për paraqitjen e ankesave është telefoni. Gjatë vitit 2011 janë paraqitur 307 ankesa nëpërmjet telefonit, ndërsa gjatë vitit 2012 janë paraqitur 357 ankesa.

Në rastet e shkeljeve të lehta disiplinore masat ndëshkimore jepen nga eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit që ka kryer shkeljen.<sup>119</sup> Në rast të shkeljeve të rënda disiplinore masat jepen nga DSP.<sup>120</sup> Nëse shkelja e disiplinës dyshohet se përmban elementë të veprës penale, atëherë çështja i dërgohet SHKB. Nga ana e vet, SHKB mund ta rikthejë çështjen për rishqyrtim tek DSP kur shkelja nuk përbën veprë penale.<sup>121</sup> Nëse rasti përbën veprë penale, atëherë SHKB në bashkëpunim me Prokurorinë hetojnë çështjen dhe e dërgojnë në Gjykatë.




Figura 5: Sistemi i marrjes dhe shqyrtimit të ankesave në Policinë e Shtetit

SHKB, i cili ka një staf prej 104 punonjës dhe administrativisht është i organizuar në nivel qendror dhe në nivel qarqesh (12 qarqe), kryen dy funksione kryesore:

119 Regullorja e Disiplinës, Neni 26

120 Regullorja e Disiplinës, Neni 26

121 Ligjit nr. 10002, datë 06.10.2008, Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, Neni 26

hetimin e veprave penale (Departamenti i Hetimit) dhe inspektimin (Drejtoria e Inspektimit) (Figura 3). Megjithatë, si numri i stafit ashtu edhe ekspertiza e stafit të SHKB-së konsiderohen të pamjaftueshme për të adresuar korrupsionin në mënyrë të përshtatshme, sidomos në zbatimin e masave proaktive.<sup>122</sup> Një nga problemet kryesore të SHKB ka qenë edhe politizimi i saj. Siç tregojnë qëndrimet e partive politike kryesore, SHKB është parë me mosbesim çka ka sjellë dhe ndryshime të thella sa herë që ka pasur rotacione politike.<sup>123</sup> DSP është e organizuar në nivel qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe ka një staf prej 16 punonjësish.

## 7.4. Rezultatet në luftën kundër korrupsionit

Siç edhe mund të dilet në përfundime nga analiza e mësipërme, kuadri ligjor dhe institucional nuk ka rezultuar i efektshëm në uljen e korrupsionit. Edhe sipas indeksit të korrupsionit botëror të Transparency International për periudhën 2007-2013, korrupsioni policor në Shqipëri ka qëndruar konstant në shkallën 3.7 (nga 1-5 ku 1 është më pak i korruptuar dhe 5 më shumë i korruptuar).<sup>124</sup>

Edhe raportet ndërkombëtare nënvizojnë se korrupsioni në agjencitë e zbatimit të ligjit vazhdon të ngelet i lartë.<sup>125</sup> Punonjësit e policisë nuk e zbatojnë gjithmonë ligjin njëllë.<sup>126</sup> Edhe pse SHKB ka kryer kontrole, i është përgjigjur ankesave dhe ka kryer hetime, punonjësit e policisë shpesh pranojnë rryshfet për të mos i regjistruar çështjet në bazën e të dhënave të krimeve.<sup>127</sup>

Miratimi i ligjit për Policinë e Shtetit në vitin 2007 fillimisht pati një ndikim pozitiv në sjelljen e drejtuesve të policisë si dhe për strukturat e rekrutimit dhe karrierës së në polici.<sup>128</sup> Por në terma afatgjatë korrupsioni dhe keqsjellja në radhët e PSH tregon se korrupsioni vazhdon të ngelet një problem i pazgjidhur.<sup>129</sup> Sistemi i

122 European Commission, Commission Staff Working Document, Albania 2012 Progress Report, SWD(2012) 334 final, Brussels, 10.10.2013, p. 15.

123 Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ‘Diskutimi i projektligjit “Për Shërbimin për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme”’. Procesverbal, Datë 09.06.2014 [http://www.parlament.al/web/pub/procesverbal\\_ligjet\\_09\\_06\\_2014\\_17908\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/procesverbal_ligjet_09_06_2014_17908_1.pdf)

124 Transparency International, Global Corruption Barometer 2013, Berlin, 19 July 2013, p. 35.

125 European Commission, Albania 2013 Progress Report, p. 9.

126 US Department of State, Albania 2013 Human Rights Report, p. 5


127 US Department of State, Albania 2013 Human Rights Report, p. 6.

128 Commission of the European Communities, Commission Staff Working Document, Albania 2008 Progress Report, SEC(2008) 2692, Brussels, 5.11.2008, p. 48; Commission of the European Communities, Albania 2009 Progress Report, p. 48.

129 US Department of State, Albania 2013 Human Rights Report, p. 5.

administrimit të burimeve njerëzore është i papërshtatshëm po të shihet transferimi dhe largimi nga puna i punonjësve të trajnuar dhe kompetentë, gjë që bie ndesh me vetë Ligjin për Policinë e Shtetit.<sup>130</sup> Lëvizjet e vazhdueshme të personelit kanë çrregulluar cilësinë e shërbimeve si dhe dëmtuar vazhdimësinë dhe zhvillimin e vlerave dhe standardeve profesionale.<sup>131</sup>

Me gjithë shkallën e lartë të përhapjes së korrupsionit në PSH, rezultatet e mekanizmave antikorrupsion tregojnë se efektiviteti i masave reaguese ka qenë i dobët, siç duket nga analiza e të dhënave për hetimet dhe dënimet (*Grafiku 3*).



*Grafiku 3: Numri i kallëzimeve penale nga SHKB për periudhën 2010-2013, numri i punonjësve të policisë të arrestuar dhe numri i punonjësve të dënuar me burgim. Burimi: Raportet vjetore të SHKB, 2010-2013. Të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Qershor 2014.*

Përveç numrit të vogël të kallëzimeve dhe dënimeve penale të dhënat tregojnë edhe tendencën në rënie me kalimin e viteve ndërkohë që shkalla e korrupsionit pothuaj ka ngelur e pandryshuar.


Efikasiteti i dobët i sistemit antikorrupsion dhe veçanërisht i SHKB pranohet edhe nga vetë Ministria Brendshme, e cila vë në pah se me gjithë 'investimet e vazh-

130 Commission of the European Communities, Albania 2008 Progress Report, p. 48; Commission of the European Communities, Albania 2009 Progress Report, p. 48.

131 Rob MCCusker, Review of anti-corruption strategies, Australian Institute of Criminology, Technical and Background Paper, no. 23, 2006, p. 13.

dueshme në aspektin e përmirësimit të personelit, trajtimit, trajnimit dhe pajisjeve, ky shërbim [SHKB], duke u krahasuar me agjencitë e mbikëqyrjes policore në vendet e tjera, nuk ka arritur të tregojë potencialin e plotë të funksionit të tij’... ‘Si rrjedhojë e efikasitetit të dobët [të SHKB] nuk është ulur niveli i korrupsionit dhe [niveli i] implikimit në veprimtari kriminale të punonjësve të Policisë së Shtetit’.<sup>132</sup>

Analiza e të dhënave tregon se edhe struktura e hetimeve penale dhe dënimeve anon nga rangjet e ulëta të policisë, megjithëse të dhënat tregojnë se korrupsioni është i përhapur në të gjitha nivelet e policisë.<sup>133</sup> Hetimi i punonjësve të nivelit zbatues zë numrin më të madh të çështjeve penale të trajtuar nga SHKB (Grafiku 4).



Grafiku 4: Numri i kallëzimeve penale nga SHKB sipas pozicionit drejtues, për periudhën 2006-2013. Burimi: Raportet vjetore të SHKB 2010-2013.

Këto të dhëna tregojnë se sistemi i ankesave, disiplinës dhe hetimit është i ndërtuar në mënyrë të tillë që i lejon punonjësit e rangjeve të larta që të ‘mbyllin’ çështjet ku ata mund të gjenden të përfshirë.


Edhe sistemi i disiplinës dhe i ndëshkimeve nuk ka funksionuar në mënyrë të efektshme,<sup>134</sup> çka duket edhe në rezultatet e praktikës disiplinore (Grafiku 4). Numri i praktikave disiplinore të hapura nga DSP për shkelje të disiplinës është i

132 Relacion për projektligjin “Për shërbimin për ankesat dhe çështjet e brendshme, në ministrinë e punëve të brendshme” ([http://www.parlament.al/web/pub/relacioni\\_sherbimi\\_anekesat\\_per\\_çeshtjet\\_brendshme\\_17079\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/relacioni_sherbimi_anekesat_per_çeshtjet_brendshme_17079_1.pdf)). Dokument i aksesuar në Gusht 2014.

133 US Department of State, Albania 2013 Human Rights Report. Dokument i aksesuar më 6 korrik 2014, <http://www.state.gov/documents/organization/220457.pdf>

134 Commission of the European Communities, Albania 2009 Progress Report, faqe 48.

ulët në krahasim e numrin e shkeljeve.




Grafiku 5: Ecuria e praktikës disiplinore të hapura nga DSP për periudhën 2010-2013<sup>135</sup>

Performanca e dobët e sistemit antikorrupsion është reflektuar edhe në numrin e ulët të ankesave. Megjithëse ankesat dhe denoncimet e publikut nga qytetarët janë një nga format kryesore për evidentimin dhe adresimin e keqsjelljes dhe akteve korruptive në polici shifrat tregojnë një numër tepër të ulët të tyre, krahasuar me shkallën e perceptimit të korrupsionit si nga publiku ashtu edhe nga vetë punonjësit e policisë. Ndërkohë që ankesat përbëjnë një nga format kryesore për evidentimin dhe adresimin e keqsjelljes dhe akteve korruptive në polici. Për shembull, vetëm gjatë vitit 2012, në 12 raste ankesat e paraqitura nga qytetarët i kanë shërbyer SHKB si pikënisje për fillimin e hetimit penal.<sup>136</sup>

Për më tepër, të dhënat tregojnë një rënie drastike të numrit të ankesave gjatë vitit 2013, çka tregon se besimi i qytetarëve se ankesat dhe denoncimet do të ndiqen ka rënë në mënyrë drastike (Grafiku 6).


135 Raportet vjetore ‘Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm’: 2010, 2011, 2012, 2013

136 Raporti vjetore ‘Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm’ 2012



Grafiku 6. Numri i ankesave drejtuara SHKB-së për periudhën 2010-2013.<sup>137</sup>

Rënia e besimit të publikut në sistemin e ankesave në PSH shihet edhe nga prirja e numrit të ankesave drejtuara Avokatit të Popullit, e cila tregon një rritje të konsiderueshme në vitet e fundit.



Grafiku 7: Ankesat e paraqitura ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit për periudhën 2006-2009.<sup>138</sup> Burimi: Raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit dhe SHKB, 2003-2013.

<sup>137</sup> Raportet vjetore ‘Mbi veprimtarinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm’: 2010, 2011, 2012, 2013

<sup>138</sup> Mungesa e të dhënave nga Avokati i Popullit për vitet 2010, 2011 dhe 2013 lidhet me mënyrën e raportimit të këtij institucioni për këto vite, ku ankesat ndaj punonjësve të policisë nuk janë paraqitur të ndara.

Rezultatet e sondazheve me publikun dhe punonjësit e policisë tregojnë për njohje të pakët të kuadrit për parandalimin apo hetimin e korrupsionit dhe ndër ata që kanë informacion besimi tek ky kuadër është i ulët.

Besueshmëria e ulët në masat antikorrupsion del edhe nga të dhënat e Barometrit Botëror të Korrupsionit i Transparency International. Sipas Barometrit të vitit 2007, 27% e të pyeturve në Shqipëri mendonin se ato ishin të paefektshme, 53% e tyre mendoni se këto përpjekje nuk ishin as të efektshme por as të paefektshme, dhe vetëm 20% mendonin se përpjekjet anti-korrupsion të qeverisë ishin të efektshme.<sup>139</sup> Po kështu, Barometri i vitit 2013 tregoi se vetëm 24% e të pyeturve në Shqipëri mendonin se përpjekjet anti-korrupsion të qeverisë ishin shumë të paefektshme, 34% e të pyeturve mendonin se ato ishin të paefektshme, ndërsa 30% e tyre mendoni se këto përpjekje nuk ishin as të efektshme por as të paefektshme, dhe 9% e të pyeturve mendoni se këto përpjekje ishin të efektshme.<sup>140</sup>

Edhe vetë punonjësit e policisë kanë njohje të pjesshme për kuadrin antikorrupsion, pasi 31% e të anketuarve nga IDM shprehen se kanë pak njohuri, ndërsa 8% shprehen se nuk e njohin. Megjithatë, pjesa më e madhe e punonjësve të policisë të anketuar (mbi 70%) shprehen se kuadri antikorrupsion zbatohet plotësisht ose deri diku.

Por nga ana tjetër, sondazhi i IDM tregoi për një nivel të ulët të denoncimeve nga punonjësit e policisë të kolegëve edhe eprorëve të përfshirë në akte korruptive, megjithëse raportimi i tyre përbën detyrim ligjor. Ndonëse gjatë vitit të fundit (në kohën e realizimit të sondazhit) 54% e punonjësve të policisë të intervistuar thonë se u është kërkuar (47% një ose disa herë dhe 7% shpesh herë) nga një koleg që t'i kryejë një favor dhe 33% thonë se eprori u ka kërkuar të bëjnë lëshime ndaj dikujt (29% një ose disa herë dhe 7% shpesh herë), vetëm 8% thonë se e kanë denoncuar kolegun dhe 5% thonë se e kanë denoncuar eprorin.

Të dhëna nga intervistat dhe diskutime më të ngushta me punonjës të policisë tregojnë se shkalla e besimit e vetë punonjësve të policisë në sistemin antikorrupsion është e ulët. Nga ana tjetër, mospërputhjet e opinioneve ndërmjet publikut dhe punonjësve të policisë për disa nga pyetjet, mungesa e koherencës në disa qëndrime dhe përvoja në ndërveprimin dhe komunikimin me punonjësit e policisë tregojnë se në përgjithësi punonjësit e policisë në Shqipëri janë pak të hapur ndaj diskutimit mbi korrupsionin. Në takime të kryera me punonjës të policisë në

139 Transparency International Global Corruption Barometer 2007 (faqe. 24)

140 Transparency International, Global Corruption Barometer 2013, <http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=albania>

komisariate të ndryshme të vendit gjatë kryerjes së sondazheve apo gjatë komunikimit dhe diskutimit të gjetjeve studimore ata treguan se nuk flasin fare ose flasin shumë pak për temën e korrupsionit policor. Po kështu, dallohej preokupimi i tyre i vazhdueshëm për të rrezatuar një imazh sa më pozitiv të organizatës së policisë dhe kjo shpjegon edhe diferencën ndërmjet mendimit të publikut dhe punonjësve të policisë për disa nga pyetjet ku vlerësohet institucioni dhe performanca e tij.

## **8. Përhapja dhe llojet e korrupsionit policor në Shqipëri**

Siç u diskutua në kapitullin mbi korrupsionin policor, në Shqipëri ky lloj korrupsioni nuk ka qenë ndonjëherë subjekt i veçantë vëzhgimi apo studimi. Për pasojë, megjithëse ka të dhëna për nivelin e korrupsionit policor, ato janë të bazuara shpesh në perceptime të publikut mbi dhënien e ryshfetit. Kësisoj, mungon njohja mbi llojet më të përhapura të korrupsionit dhe strukturat më të prekura prej tij duke ndikuar në këtë mënyrë edhe qasjen ndaj masave antikorrupsion, pasi këto masa duhet të jenë të përshtatshme për të trajtuar lloje të ndryshme korrupsioni, kryesisht për parandalimin e tij.

Përkundrejt këtij sfondi, ky studim ka synuar që nëpërmjet sondazheve të publikut dhe punonjësve të policisë të identifikojë krahas shkallës së korrupsionit edhe llojet e ndryshme të tij dhe nivelin e përhapjes tek institucioni i Policisë së Shtetit dhe në strukturat përbërëse të saj.

### **8.1. Shkalla e përhapjes së korrupsionit**

Për të marrë përgjigje për shkallën e përhapjes së korrupsionit si dhe institucionet apo strukturat më shumë apo më pak të prekura, të njëjtat pyetje iu drejtuan si publikut ashtu edhe punonjësve të policisë. Paraprakisht të anketuarit u pyetën për shpeshësinë e marrjes së informacionit mbi korrupsionin dhe mjeteve të informimit.

Në përgjithësi numri i të anketuarve, të cilët kanë dhënë një përgjigje për organizatat dhe strukturat policore më shumë apo më pak të korruptuara, ka qenë i ulët. Po kështu, i ulët është edhe numri i të anketuarve nga publiku, të cilët kanë pasur përvoja me dhënien apo kërkimin e ryshfetit dhe favoreve (për të dhëna të plota shih Shtojca 1). Nga ana tjetër, rreth gjysma e punonjësve të policisë të anketuar shprehet se kanë pasur përvoja shkëmbimi favoresh apo ryshfeti me




qytetarë, kolegë dhe eprorë (për të dhëna të plota shih Shtojca 2).

Këto përvoja, të ndërthurura me faktin se shumica e të anketuarve si nga publiku (74%) ashtu edhe nga punonjësit e policisë (71%) pranojnë se burimi kryesor i informimit të tyre mbi korrupsionin është media, e cila ka raporton në mënyrë të shpeshtë mbi raste të korrupsionit, shpjegojnë edhe hendekun ndërmjet perceptimit të lartë të korrupsioni dhe përvojave të drejtpërdrejta.

### 8.1.1. Shkalla e përhapjes së korrupsionit sipas publikut


Në fillim të anketuarve iu është kërkuar të japin sipas mendimit të tyre se cila organizatë policore është më shumë e korruptuar. Përveç marrjes së mendimit mbi korrupsionin kjo pyetje e hapur kishte qëllim të dyfishtë. Duke pasur parasysh se reformat e kryera gjatë dy dekadave janë shoqëruar me krijimin dhe shpërbërjen e strukturave të ndryshme policore dhe meqenëse në Shqipëri operojnë disa organizata policore qëllimi tjetër ishte për të parë se sa i njeh publiku këto organizata.

Pyetjes se ‘në çfarë mase është i përhapur korrupsioni në Policinë e Shtetit’ shumica e të anketuarve (33%) janë përgjigjur se korrupsioni është ‘i përhapur në masë të konsiderueshme’ dhe një pjesë e konsiderueshme (18%) se është ‘mjaft i përhapur dhe serioz’ (Grafiku 8).




Grafiku 8: Përhapja e korrupsionit në Policinë e Shtetit

Pyetjes se ‘cila organizatë policore është më shumë e korruptuar’ i janë përgjigjur rreth 10% e të anketuarve. Nga përgjigjet del se 61% e të intervistuarve identifikojnë si më të korruptuara disa struktura të Policisë së Shtetit ku bie në sy shërbimi i policisë rrugore dhe shërbimi i policisë së rendit (Grafiku 9).



Grafiku 9: Përhapja e korrupsionit në shërbime të caktuara policore

Të pyetur në lidhje me organizatën policore më pak të korruptuar të anketuarit identifikojnë struktura të ndryshme, brenda dhe jashtë Policisë së Shtetit. Pjesa më e madhe e tyre identifikojnë si më pak të korrupuara kompanitë private të sigurisë, të njohura si ‘Policia Private’ (11.5%), strukturat e antikrimit në Policinë e Shtetit dhe organizatat policore të pushtetit vendor (Grafiku 10).




Grafiku 10: Përhapja e korrupsionit sipas niveleve të drejtimit


### 8.1.2. Shkalla e përhapjes së korrupsionit sipas punonjësve të policisë

Siç u theksua në kapitullin e mëparshëm (Vlerësimi i Kuadrit Antikorrupsion), sondazhi dhe intervistat me punonjës të policisë tregojnë për një mbyllje ndaj diskutimit mbi korrupsionin policor. Kjo reflektohet edhe në pyetjen se sa shpesh dëgjojnë ose ndeshen me informacion për oficerë policie të korruptuar, ku shumica e të anketuarve (60%) shprehen se dëgjojnë ‘rrallë’ ose ‘asnjëherë’ (8%) për oficerë policie të korruptuar. Vetëm rreth 25% e përgjigje-dhënësve shprehen se dëgjojnë shpesh ose gjithmonë për punonjës policie të korruptuar. Pavarësisht këtij hezitimi, punonjësit e anketuar mendojnë se korrupsioni në Policinë e Shtetit ekziston, por në ‘raste të izoluar’ (37.1%) ose ‘jo në nivele serioze’ (32.6%). Vetëm rreth 12% e tyre mendojnë në si korrupsioni është një fenomen të përhapur ose serioz (Shih Aneksin 1 për të dhëna të plota).

Grafikët më poshtë tregojnë për përhapjen e korrupsionit sipas niveleve të drejtimit dhe sektorëve të ndryshëm brenda Policisë së Shtetit (Grafiku 11 dhe 12).



Grafiku 11: Përhapja e korrupsionit sipas niveleve të drejtimit



Grafiku 12: Përhapja e korrupsionit sipas sektorëve të policimit

## 8.2. Llojet e korrupsionit

### 8.2.1. Raportet zyrtare dhe të medias

Nga analiza e dokumenteve dhe raporteve zyrtare mbi korrupsionin rezulton se në Policinë e Shtetit llojet më të përhapura të korrupsionit për të cilat strukturat antikorrupsion në Ministrinë e Brendshme kanë kryer hetime dhe hapur çështje penale në vitet e fundit janë:<sup>141</sup>

- Korrupsion pasiv
- Trafik droge
- Falsifikim dokumentesh
- Mashtrim
- Kanosje
- Rrahje
- Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës
- Vjedhje
- Vjedhje duke shpërdoruar detyrën
- Vjedhje dhe vjedhje duke shpërdoruar detyrën

141 Raporte të SHKB 2010, 2011, 2012, 2013,

- Shfrytëzim prostitucioni
- Trafikim mjeteve motorike
- Shpërdorim detyre
- Veprime arbitrare
- Vepra të tjera

Nga lista e mësipërme, numri më i madh i hetimeve të kryera ka qenë për korrupsion pasiv, shpërdorim detyre, veprimet arbitrare, dhe vepra të tjera. Trafiku i drogës dhe falsifikimi i dokumenteve janë llojet e korrupsionit për të cilat numri i hetimeve nga SHKB në tre vitet e fundit ka ardhur duke u rritur.<sup>142</sup> Megjithatë, raportet nuk japin të dhëna specifike se çfarë formash merr korrupsioni pasiv, shpërdorimi i detyrës, veprimet arbitrare, apo vepra të tjera që përbëjnë kategori të gjera ku përfshihen forma të ndryshme të korrupsionit.<sup>143</sup>

Raportimet në media tregojnë se disa nga llojet më të përhapura të korrupsionit policor janë lehtësimi i kontrabandës së mallrave në dogana, zhvatja e parave nëpërmjet shantazhit, pengimi i hetimeve, mosregjistrimi i rregullt i shtetasve në pikat e kalimit kufitar, emërimet korruptive, komprometimi i procedurave të prokurimit publik, shpërdorimi i informacionit policor, kërkimi i favoreve seksuale, përdorimi i armatimit dhe mjeteve të policisë jashtë shërbimit, etj.

### 8.2.2. Perceptimi i publikut

Për të parë llojet e korrupsionit si dhe shkallën e përhapjes së tyre të anketuarve nga publiku sondazhi i IDM u kërkoi të vlerësojnë sa shpesh sipas tyre ndodhin aktet e mëposhtme në Policinë e Shtetit (Tabela 5).

142 Raporte të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, viti 2010, 2011, 2012, 2013,

143 Kodi Penal përkufizon korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike përcaktohet 'kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në tre milionë lekë. Kodi Penal, Neni 259

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Thuajse asnjëherë)	2	3	4	5 (Shumë shpesh)
Ryshfeti	5%	9%	23%	27%	36%
Nderet/favoret prej të tretëve (jashtë policisë)	7%	18%	32%	26%	17%
Nderet/favoret për të tretët (nga ana e policisë)	7%	20%	32%	24%	17%
Nderet/favoret për kolegët e tyre (brenda policisë)	6%	15%	25%	26%	27%
Shpërdorimi fondeve të policisë	13%	23%	26%	18%	21%
Shpërdorimi mjeteve të policisë	15%	21%	25%	20%	19%
Manipulimi provave	12%	21%	29%	21%	26%
Përdorimi i dhunës së tepruar nga ana e policisë	16%	23%	25%	19%	18%

Tabela 5: Llojet e korrupsionit policor dhe përhapja e tyre sipas publikut

Për të mësuar nëse korrupsioni zyrtar brenda policisë është i përhapur dhe nëse korrupsioni policor është një fenomen individual apo problem organizativ dhe strukturor, të anketuarve nga publiku u është kërkuar të japin mendimin e tyre për pyetjet në tabelën më poshtë.

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3	4	5 (Plotësisht dakord)
Oficerët e policisë bashkëpunojnë me njerëz të inkriminuar dhe / ose me organizata kriminale	13%	28%	26%	14%	19%
Oficerët e policisë janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme (si trafiqe, kontrabandë, etj.)	10%	28%	30%	15%	17%
Rekrutimi i oficerëve të policisë kry- het mbi baza korruptive	11%	24%	28%	19%	18%
Emërimet dhe gradimet në nivele të larta të policisë janë korruptive	12%	21%	26%	21%	20%

Emërimet dhe gradimet në nivele të mesme dhe të ulta të policisë janë korruptive	11%	22%	28%	21%	18%
Drejtuesit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive	9%	20%	25%	20%	26%
Drejtuesit politikë dhe oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	9%	19%	25%	21%	26%
Oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	9%	21%	28%	19%	23%
Prokurimet në polici kryhen në mënyrë korruptive	13%	25%	27%	17%	18%
Oficerët e policisë e krijojnë vetë mundësinë për përfitim nëpërmjet korrupsionit	8%	20%	27%	20%	25%

*Tabela 6: Karakteristikat e korrupsionit policor sipas publikut*

Siç shihet nga përgjigjet, publiku mendon se korrupsioni në polici është i përhapur në nivel institucioni dhe ndikon në kulturën institucionale nëpërmjet korrupsionit në rekrutimet dhe gradimet e punonjësve të policisë. Këtë e përforcon edhe mendimi që ka publiku për bashkëpunimin ndërmjet punonjësve të policisë dhe drejtuesve të policisë me punonjësit në vartësi të tyre për të realizuar qëllime korruptive. Mendimi i publikut se punonjësit e policisë e krijojnë vetë mundësinë për përfitim nëpërmjet korrupsionit tregon për prirje drejt korrupsionit grabitqar.

### 8.2.3. Perceptimi i punonjësve të PSH

Edhe sondazhi me punonjësit e policisë, me gjithë mbylljen e tyre të dukshme ndaj diskutimit të korrupsionit të theksuar tashmë, tregon se format e korrupsionit janë të shumëllojshme. Siç shihet nga tabela më poshtë, forma e korrupsionit, e cila përveç se e përhapur është edhe më e shpeshtë, është shpërdorimi fondeve dhe mjeteve të policisë. Megjithëse të anketuarit nuk mendojnë se ryshfeti dhe favorizimi ndodhin shumë shpesh, këto dy forma janë po ashtu të përhapura.

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Thuajse asnjëherë)	2	3	4	5 (Shumë shpesh)
Ryshfeti	41,4	38,5	12,2	5,8	2,1
Nderet / favoret prej të tretëve (jashtë policisë)	36.4	37	17.7	6.5	2.4
Nderet / favoret për të tretët (nga ana e policisë)	42.2	36.8	14.3	5.5	1.2
Nderet / favoret për kolegët e tyre (brenda policisë)	40.3	33.3	15.5	7.3	3.6
Shpërdorimi fondeve të policisë	45.1	22.1	12.4	9.8	10.6
Shpërdorimi mjeteve të policisë	42	23.9	15.2	8.4	10.5
Manipulimi provave	78.5	13.9	5.2	1.2	1.2
Përdorimi i dhunës së tepruar nga ana e policisë	61.2	26.8	7.6	2.9	1.5

*Tabela 7: Llojet e korrupsionit policor dhe përhapja e tyre sipas punonjësve të policisë*

Vlen për t'u theksuar për qindja e lartë e të anketuarve që mendojnë se manipulimi i provave nuk është formë e përhapur korrupsioni dhe po kështu edhe përdorimi i tepruar i forcës gjatë ushtrimit të detyrës.

Meqenëse të dyja këto forma korrupsioni nuk kanë për motiv përfitimin por përdorimin e kompetencave dhe diskrecionit profesional për të ndikuar mbi rezultatet e punës së policisë mund të arrihet në përfundimin se më të përhapura janë ato forma korrupsionin që lidhen me motivin e përfitimit.

Nga ana tjetër, fakti që rreth 22% e të anketuarve mendon se manipulimi i provave është një ndër format e korrupsionit dhe raportimet e shpeshta të mediave për raste të dështimit të hetimeve kriminale me profilin të lartë, tregojnë se manipulimi i provave në këmbim të përfitimit është i pranishëm, edhe pse të anketuarit shprehën se nuk është shumë i përhapur. Megjithatë, vlen të përmendet edhe fakti se është e vështirë të identifikohet manipulimi i provave si formë korrupsioni policor duke pasur parasysh faktin se në Shqipëri është institucioni i prokurorisë dhe prokurorët



që janë përgjegjës për drejtimin e hetimeve.

Duke qenë se prokuroria rezulton si një ndër institucionet me korrupsionin më të përhapur - 92% e publikut dhe mbi 80% e punonjësve të policisë mendojnë se korrupsioni tek prokuroria është i përhapur, nga të cilët 34% mendojnë se është shumë i përhapur, dhe mbi 80% e punonjësve të policisë mendojnë se korrupsioni tek prokuroria është i përhapur (34% e publikut dhe rreth 30% e punonjësve të policisë mendojnë se korrupsioni tek prokuroria është shumë i përhapur) – manipulimi i provave si formë korrupsioni nevojitet të shqyrtohet më tej.

Punonjësve të policisë të anketuar iu kërkua të japin mendimin duke ju drejtuar të njëjtat pyetje si publikut për të mësuar nëse korrupsioni zyrtar brenda policisë është i përhapur dhe nëse korrupsioni policor është një fenomen individual apo problem organizativ.

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3	4	5 (Plotësisht dakord)
Oficerët e policisë bashkëpunojnë me njerëz të inkriminuar dhe / ose me organizata kriminale	60.2%	29.7%	5.8%	2.6%	1.7%
Oficerët e policisë janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme (si trafikë, kontrabandë, etj.)	58.6%	28.6%	8.5%	2%	2.3%
Rekrutimi i oficerëve të policisë kryhet mbi baza korruptive	61.9%	21.7%	9.4%	2.3%	4.7%
Emërimet dhe gradimet në nivele të larta të policisë janë korruptive	42.4%	21.8%	16.3%	7%	12.5%
Emërimet dhe gradimet në nivele të mesme dhe të ulta të policisë janë korruptive	48.1%	27.1%	11.9%	5%	7.9%
Drejtuesit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive	49.6%	20.5%	13.5%	6.4%	10%
Drejtuesit politikë dhe oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	58.2%	23.4%	7.6%	5.8%	5%

Oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	69.8%	17.7%	9.5%	1.2%	1.8%
Prokurimet në polici kryhen në mënyrë korruptive	54.1%	21.1%	9.9%	7.6%	7.3%
Oficerët e policisë e krijojnë vetë mundësinë për përfitim nëpërmjet korrupsionit	59.2%	24.6%	11.2%	1.8%	3.2%

*Tabela 8: Karakteristikat e korrupsionit policor sipas punonjësve të policisë*

Siç shihet nga përgjigjet, punonjësit e policisë mendojnë se korrupsioni në Policinë e Shtetit është i përhapur në nivel organizate dhe pavarësisht shkallës së përhapjes, e cila është më e lartë në proceset e emërimeve, gradimeve apo prokurimeve, po-himi i mbi 40% i përgjigjedhënësve se policia përdoret nga drejtuesit politikë për qëllime korruptive tregon për shkallën e lartë të përhapjes se korrupsionit politik.

## 9. Shkaqet e korrupsionit policor në Shqipëri

Siç është diskutuar më sipër, për shkak të mungesë së studimeve të thelluara mbi korrupsionin policor në Shqipëri edhe vlerësimi i shkaqeve të korrupsionit policor është një fushë që ka ngelur relativisht e patrajtuar. Megjithatë, në përpjekjet e deritanishme për të trajtuar problemin e korrupsionit disa nga shkaqet e identifikuara që kanë shërbyer për të ndërmarrë politika dhe masa të caktuara janë pagat e ulëta, boshllëqet ligjore, trajnimi i dobët, dobësitë drejtuese, etj.

Ky kapitull synon të shtjellojë më në thellësi gamën e shkaqeve të korrupsionit policor në Shqipëri duke u nisur nga vlerësimet teorike të diskutuara më sipër mbi shkaqet e korrupsionit policor dhe duke i ballafaquar me të dhënat e marra nga sondazhet me publikun dhe punonjës të policisë.

### 9.1. Perceptimet e publikut

Perceptimet e publikut ndaj korrupsionit dhe pritshmëritë ndaj institucioneve janë faktorë të rëndësishëm nxitës ose frenues të korrupsionit.

Për të mësuar mbi shkallën e përhapjes e korrupsionit në institucione të ndryshme, të cilat janë pjesë e rëndësishme e mjedisit ku policia operon dhe me të cilat ndërvepron, të anketuarit nga publiku u pyetën për të dhënë mendimet mbi përhapjen e korrupsionit në institucionet në tabelën më poshtë.

Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak)	2	3	4	5 (Shumë i përhapur)
Presidenti	35%	30%	16%	10%	9%
Parlamenti	16%	22%	26%	16%	21%
Këshilli Ministrave	16%	23%	22%	19%	20%
Ministria e Brendshme	15%	23%	28%	19%	15%
Prokuroria	8%	11%	22%	25%	34%
Gjykatat	5%	9%	15%	22%	49%
Kontrolli Lartë i Shtetit	11%	17%	31%	21%	20%
Inspektorati Lartë i Kontrollit & Deklarimit të Pasurive	9%	17%	26%	23%	25%
Media	16%	29%	31%	13%	11%
Shoqëria civile	29%	33%	21%	11%	6%
Avokati Popullit	33%	29%	19%	9%	10%

*Tabela 9: Përhapja e korrupsionit në institucione sipas publikut*

Të dhënat nga përgjigjet tregojnë se me gjithë dallimet për shkallën e përhapjes publiku mendon se korrupsioni është i lartë në institucionet kryesore të vendit. Përsa i përket lidhjes ndërmjet korrupsionit dhe aspekteve financiare dhe organizative të policisë, të dhënat tregojnë se publiku pothuaj në mënyrë unanime (mbi 95%) mendon se pagat e ulëta, trajnimi i dobët, ndikimi politik dhe kultura e korrupsionit janë faktorë që nxisin korrupsionin në polici.

Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se një pjesë e publikut e toleron sjellje të caktuara korruptive apo dhe qëndrime jo të drejta të punonjësve të policisë ndaj korrupsionit.

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3	4	5 (Plotësisht dakord)
Është e drejtë që oficerët e PSH të kryejnë punë tjetër jashtë orarit të punës	43%	14%	17%	9%	17%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në marrje ryshfeti	4%	6%	8%	15%	67%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në dhënien e informacioneve policore personave / organizatave kriminale	4%	5%	6%	13%	72%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në organizata kriminale	3%	4%	4%	11%	78%
Disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës	25%	16%	21%	15%	23%
Kryerja e një pune të dytë jashtë orarit të punës nga oficerët e PSH ndikon negativisht në përmbushjen e detyrës në polici	20%	14%	17%	14%	35%

Tabela 10: Toleranca ndaj korrupsionit

Po kështu, për 18% të të anketuarve pranimi nga punonjës të policisë i shërbimeve falas nga subjekte private nuk konsiderohet si shkelje, ndërsa 8-10% e të anketuarve nuk e konsiderojnë korrupsion rastin kur një punonjës policie ndërhyr për të ndihmuar dikë për të përfituar një shërbim jashtë radhës, kur vetë punonjësi i policisë shkel rregullat e trafikut rrugor kur është jashtë shërbimit apo dhe në rast se punonjësi i policisë manipulon provat (Shih Aneks 2 për të dhëna të plota mbi përgjigjet).

## 9.2. Perceptimet e punonjësve të policisë

### 9.2.1. Mjedisi i gjerë

Siç u shtjellua më sipër ka një lidhje të ngushtë ndërmjet mjedisit të gjerë dhe

korrupsionit policor. Një mjedis me korrupsion të përhapur dhe tolerant ndaj korrupsionit i bën punonjësit e policisë ta shohin atë si një praktikë legjitime. Kështu rreth 84% e të anketuarve që mendojnë se kultura e korrupsionit në shoqërinë shqiptare dhe ndikimi politik mbi policinë (rreth 80%) kanë ndikim në korrupsionin policor.

Po kështu, punonjësit e policisë në përgjithësi i shohin institucionet si të korruptuara, pavarësisht dallimeve për shkallën e përhapjes së korrupsionit në këto institucione. Një ndër të dhënat më domethënëse vlen të veçohet mendimi i mbi 80% e punonjësve të policisë se gjykatat dhe prokuroria janë të korruptuara. Dukë qenë se këto dy institucione janë dhe institucionet kryesore me të cilat policia ndërvepron në luftën kundër korrupsionit, perceptimi i tyre si të korruptuara në një shkallë kaq të lartë ndikon drejtpërdrejt në besimin e punonjësve policisë se çështjet që ata ndjekin do të hetohen dhe gjykoen në mënyrë të drejtë dhe i nxit ata që të shohin korrupsionin si një rrethanë nga e cila edhe ata duhet të përfitojnë.

Edhe institucione si Kontrolli Lartë i Shtetit dhe Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, të cilat kanë rol kyç në luftën kundër korrupsionit, perceptohen nga punonjësit e policisë me korrupsion të lartë.

Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak)	2	3	4	5 (Shumë i përhapur)
Presidenti	60.4	21.9	6.6	4.5	6.6
Parlamenti	45.7	22.1	15.2	6.9	10.1
Këshilli Ministrave	54.8	19.4	16.4	4.6	4.8
Ministria e Brendshme	60.2	21.5	10.5	5.7	2.1
Prokuroria	19.6	16.7	16.1	17.9	29.7
Gjykatat	14.6	12.8	13.4	16.3	42.9
Kontrolli Lartë i Shtetit	32.3	22.9	18.6	14.9	11.3
Inspektorati Lartë i Kontrollit & Deklarimit të Pasurive	26.9	21.5	17.6	14	20
Media	25.9	25.6	24.4	10.4	13.7
Shoqëria civile	41.2	30.1	15.8	6.9	6
Avokati Popullit	53.8	21.8	12.2	5.9	6.3

Tabela 11: Përhapja e korrupsionit në institucione sipas punonjësve të policisë

### 9.2.2. Faktorët organizative

Ndër faktorët që nxisin korrupsionin sipas punonjësve të policisë janë pagat e ulëta, kushtet jo të mira të punës trajnimi i pamjaftueshëm dhe kultura e punës në institucionin e policisë.

Faktorët	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak ndikim)	2	3	4	5 (Shumë ndikim)
Pagat e ulëta	11.5%	6.9%	13.2%	12.6%	55.8%
Pagat e nivelit të mesëm & të ulët në PSH janë të mjaftueshme për një jetesë normale	45.5%	23.4%	15%	6.8%	9.3%
Pagat e nivelit të lartë në PSH janë të mjaftueshme për një jetesë normale	11.4%	18.1%	23.6%	15.4%	31.5%
Kultura e punës në institucionin e policisë	23%	14.4%	20.7%	17.4%	24.5%
Trajnim i dobët	17.9%	13.9%	21.8%	17.6%	28.8%

Tabela 12: Toleranca ndaj korrupsionit

Siç u diskutua në kapitullin mbi shkallën e përhapjes së korrupsionit policor, një nga shkaqet por që në të njëjtën kohë është edhe pasojë, pra formë korrupsioni, është kultura e korrupsionit brenda institucionit të policisë e nxitur prej rekrutimeve, emërimeve dhe ngritjeve në detyrë me forma korruptive.

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (aspak dakord)	2	3	4	5 (plotësisht dakord)
Në radhët e PSH ka mjaft oficerë policie të pakorruptuar	24,9%	13,6%	5,5%	8,7%	47,3%
Oficerët e policisë janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e Policisë	54%	20,3%	13%	5,9%	6,8%
Sa më shumë organizata policore (Policia) në vend aq më i lartë korrupsioni	40,7%	14,1%	16,6%	6,3%	22,3%

Oficerët e vjetër (në moshë) të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët e rinj	47,7%	17,3%	14,1%	9,1%	11,8%
Oficerët meshkuj të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët femra	40%	19,3%	15,5%	9,1%	16,1%
Institucioni i PSH nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij	24,9%	15,3%	9,4%	6,7%	43,7%
Oficerët e policisë që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyra	46,3%	22%	17%	5%	9,7%
Oficerët në nivelet e larta të PSH e tolerojnë korrupsionin e vartësve të tyre	41,7%	21,9%	19,8%	8,6%	8%
Mosveprimi i drejtuesve të PSH për të luftuar korrupsionin dekurajon oficerët e Policisë	24%	14,5%	12,4%	10,9%	38,2%
Shumica e oficerëve të PSH janë të motivuar për zbatimin e ligjit	13%	6,3%	13%	11,5%	56,2%
Shumica e oficerëve të PSH shpesh e përdorin ligjin si mjet presioni mbi qytetarët për qëllime përfitimi	45,3%	27,3%	14,7%	6,8%	5,9%

*Tabela 13: Faktorë që nxisin korrupsionin sipas punonjësve të policisë*

Ndikimi i eprorëve dhe kolegëve përbën një shkak tjetër që nxit korrupsionin. Sipas sondazhit, 54% e punonjësve të policisë pohojnë se gjatë vitit të fundit u është kërkuar të paktën një herë që t'i kryejnë një favor një kolegu të tyre, ndërsa 34% e tyre pohojnë se po gjatë vitit të fundit eprori u ka kërkuar të paktën një herë që të bëjnë lëshime. Marrëdhëniet të tilla si epror-vartës tregojnë se mesazhi që punonjësit e policisë marrin është se korrupsioni është i tolerueshëm. Rreth 58% e të anketuarve mendojnë se eprorët e policisë në nivelet e larta të PSH e tolerojnë korrupsionin.

Tabela e mëposhtme përmban të dhëna që synojnë të eksplorojnë lidhjet ndërmjet korrupsionit dhe disa dimensioneve si gjinia, moshja, vjetërsia në shërbim, etj.

Përsa i përket kushteve të punës, vetëm 26% e të anketuarve mendojnë se ato janë të mira ose shumë të mira, kurse 29% e tyre mendojnë se janë të këqija. 44% e të anketuarve mendojnë se kushtet e punës janë të pranueshme. Megjithatë, nga intervistat me punonjës të policisë rezulton se ka paqartësi përsa i përket vlerësimit të kushteve të punës për shkak të mungesës së tipologjive standarde se çfarë kush-

tesh duhet të krijohen për shërbime të ndryshme policore në mënyrë që ato të kryejnë detyrën në mënyrë profesionale. Kështu, vlerësimi kryesisht bazohet tek kushte themelore si zyra, veshje, apo automjete në rastin e njërive të lëvizshme, etj.

Një tjetër aspekt që sondazhi ka synuar të trajtojë është shkalla e kuptimit dhe dallimit që punonjësit e policisë bëjnë ndërmjet keqsjelljes, korrupsionit dhe sjelljes kriminale si forma më e rëndë e korrupsionit policor. Siç u diskutua më sipër, në kapitullin e shkaqeve të korrupsionit, megjithëse keqsjellja dhe korrupsioni dallojnë nga njeri-tjetri, pranimi i shkeljeve të vogla gradualisht shpie në pranimin e formave më të rënda të keqsjelljes dhe korrupsionit.

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3	4	5 (Plotësisht dakord)
Është e drejtë që oficerët e PSH të kryejnë punë tjetër jashtë orarit të punës	36.1%	15.2%	14.9%	8.6%	25.2%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në marrje ryshfeti	11.9%	6.8%	12.4%	10.4%	58.5%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në dhënien e informacioneve policore personave / organizatave kriminale	10.3%	5.6%	5.9%	5.3%	72.9%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në organizata kriminale	5.6%	3.9%	6.8%	5.4%	78.3%
Disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës	32.3%	15.4%	18.3%	11.5%	22.5%
Kryerja e një pune të dytë jashtë orarit të punës nga oficerët e PSH ndikon negativisht në përmbushjen e detyrës në polici	31.9%	11.7%	13.7%	11.4%	31.3%


*Tabela 14: Dallimi ndaj korrupsionit dhe keqsjelljes sipas punonjësve të policisë*



Në radhë të parë, këto aspekte bëhen të ditura nëpërmjet trajnimit dhe rregullave të qarta. Prandaj, dhe punonjësit e policisë janë pyetur nëse mendojnë se rregulloret lënë hapësira për korrupsion dhe, duke qenë se ato ndodhin, është synuar të mësohet nëpërmjet sondazhit edhe shkalla e tolerimit të tyre nga punonjësit e policisë.

Të dhënat në tabelën më poshtë tregojnë se punonjësit e policisë nuk janë të ndarë qartazi në kuptimin e sjelljeve korruptive apo që çojnë në korrupsion dhe po kështu në qëndrimet që ata duhet të mbajnë ndaj akteve korruptive.

Po kështu, figura e mëposhtme tregon se rreth 2/3 e punonjësve të anketuar i shohin si akte korruptive mosndëshkimin e një punonjësi policie për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor, pranimin e shërbimeve falas apo edhe manipulimin e provave.



Grafiku 13: Toleranca ndaj korrupsionit dhe keqsjelljes sipas punonjësve të policisë

Përveç kulturës së tolerimit të korrupsionit të krijuar në vite, një faktor tjetër që lidhet me shkaqet e mostrajtitimit të këtij problemi lidhet me pamjaftueshmërinë dhe efektshmërinë e ulët të akteve, të cilat i ndihmojnë punonjësit e policisë të trajtojnë korrupsionin. Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se kodi i stikës së policisë nuk ka ndikuar aspak për parandalimin e korrupsionit (rreth 70%) dhe se rregulloret e brendshme lënë hapësirë për korrupsion (rreth 54%).

### 9.2.3. Besimi tek sistemi antikorrupsion

Meqenëse besimi tek sistemi antikorrupsion dhe pjesëmarrja aktive e punonjësve

të policisë në luftën kundër korrupsionit janë faktorë kyç për forcimin e kulturës së mostolerimit të korrupsionit dhe integritetit të organizatës së policisë, sondazhi ka synuar të marrë mendimet e të anketuarve mbi këto aspekte.

Rezultate tregojnë se një pjesë e madhe e të anketuarve mendojnë se është plotësisht e mundur që policia të luftojë korrupsionin brenda vetes (rreth 70%) dhe se është plotësisht e mundur që korrupsioni në polici të mund të zvogëlohet (rreth 58%). Megjithatë, numri i punonjësve që kanë besim të lëkundur ose që nuk besojnë se korrupsioni mund të luftohet mbetet ende i lartë.

Po kështu, besimi që punonjësit e policisë kanë tek institucionet e tjera në luftën kundër korrupsionit është i lëkundur. Përveç një shkalle të lartë besimi tek kryeministri dhe ministria e brendshme besimi tek institucione te tjera është i vogël.


Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak besim)	2	3	4	5 (shumë besim)
Kryeministri	5%	9%	11%	12%	63%
Ministri Brendshëm	5%	6%	10%	12%	67%
Drejtori përgjithshëm i PSH	4%	4%	10%	18%	64%
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm	6%	10%	15%	17%	52%
Prokurori përgjithshëm	12%	17%	21%	15%	35%
Avokati popullit	12%	19%	17%	14%	38%
Inspektorati Lartë Kontrollit & Deklarimit të Pasurisë	17%	18%	23%	15%	27%
Parlamenti	15%	16%	22%	18%	29%
Gjyqësori	27%	17%	21%	11%	24%
Prokuroria	20%	17%	25%	13%	25%
Kontrolli Lartë i Shtetit	17%	19%	25%	14%	25%
Partitë politike	46%	22%	14%	5%	13%
Shoqëria civile	14%	14%	25%	17%	30%
Media	15%	12%	20%	20%	33%

Tabela 15. Besimi tek institucionet në luftën antikorrupsion në PSH

Përsa i përket horizontit kohor, rezultatet e sondazhit tregojnë se një pjesë e mirë e punonjësve të policisë (33%) e shohin suksesin e luftës kundër korrupsionit të lid-

hur me anëtarësimin në BE, ndërsa një pjesë tjetër (8%) mendojnë se lufta kundër korrupsionit nuk do të japë kurrë rezultate.

Lufta antikorrupsion në PSH do të japë rezultate (minimizim i korrupsionit):



Grafiku 14: Masat antikorrupsion dhe efekti i tyre

## 10. Integriteti policor dhe korrupsioni

Me qëllim marrjen e të dhënave të mëtejshme mbi korrupsionin u kryen intervista të strukturuar me punonjës të policisë duke iu kërkuar që të japin mendimin e tyre për 11 skenarë të ndryshëm (Shih për më tepër kapitullin mbi Metodologjinë dhe Shtojca 5)

Në përgjithësi, të anketuarit shprehin qëndrimin e tyre kundër shkeljeve duke i renditur shkeljet sipas shkallës së seriozitetit që mendojnë. Sa më serioze është shkelja aq më e rëndë është masa disiplinore që ata mendojnë se duhet të jepet dhe po kështu edhe gatishmëria për të raportuar shkeljet e një kolegu është më e lartë për shkeljet më të rënda.

Për një sërë shkeljesh, të cilat cilësohen si të rënda edhe në Rregulloren e Disiplinës, punonjësit e policisë shprehin prirje tolerance duke u shprehur se duhet të jepen masa më të lehta. Është e paqartë nëse ky qëndrim është rezultat i mosnjohjes së rregullave apo i mungesës së mbështetjes së tyre ndaj rregullave, por, cilado qoftë arsyeja, kjo tregon për boshllëqe të theksuara në mënyrën se si komunikohen dhe kuptohen rregullat antikorrupsion në PSH.

Rezultatet tregojnë se gatishmëria e ulët për të raportuar shkeljet e kolegëve përbën një element të rëndësishëm të kulturës së integritetit të policisë, pasi punonjësit e policisë nuk e shohin mosraportimin e një kolegu ndër shkeljet më të rënda.

	Serioziteti i shkeljes		Disiplina		Gatishmëria për të raportuar		
	Mendimi për veten (pyetja 1)	Mendimi për të tjerët (pyetja 2)	Masa disiplinore që DUHET të merret	Masa disiplinore që DO TË merret	Vetë (pyetja 6)	Shumica e punonjësve të tjerë (pyetja 7)	
<b>Skenari</b>	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare
	Moda	Moda	Moda	Moda	Moda	Moda	Moda
<b>Skenari 1</b>	1.91	2.10	2.43	2.50	2.72	2.28	1
Kryerja e një pune dytë							
<b>Skenari 4</b>	3.37	3.12	3.03	3.20	3.46	3.13	5
Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit							
<b>Skenari 8</b>	3.69	3.38	3.50	3.42	3.31	3.18	5
Mbulim i shkeljes së një kolegu							
<b>Skenari 2</b>	3.82	3.48	3.47	3.51	3.66	3.33	5
Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit							

<b>Skenari 7</b> Keqëndorim i kompetencave të parashikuara	3.93	5	3.54	5	3.43	Vërejtje me shkrim	3.40	Vërejtje me shkrim	3.41	5	3.29	5
<b>Skenari 6</b> Marrje përqindje për rekomandim	3.94	5	3.58	5	3.90	Vërejtje me shkrim	3.84	Vërejtje me shkrim	3.55	5	3.36	5
<b>Skenari 10</b> Përdorim të tepruar force	3.95	5	3.66	5	3.47	Vërejtje me shkrim	3.53	Vërejtje me gojë	3.79	5	3.24	5
<b>Skenari 9</b> Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	4.30	5	3.98	5	3.78	Vërejtje me shkrim	3.75	Vërejtje me shkrim	3.87	5	3.52	5
<b>Skenari 11</b> Vjedhje e sendeve të gjetura	4.55	5	4.20	5	4.53	Shkarkim nga puna	4.61	Shkarkim nga puna	4.09	5	3.86	5
<b>Skenari 3</b> Marrje rryshfeti	4.86	5	4.39	5	4.84	Shkarkim nga puna	4.87	Shkarkim nga puna	4.20	5	3.92	5
<b>Skenari 5</b> Vjedhje nga vendi i krimit	4.94	5	4.66	5	4.48	Shkarkim nga puna	5.41	Shkarkim nga puna	4.49	5	4.10	5

*Tabela 16: Rezultatet e anketimit për vlerësimin e shkallës së seriozitetit të shkeljes, masës disiplinore dhe vullnetit për të raportuar.*

## 10.1. Vlerësimi për shkallën e seriozitetit të sjelljes

Në vlerësimin e të 11 skenarëve punonjësit e policisë të anketuar i shohin disa nga llojet e keqsjelljes si më të rënda sesa të tjerat. Punonjësit e policisë i konsiderojnë ‘vjedhjen nga vendi i krimit’, ‘marrjen e ryshfetit’, dhe ‘vjedhjen e sendeve të gjetura’, si shkeljet më të rënda. Shkalla e seriozitetit të shkeljes reflektohet edhe në masat disiplinore që ata mendojnë se do të jepen apo duhet të jepen, siç do të shtjellohet më poshtë në mënyrë më të detajuar.

Në tërësi, këto vlerësime tregojnë se njohja e punonjësve të policisë me rregullat është e pjesshme dhe e pamjaftueshme, pasi përveç kryerjes së një pune të dytë, të cilën Rregullorja e Disiplinës nuk e parashikon si shkelje ‘kur nuk përbën konflikt interesi dhe është në përputhje me legjislacionin përkatës’,<sup>144</sup> shkeljet e përshkruara në skenarët 2, 4, 6,7, 9 dhe 10, janë shkelje të cilat Rregullorja e Disiplinës i rendit si shkelje të rënda.<sup>145</sup>

Edhe mbulimi i shkeljes së një kolegu, shkelje e cila shihet si ndër më pak seriozet nga punonjësit e policisë, tregon se kultura e heshtjes dhe solidaritetit ndaj kolegëve është e përhapur dhe përbën një nga shkaqet kryesore të korrupsionit. Siç u trajtua në kapitullin mbi shkaqet e korrupsionit, aktet korruptive ndodhin larg syve të eprorëve dhe publikut dhe kur punonjësit e policisë janë të sigurt se kolegët nuk do t’i raportojnë, atëherë edhe siguria se përfitimi nga përfshirja në korrupsion do të jetë më e madhe se humbja rritet.

Një aspekt që meriton analizë të veçantë është mendimi i punonjësve të policisë ndaj dypunësimit. Ky skenar është vlerësuar si shkelja më pak e rëndë dhe i vetmi të cilin të anketuarit mendojnë se kolegët do ta vlerësonin si shkelje më serioze sesa ata vetë.

Kjo shkallë tolerance tregon se kryerja e një pune të dytë tashmë përbën një tipar kryesor të kulturës organizative në PSH, e cila meriton vëmendje të veçantë. Edhe pse Rregullorja e Disiplinës e lejon dypunësimin, kur nuk përbën konflikt interesi dhe është në përputhje me legjislacionin përkatës, nuk është e qartë se si vlerësohet rast pas rasti secila punë e dytë ndërkohë që shkalla e diskrecionit dhe rreziku që vetë eprorët të përfshihen në korrupsion është i lartë. Siç del nga raportimet në media, ka pasur shumë raste kur punonjës të policisë janë përfshirë në konflikte me qytetarë gjatë kryerjes së punëve të dyta si truproja apo punë të ngjashme, duke

144 Rregullorja e Disiplinës, Neni 4, pika 14

145 Rregullorja e Disiplinës, Neni 11, pika 8, 10, 12, 14, 20.

përdorur statusin dhe armët e shërbimit.

Një aspekt tjetër që spikat nga analizimi i të dhënave të anketimit është dallimi ndërmjet vlerësimit që vetë punonjësit e policisë kanë për secilin skenar dhe vlerësimit që ata kanë për mendimin e punonjësve të tjerë. Ndryshe nga skenari i dypunësimit, për 10 skenarët e tjerë punonjësit e anketuar mendojnë se kolegët e tyre do t'i vlerësonin si më pak serioze shkeljet e dhëna në skenarë. Kjo tregon se në nivel organizate ekziston një shkallë tolerance ndaj sjelljes korruptive dhe shkeljes së rregullave.

## 10.2. Mbështetja për masat disiplinore

Në përgjithësi, të dhënat e anketës tregojnë për një shkallë të lartë tolerance ndaj shkeljeve. Përveç kryerjes së një pune të dytë, për të cilën punonjësit e policisë mendojnë se nuk duhet të jepet ndonjë masë disiplinore, për të gjitha shkeljet e tjera ata mendojnë se do të jepen masa si vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, apo përjashtim nga policia.

Megjithatë, siç u theksua më sipër, shumë shkelje vlerësohen jo si të rënda dhe masat disiplinore që punonjësit e policisë mendojnë se jepen apo duhet të jepen për shumicën e shkeljeve të përshkruara në skenarë janë vërejtje me gojë ose me shkrim, megjithëse në Rregulloren e Disiplinës shumë prej tyre cilësohen si shkelje të rënda,<sup>146</sup> dhe të dënueshme deri në përjashtim nga policia.<sup>147</sup>

Vlerësimi për masat disiplinore nxjerr në pah edhe qëndrimin ndaj përdorimit të tepruar të forcës. Edhe pse punonjësit e policisë mendojnë se masa që do të jepet është vërejtje me gojë ndërkohë që ata mendojnë se duhet të jepet vërejtje me shkrim, qëndrimi ndaj kësaj shkelje nuk është në përputhje me Rregullorja e Disiplinës e cila e cilëson 'përdorimin e paarsyeshëm i forcës' si shkelje të rëndë,<sup>148</sup> të dënueshme me 'përjashtim nga policia'.<sup>149</sup>

Po kështu, ata mendojnë se do të jepet dhe duhet të jepet vërejtje me shkrim për pranim shpërblimesh dhe dhuratash, keqpërdorim të kompetencave apo dhe marrjes së përqindjeve si shpërblim për rekomandime.

Shkeljet për të cilat punonjësit e policisë mendojnë se do të jepet masa më rëndë janë vjedhja dhe marrja e ryshfetit. Në fakt, qëndrimi më i rreptë ndaj këtyre shkeljeve duket se buron nga shkalla e lartë e sensibilizimit shoqëror ndaj këtyre

146 Rregullorja e Disiplinës, Neni 11, pika 8, 10, 12, 14, 20.

147 Rregullorja e Disiplinës, Neni 10, pika 8, 10, 12, 14, 20.

148 Rregullorja e Disiplinës, Neni 11, pika 14

149 Rregullorja e Disiplinës, Neni 10, pika 2

Analiza më e detajuar e të dhënave tregon për dallime në mbështetjen ndaj masave që punonjësit e policisë mendojnë se duhet të jepen dhe atyre që do të jepen, dallime të cilat nuk anojnë në të njëjtin kah. Për shkelje si marrje ryshfeti, pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit, dhe pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit, vjedhje e sendeve të gjetura, ka një mbështetje më të vogël nga punonjësit e policisë për masën disiplinore që ata mendojnë se duhet të merret. E vetmja shkelje për të cilën ka mbështetje më të gjerë për masën shkarkim nga puna, si masa që duhet të jepet është vjedhja nga vendi i krimit.

### 10.3. Gatishmëria për të raportuar shkeljet

Analiza e të dhënave të anketës tregon se kodi i heshtjes është një dimension i rëndësishëm i kulturës së integritetit në PSH. Kjo vërehet si në vlerësimin që punonjësit e policisë japin për shkallën e seriozitetit të shkeljes së rregullave nga një koleg (shiko renditjen në Tabelën xxx më poshtë) ashtu edhe në gatishmërinë për të raportuar. Gatishmëria për të raportuar shkeljen e një kolegu është në nivel mjaft të ulët, e cila renditet menjëherë pas gatishmërisë për të raportuar kryerjen e një pune të dytë, të cilën shumica e punonjësve të policisë nuk e konsiderojnë si shkelje të dënueshme.

Kjo tregon se edhe pse Rregullorja e Disiplinës parashikon detyrimin e punonjësve të policisë për të raportuar shkeljet,<sup>150</sup> gatishmëria e tyre për ta përmbushur këtë detyrim është e ulët dhe po kështu mbështetja që ata tregojnë se kanë për këtë politikë zyrtare të policisë është e ulët.

Gatishmëria e ulët për të raportuar vërehet edhe nga krahasimi të dhënave mbi vlerësimin e skenarëve sipas shkallës së seriozitetit të shkeljes dhe gatishmërisë për të raportuar shkeljen. Siç shihet në tabelën më poshtë, përveç skenarëve 1 dhe 4, vlerat mesatare për gatishmërinë për të raportuar janë më të ulta se ato të vlerësimit të shkallës së seriozitetit të shkeljes.



Skenari	Serioziteti i shkeljes		Serioziteti i shkeljes	
	Mendimi për veten (pyetja 1)	Mendimi për veten (pyetja 1)	Vetë (pyetja 6)	Shumica e punonjësve të tjerë (pyetja 7)
	Mesatare	Mesatare	Mesatare	Mesatare
<b>Skenari 1</b> Kryerja e një pune dytë	1.91	2.10	2.72	2.28
<b>Skenari 4</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	3.37	3.12	3.46	3.13
<b>Skenari 8</b> Mbulim i shkeljes së një kolegu	3.69	3.38	3.31	3.18
<b>Skenari 2</b> Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	3.82	3.48	3.66	3.33
<b>Skenari 7</b> Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	3.93	3.54	3.41	3.29
<b>Skenari 6</b> Marrje përqindje për rekomandim	3.94	3.58	3.55	3.36
<b>Skenari 10</b> Përdorim të tepruar force	3.95	3.66	3.79	3.24
<b>Skenari 9</b> Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	4.30	3.98	3.87	3.52
<b>Skenari 11</b> Vjedhje e sendeve të gjetura	4.55	4.20	4.09	3.86
<b>Skenari 3</b> Marrje ryshfeti	4.86	4.39	4.20	3.92
<b>Skenari 5</b> Vjedhje nga vendi i krimit	4.94	4.66	4.49	4.10

Tabela 17: Vlerësimi i seriozitetit të shkeljes dhe i gatishmërisë për të raportuar shkeljet

## 10.4. Përputhshmëria me politikën zyrtare

Pyetja e tretë i kërkoi punonjësve të anketuar të jepnin mendimin e tyre nëse skenari i dhënë përbënte shkelje të politikës zyrtare të Policisë së Shtetit. Të anketuarit janë mendojnë se vjedhja nga vendi i krimit, marrja e ryshfetit dhe vjedhja e sendeve të gjetura janë si tre sjelljet që bien më së shumti në kundërshtim me politikën zyrtare të PSH.

Kryerja e një pune të dytë shihet nga shumica dërrmuese e të anketuarve se nuk është në kundërshtim me politikën zyrtare të policisë. Po kështu, pranimi i shpërblyer nga qytetarë jashtë shërbimit për një pjesë të madhe të të anketuarve nuk shihet se përbën shkelje të politikës zyrtare.

Edhe në përgjigjen e kësaj pyetjeje del në pah heshtja dhe mungesa e gatishmërisë për të raportuar kolegët si pjesë e kulturës së organizatës (Tabela 18).

Renditja e skenarëve	Serioziteti i shkeljes	Masa disiplinore	Gatishmëria për të raportuar	Përputhshmëria me politikën zyrtare
	Skenari 3 Marrje ryshfeti (për tejkalim norme shpejtësie)	Skenari 3 Marrje ryshfeti (për tejkalim norme shpejtësie)	Skenari 5 Vjedhje nga vendi i krimit	Skenari 5 Vjedhje nga vendi i krimit
	Skenari 11 Vjedhje e sendeve të gjetura	Skenari 11 Vjedhje e sendeve të gjetura	Skenari 3 Marrje ryshfeti (për tejkalim norme shpejtësie)	Skenari 3 Marrje ryshfeti
	Skenari 5 Vjedhje nga vendi i krimit	Skenari 5 Vjedhje nga vendi i krimit	Skenari 11 Vjedhje e sendeve të gjetura	Skenari 11 Vjedhje e sendeve të gjetura
	Skenari 6 Marrje përqindje për rekomandim	Skenari 6 Marrje përqindje për rekomandim biznesi	Skenari 9 Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	Skenari 9 Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit
	Skenari 9 Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	Skenari 9 Pranim dhurate për të shpërfillur shkelje të ligjit	Skenari 10 Përdorim force të tepruar	Skenari 10 Përdorim force të tepruar

	Skenari 8 Mbulim i shkeljes së një kolegu	Skenari 8 Mbulim i shkeljes së një kolegu	Skenari 2 Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	Skenari 7 Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara
	Skenari 10 Përdorim force të tepruar	Skenari 10 Përdorim force të tepruar	Skenari 6 Marrje përqindje për rekomandim biznesi	Skenari 2 Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit
	Skenari 2 Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	Skenari 2 Pranim shpërblimi nga qytetarë gjatë shërbimit	Skenari 4 Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	Skenari 6 Marrje përqindje për rekomandim
	Skenari 7 Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	Skenari 7 Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	Skenari 7 Keqpërdorim i kompetencave të parashikuara	Skenari 8 Mbulim i shkeljes së një kolegu
	Skenari 4 Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	Skenari 4 Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit	Skenari 8 Mbulim i shkeljes së një kolegu	Skenari 4 Pranim shpërblimi nga qytetarë jashtë shërbimit
	Skenari 1 Kryerja e një pune të dytë (konflikt interesi)	Skenari 1 Kryerja e një pune të dytë (konflikt interesi)	Skenari 1 Kryerja e një pune të dytë (konflikt interesi)	Skenari 1 Kryerja e një pune të dytë

*Tabela 18 : Renditja e rezultateve sipas seriozitetit të shkeljes, masës disiplinore, gatishmërisë për të raportuar dhe përputhshmërisë me politikën zyrtare*

Siç u trajtua në kapitujt më sipër, heshtja si pjesë e kulturës policore reflektohet edhe nga rezultatet e sondazhit me punonjësit e policisë ku megjithëse korrupsioni rezulton të jetë i përhapur 44% e të anketuarve u shprehën se dëgjojnë të rrallë ose asnjëherë për korrupsion në polici.

## 11. Përfundime dhe rekomandime

### 11.1. Përfundime

Ky studim analizon korrupsionin policor në Shqipëri. Qëllimi i studimit është që të kontribuojnë në përmirësimin dhe forcimin e kuadrit antikorrupsion në Shqipëri nëpërmjet njohjes më të mirë të fenomenit të korrupsionit policor dhe shkaqeve të tij. Po ashtu, studimi synon të kontribuojë në plotësimin e boshllëqeve që ekzistojnë në fushën e studimeve empirike mbi korrupsionin në Shqipëri dhe në veçanti mbi korrupsionin policor.

Fillimisht studimi bën një vlerësim të literaturës mbi korrupsionin policor duke u ndalur në përkufizimin dhe veçantitë e tij, të llojeve të korrupsionit policor dhe faktorëve që e nxisin apo frenojnë. Në vijim, mbështetur në të dhëna dhe burime dytësore, studimi analizon dhe sfondin në të cilin është shfaqur dhe zhvilluar korrupsioni policor në Shqipëri si dhe bën një vlerësim të politikave dhe kuadrit ligjor dhe institucional antikorrupsion. Më tej, mbështetur në të dhëna empirike të mbledhura nëpërmjet sondazheve me publikun dhe sondazheve dhe intervistave me punonjës të policisë për të korrupsionit policor, studimi përqendrohet tek analiza shkallës aktuale të përhapjes së korrupsionit policor në Shqipëri, të formave të korrupsionit dhe shkaqeve që nxisin këtë korrupsion.

Që në krye të herës, studimi nisat me premisën se korrupsioni policor është një fenomen shkaqet e të cilit gjenden tek mjedisi më i gjerë dhe tek kultura dhe problemet organizative të policisë. Gjetjet tregojnë se korrupsioni policor në Shqipëri është i përhapur në shkallë të lartë dhe prek të gjitha nivelet e policimit, përfshirë dhe drejtimin politik të institucionit të policisë.

Përsa i përket llojeve, përveç marrjes së ryshfetit dhe favoreve nga qytetarët, e cila është edhe forma më e përhapur e korrupsionit në individual, korrupsioni zyrtar rezulton gjithashtu i përhapur. Ndër format më të përhapura të korrupsionit zyrtar rezultojnë rekrutimet, emërimet dhe promovimet korruptive ku punonjësit e policisë janë edhe objekt edhe subjekt i korrupsionit. Po kështu, formë tjetër e përhapur rezulton abuzimi me burimet financiare dhe materiale të policisë, prokurimet korruptive të produkteve dhe shërbimeve të destinuara për policinë, si dhe shpërdormi i informacionit policor apo manipulimi i të dhënave dhe provave.

Motivi kryesor i korrupsionit rezulton të jetë përfitimi financiar apo material.

Shkaqet e korrupsionit rezultojnë nga kombinimi i faktorëve të ndryshëm si toleranca ndaj korrupsionit, rrënjët e se cilës janë sa historike aq edhe strukturore të lidhura me tranzicionin postkomunist, specifikat e policimit, kultura organizative e policisë, si dhe efektiviteti i dobët i masave antikorrupsion, të cilat me kalimin e viteve kanë shpënë në rënien e besimit si tek qytetarët ashtu edhe tek vetë punonjësit e policisë. Masat për krijimin dhe mbajtjen e kulturës së integritetit të organizatës së policisë pothuajse kanë munguar ose janë zbatuar në mënyrë shumë të pjesshme dhe integriteti i dobët shërben si bazë për sjellje dhe korrupsion individual apo në grupe të punonjësve të policisë.

## 11.2. Rekomandime për reformën

Korrupsioni policor është trajtuar tradicionalisht si fenomen që shkaktohet nga sjellja individuale e një numri të kufizuar punonjësish të policisë të pa trajnuar ose me prirje për të shkelur rregullat. Për pasojë edhe qasja për të trajtuar korrupsionin ka qenë e mbështetur kryesisht në forcimin e hetimit për të identifikuar dhe dënuar rastet individuale të korrupsionit dhe në përmirësimin e trajnimit dhe standardeve të rekrutimit.

Por në dy-tre dekadat e fundit prirja e reformave ka qenë që korrupsioni në polici të trajtohet si rezultat i kombinimit të një sërë faktorëve që shkojnë përtej individit siç janë dobësia organizative, çështje që lidhen me mungesën e transparencës, mungesën e sistemeve të kontrollit dhe llogaridhënies, legjislacionit të paplotë ose jo të përshtatshëm, institucione që në përgjithësi janë të dobëta dhe ku zbatimi i ligjit është i dobët.

Faktorë të tjerë që ndikojnë në korrupsionin policor përfshijnë edhe natyrën e punës policore, e cila e bën të pamundur për të kontrolluar aktivitetin e çdo punonjësi policie në terren, solidaritetin profesional dhe heshtjen ndaj keqsjelljes së kolegëve, pagat e ulëta dhe kontaktet e shpeshta me pjesëtarë të organizatave kriminale, të cilët kanë mjetet dhe burime të mjaftueshme dhe që synojnë të korruptojnë punonjësit e policisë (Newham 2002).<sup>151</sup>

Kompleksiteti i shkaqeve të korrupsionit policor ka çuar në identifikimin dhe zbatimin e qasjeve që e trajtojnë korrupsionin policor mbështetur në strategji, të cilat kombinojnë masat shtrënguese dhe dënimet me masat parandaluese, si dhe në bashkërendimin e reformave që përqendrohen përveç zbatueshmërisë së ligjit edhe në ndryshime strukturore dhe nxitjen e pjesëmarrjes së publikut nëpërmjet edukimit dhe ndërveprimit.

151 Gareth Newham, "Tackling police corruption in South Africa." Africa do Sul: Centre for the Study of Violence and reconciliation (2002).

Qëllimi kryesor i masave parandaluese është që të ndikojnë në ndryshimin e *strukturave* dhe *faktorëve* që nxisin korrupsionin dhe të krijojnë mjedisin institucional dhe rrethanat të cilat zvogëlojnë nxitjen dhe mundësitë për tu përfshirë në akte korrupsioni.

Reforma e sistemeve të menaxhimit, ndryshimi i kulturës organizative të institucioneve policore me mjete që forcojnë integritetin në të gjitha nivelet e institucionit të policisë, forcimi i mekanizmave llogaridhënies dhe që sjellin përfshirjen e një publiku të mirë informuar dhe aktiv, përbëjnë disa nga masat kryesore parandaluese.

Sistemet e dobëta të menaxhimit të burimeve njerëzore krijojnë mundësi dhe nxitje që punonjësit e policisë t'i kthehen korrupsionit si mjet për të arritur objektivat e tyre. Sistemi i papërshtatshëm i rekrutimit dhe kriteret e dobëta të përzgjedhjes shpien në rekrutimin e punonjësve të pakualifikuar, me integritet të ulët dhe me premisa për t'u përfshirë në korrupsion. Po kështu, sistemi i promovimit në detyrë duhet të jetë transparent, i ndershëm dhe i hapur. Sistemi i rekrutimit dhe karrierës duhet të jetë i hapur, i ndershëm dhe transparent për të bërë të mundur që të rekrutohen kandidatë me kualifikimet profesionale dhe standardet etike më të larta.

Në përpjekje për të nxitur standarde të rritjes në detyrë në bazë të meritës dhe karrierës punonjësit e policisë duhet të pajisen me dijet dhe aftësitë e duhura në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe me etikë. Kjo përfshin edhe ndërtimin e kapaciteteve që punonjësit e policisë të jenë në gjendje të dallojnë keqsjelljen dhe t'i rezistojnë dhe shmangin korrupsionin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Po kështu, edhe drejtuesit policorë duhet të trajnohen dhe përgatiten për atë se çka kërkohet prej tyre për të nxitur integritetin dhe për të dhënë shembullin e tyre personal. Ata duhet të pajisen me njohuri dhe aftësi për të motivuar stafet e tyre nëpërmjet shpërblimit për performancë të bazuar në sjellje etike.

Por përpjekjet për një polici me integritet nuk mund të jenë të suksesshme, nëse pagat janë të ulta, pasi ato krijojnë nxitjen për korrupsion. Nga ana tjetër, rritja e pagave nuk mund të ndikojë në uljen e korrupsionet, nëse nuk kombinohet me ngritjen e sistemeve të efektshëm të menaxhimit dhe masa për të zbatuar masat penalizuese.<sup>152</sup>

Një masë tjetër që ndikon në uljen e korrupsionit është rritja e transparencës në të gjithë sektorët e qeverisjes policore, si ato administrative ashtu edhe buxhetore.

152 Marie Chêne (2009). Low salaries and the culture of per diems and corruption, Transparency International/U4, (U4 Helpdesk query 220), Chr Michelsen Institute, Bergen, Norway, <http://www.u4.no/helpdesk/helpdesk/query.cfm?id=220>

Kufizimi i mundësisë që punonjës apo sektorë të policisë të përdorin sekretin si mbulesë për korrupsionin, kufizimi i mundësive për të abuzuar me kompetencat policore, përmirësimi i sistemeve të publikimit të të dhënave për shpenzimet buxhetore dhe i sistemeve të të dhënave mbi auditet dhe kontrollat janë masa që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e sjelljeve korruptive.

Transparenca në të gjithë segmentet e qeverisjes së policisë mund të kufizojë mundësitë për të influencuar negativisht dhe të rrisë besimin e publikut. Duhet të jetë e detyrueshme për policinë publikimi periodik i statistikave policore dhe fuqizimi dhe raportimi tek institucionet mbikëqyrëse i regjistrave dhe të dhënave që ndikojnë në uljen e korrupsionit.

Një kusht tjetër themelor për zbatimin e suksesshëm të strategjisë dhe masave antikorrupsion është dhe ndërtimi i një udhëheqje të besueshme dhe angazhimi për të mbështetur luftën kundër korrupsioni si brenda policisë ashtu edhe në institucionet jashtë saj. Drejtuesit e policisë dhe menaxherët luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e integritetit policor dhe për këtë duhet të jenë edhe një nga objektivat kryesorë të reformës antikorrupsion. Ata duhet të kenë aftësinë dhe vullnetin për të zbatuar rregullat dhe sistemin a disiplinës formale për të krijuar besimin dhe respektin e vartësve të tyre.

Por në rastin më të mirë strategjitë antikorrupsion duhet të synojnë që të krijojnë një kulturë organizative, e cila bazohet në kulturën etike dhe profesionalizmin më tepër sesa në masat shtrënguese dhe dënimet. Për këtë është e rëndësishme të krijohen dhe zbatohen kodet e sjelljes për të gjithë stafin policor, të cilat të trajtojnë të gjitha format e sjelljes joetike.<sup>153</sup>

Bashkëpunimi me publikun dhe lidhja me komunitetin janë gjithashtu kushte të rëndësishëm për të trajtuar keqsjelljen policore dhe korrupsionin. Publiku mund të luajë një rol të rëndësishëm duke raportuar rastet e korrupsionit dhe në të njëjtën kohë bashkëpunimi i policisë me komunitetet mund të rrisë legjitimitetin e institucionit të policisë duke i parë policët jo si burim frike por si burim mbrojtje.

Megjithatë, duhet të ekzistojnë edhe masa efektive reaguese, për të identifikuar, hetuar dhe dënuar punonjës të policisë që përfshihen në korrupsion apo keqsjellje.

Dhënia e kompetencave drejtuesve dhe menaxherëve të policisë për të zbatuar masat disiplinore në të gjitha nivelet si dhe forcimi i sistemit të llogaridhënies së tyre për ushtrimin e këtij funksioni, janë disa nga masat themelore për përmirësimin dhe përforcimin e sistemit të llogaridhënies së brendshme.

Po kështu kryerja a testeve të integritetit në mënyrë të rastësishme dhe të shpeshtë

153 Gareth Neëham, "Tackling police corruption in South Africa." Africa do Sul: Centre for the Study of Violence and reconciliation (2002).

si dhe fuqizimi i kontrolleve administrative, siç janë inspektimet dhe auditet e sistemeve të dokumentacionit, janë masa që forcojnë sistemin e llogaridhënies së brendshme.

Por reformat antikorrupsion në polici nuk mund të jenë të suksesshme pa reformimin e ligjeve dhe kontributin e gjyqësorit. Përfshirja në reformën ligjore dhe institucionale të masave që shtojnë mundësinë e zbulimit të rasteve të korrupsionit dhe rrisin masën e dënimeve janë të domosdoshme. Ripërkufizimi i korrupsionit në kodin penal dhe rritja masës së dënimit dhe sanksioneve për personat e përfshirë në korrupsion apo rritja e këtyre masave për vepra të caktuara korrupsioni kanë rezultuar të efektshme në vendet ku masa të tilla janë zbatuar.<sup>154 155</sup>

Një masë tjetër antikorrupsion është mbikëqyrja e jashtme nga parlamenti, institucionet e pavarura dhe publiku. Parlamenti luan një rol të veçantë pasi është institucioni i vetëm që miraton buxhetin dhe ligjet që rregullojnë aktivitetin e policisë dhe ka kompetenca që të mbikëqyrë zbatimin e tyre. Parlamenti duhet të ushtrojë në mënyrë ta vazhdueshme seanca dëgjimore me aktorë të ndryshëm dhe të ushtrojë fuqinë institucionale që ka për të ndërmarrë masa që shpien në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së policisë. Po kështu ngritja e komisioneve hetimore për të hetuar raste apo çështje të veçanta apo tema më të gjera që lidhen me korrupsionin përbëjnë instrumente të pazëvendësueshme që çojnë në forcimin e llogaridhënies.

Po kështu institucionet e pavarura si Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj., kanë një rol të rëndësishëm në hetimin e rasteve të korrupsionit që shpien në abuzime me të drejtat themelore të shtetasve apo në parandalimin e korrupsionit duke kontribuar në forcimin e menaxhimit financiar dhe burimeve të vëna në dispozicion të policisë.

Mjet tjetër i rëndësishëm antikorrupsion është ngritja e një sistemi të efektshëm të ankimit, i cili inkurajon qytetarët të raportojnë korrupsionin policor. Por për të qenë i besueshëm, një sistem i tillë duhet të jetë i lehtë për t'u përdorur nga qytetarët, duhet të ketë kapacitetet për të menaxhuar dhe zgjidhur ankesat dhe të jetë në gjendje të japë masa, nxjerrë rekomandime dhe mbrojtë bilbilfryrësit.<sup>156</sup>

154 Jon ST. Quah, "Combating corruption Singapore-style: Lessons for other Asian countries." Maryland Series in Contemporary Asian Studies 2007, no. 2 (2007): 1.

155 Valentine Anozie, Juhie Shinn, Katy Skarlatos, and Julio Urzua. "Reducing incentives for corruption in the Mexico City Police Force." In International Workshop, Public Affairs, vol. 869, pp. 2003-2004. 2004.

156 Marie Chêne, (2007). Anti-corruption complaints mechanisms, Transparency International/ U4, (U4 Helpdesk query 132), Chr Michelsen Institute, Bergen, Norway,



## 12. SHTOJCAT


### 12.1. Raport i detajuar i gjetjeve të anketimit me publikun

Sondazhi me publikun është zbatuar në periudhën Janar – Mars 2014 me 1.100 të anketuar në 36 qendra banimi në zona rurale dhe urbane të vendit. Për përcaktimin e kampionit është përdorur metoda e kampionimit të shtresëzuar me kuota të barabarta në 12 qendra urbane qendër qarku, 12 qytete dhe 12 komuna. Përzgjedhja e të anketuarve në secilën qendër banimi është bërë në mënyrë rastësore duke përfshirë qytetarë mbi moshën 18 vjeç.

#### 12.1.1. Përshkrimi i kampionit


Në bazë të metodës së përzgjedhur për kampionim – e cila mundëson shanse të barabarta përzgjedhjeje për qytetarë (potencialisht të intervistuar) të zonave të mëdha urbane (bashki qendër qarku), të mesme e të vogla urbane (bashki) si edhe të zonave rurale (komuna) – shumica e të anketuarve vijnë nga zona urbane (68%) dhe 32% prej tyre janë rezidentë të zonave rurale. Përbërja gjinore e të anketuarve është në raportet 54% me 46% në favor të meshkujve.

Të anketuarit sipas nivelit arsimor




■ Arsim i mesëm ■ Arsim universitar ■ Arsim pas-universitar ■ Refuzim

Nga pikëpamja e arsimimit, grupi i të intervistuarve shfaqet thujtë i barabartë mes atyre me arsim të mesëm (49%) dhe të intervistuar të cilët kanë kryer studimet e larta ose pas-universitare (në total rreth 44%). Shih Grafiku 1.



**Grupmoshat** janë të përfaqësuara në nivele të përafërta midis 18% dhe 25% me parjashtim të të intervistuarve që i përkasin grup-moshës mbi 56 vjeç të cilët zenë 15% të kampionit. Shih Grafiku me lart.




Sic tregohet edhe nga Grafiku me lart, shumica e të anketuarve deklarohen të punësuar (48%) ndërsa 25% janë të papunë. Studentët dhe pensionistët pasojnë këto dy kategori me nga 10% dhe 9% respektivisht.

### 12.1.2. Njohja e organizatave policore dhe korrupsioni tek to


Duke iu përgjigjur pyetjes se “Cila organizatë policore është më shumë e korrup-

tuar”, rreth 1/10 e të anketuarve kanë identifikuar të paktën një organizatë policore apo strukturë të saj (ose institucion tjetër) si të tillë.

Më shumë të korruptuar




Më pak të korruptuar



Grafiket me lart paraqesin përgjigjet relevante sipas së cilave rreth 61% e përgjigjedhënësve identifikojnë struktura të Policisë së Shtetit si më të korruptuara ku bie në sy se Policia rrugore dhe ajo e Rendit janë identifikuar më shpesh, respektivisht nga 16.5% dhe 10.9% e përgjigjedhënësve. Në lidhje me Policinë e Rendit, të anketuarit shfaqen të dyzuar pasi kjo strukturë renditet e katërta mes “organizat-


ave policore më pak të korrupuara” sipas të anketuarve”. Të pyetur në lidhje me organizatën policore më pak të korrupuar të anketuarit identifikojnë struktura të ndryshme, brenda dhe jashtë Policisë së Shtetit. Pjesa më e madhe e tyre shprehën se Policia Private (11.5%) është më pak e korrupuar, e ndjekur afër nga struktura e antikrimit (Hetimi dhe parandalimit të krimeve) në Policinë e Shtetit dhe organizatat policore të pushtetit vendor (bashki / komuna) me nga 9.8% respektivisht. Shih Grafiku me poshte.



Të anketuarve u është kërkuar të identifikojnë drejtuesit aktualë të Ministrisë së Brendshme (z. Sajmir Tahiri) dhe të Policisë së Shtetit (z. Artan Didi) si edhe ish-drejtuesit para tyre, respektivisht z. Flamur Noka dhe z. Hysni Burgaj, nga një total prej 4 alternativash për secilin pozicion (përfshirë edhe emrat e saktë). Grafiku 6 paraqet përqindjet e përgjigjeve të sakta për secilin drejtues, ku bie në sy fakti se mbi 2/3 e të anketuarve i identifikojnë saktë krerët aktualë dhe të mëparshëm të këtyre institucioneve. Ndërkohë që diferenca mes përgjigjeve të sakta për ish krerët e tyre (respektivisht F. Noka dhe H. Burgaj) është vetëm 4%, kjo diferencë thellohet ndjeshëm në 30% në rastin e krerëve aktualë.

Ky nivel njohurish pëson një rënie drastike kur të anketuarit pyeten nëse e njohin (1) Drejtorin e Policisë së Qarkut, (2) Drejtuesin e Komisariatit dhe (3) Inspektorin e policisë së lagjes / fshatit në zonat ku banojnë. Nga ana tjetër vlen të theksohet se përqindja e të anketuarve që e kanë këtë informacion vjen duke u rritur në raport me afërsinë që këto struktura të policisë kanë me komunitetin në bazë – nga

niveli i policisë së qarkut drejt inspektorit të zonës që është personi i cili “përballët” çdo ditë me qytetarët. Shih Grafiku me poshte.




Ndërkohë që ky trend është një indikacion lidhur me policimin në komunitet, pozitivitetit i tij vihet në pikëpyetje duke pasur parasysh se më shumë se gjysma e të anketuarve (53%) nuk e njohin inspektorin e zonës së Policisë së Shtetit.

81% e të anketuarve e dinë numrin e emergjencës së Policisë së Shtetit por nga ana tjetër, 75% deklarojnë se nuk kanë kërkuar kurrë ndihmën e policisë dhe vetëm 16% e kanë bërë këtë në 12 muajt e fundit (Janar 2013 – Janar 2014).

### 12.1.3. Informimi dhe perceptimet mbi korrupsionin


Televizioni mbetet burimi kryesor i informacionit mbi zhvillimet e përgjithshme në vend për 71% të të anketuarve, ndjekur nga interneti në vendin e dytë (17%) dhe gazetatat me 8%.

Mediat (TV, gazetatat, radio) mbeten gjithashtu burimi kryesor i informimit mbi korrupsionin në polici sipas 74% e të anketuarve, ndjekur nga “rrethi familjar e shoqëror” (18%). “Korrupsioni në polici” është më pak prezent si temë tek “kollegët dhe rrethi i punës” i të anketuarve (vetëm 1%). Shih Grafiku me poshte.



Thuajse  $\frac{3}{4}$  e të anketuarve deklarojnë se dëgjojnë “Shpesh” 45% ose “Thuajse gjithmonë” 29% për **korrupsionin në Polici** dhe vetëm  $\frac{1}{4}$  dëgjojnë “Rrallë” 21% ose “Asnjëherë” 2% (Refuzim, 3%).

Sa shpesh degjoni ose ndesheni me informacion per oficerë policie të korruptuar?




Përgjigjet e pyetjes pasardhëse – Sa shpesh dëgjoni ose ndesheni me informacion për oficerë policie të korruptuar? – shfaqin një ndryshim të dukshëm tek përqindjet që marrin alternativat “Rrallë” dhe “Thuajse gjithmonë”. Më konkretisht, 60% e të anketuarve shprehen se dëgjojnë “Thuajse gjithmonë” (16%) ose “Shpesh” in-

formacione të tilla, ndërsa 1/3 e tyre deklarojnë se ndeshen “rrallë” (32%) ose “asnjëherë” (4%) me informacion mbi oficerë policie të korruptuar. Shih Grafiku 9.

Pyetjes “A mendoni se ka oficerë të korruptuar në Policinë e Shtetit?”, vetëm 4% e të anketuarve i përgjigjen negativisht përkundër pjesës dërrmuese prej 82% të cilët besojnë se ka oficerë policie të korruptuar (14% nuk kanë mendim).

Nga ana tjetër, të pyetur se “në çfarë mase është i përhapur korrupsioni në Policinë e Shtetit” shumica e të anketuarve mendojnë se është “i përhapur në masë të konsiderueshme” (33%) ose “mjaft i përhapur dhe serioz” (18%). Grafiku 10 paraqet totalin e përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit.


Anketimi u ka kërkuar përgjigje-dhënësve të vlerësojnë shkallën e korrupsionit në nivelet e ndryshme të Policisë së Shtetit, duke filluar nga nivelet e larta drejtuese në Drejtorinë e përgjithshme të policisë së shtetit e deri në nivelin bazë të oficerëve të policisë në komisariate.




Siç tregohet edhe nga Grafiku 11, vlerësimi negativ i të anketuarve vjen duke u rritur sa më shumë zbret nga niveli më i lartë i PSH (Drejtoria e Përgjithshme) tek niveli bazë i oficerëve të policisë në komisariate. I vetmi përjashtim janë “Niveli i mesëm drejtues në komisariate” i cili vlerësohet më pozitivisht sesa drejtuesit e komisarariatit apo se oficerët e nivelit bazë.

Policia rrugore, Sektori kundër narkotikëve dhe trafiqeve, dhe Sektori kundër krimit financiar perceptohen nga qytetarët si tre strukturat ku korrupsioni është më shumë i përhapur. Bie në sy Policia Rrugore, për të cilën një shumicë dërrmuese prej 74% e të anketuarve japin vlerësimin “4-i përhapur” (24.5%) ose “5-mjaft i përhapur” (49.5%). Strukturat ku korrupsioni është më pak i përhapur

sipas vlerësimit të qytetarëve janë – SHKB, Rendi dhe Administrata në drejtoritë e policisë së qarkut dhe komisarite. Grafiku 12 paraqet vlerësimin mesatar nga “1 – Korrupsioni nuk ekziston” në “5 – Shumë i përhapur”.



Të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë sa dakord bien me disa pohime në lidhje me korrupsionin në Policinë e Shtetit. Tabela e mëposhtme paraqet përqindjet për secilin vlerësim të pohimeve të ndryshme në një shkallë nga “1 – **aspak dakord**” në “5-**plotësisht dakord**”. Shih Tabela 1.





**Tabela 1. Sa dakord bini me pohimet e mëposhtme?**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (aspak dakord)	2	3	4	5 (plotësisht dakord)
Në radhët e PSH ka mjaft oficerë policie të pakorruptuar	9%	17%	24%	20%	29%
Oficerët e policisë janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e Policisë	26%	27%	21%	14%	12%
Sa më shumë organizata policore (Policia) në vend aq më i lartë korrupsioni	20%	18%	25%	18%	19%
Oficerët e vjetër (në moshë) të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët e rinj	18%	16%	21%	21%	23%
Oficerët meshkuj të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët femra	7%	8%	18%	22%	46%
Institucioni i PSH nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij	6%	13%	21%	20%	40%
Oficerët e policisë që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyra	12%	14%	25%	20%	29%
Oficerët në nivelet e larta të PSH e tolerojnë korrupsionin e vartësve të tyre	9%	15%	27%	24%	25%
Mosveprimi i drejtuesve të PSH për të luftuar korrupsionin dekurajon oficerët e Policisë	4%	13%	23%	24%	35%
Shumica e oficerëve të PSH janë të motivuar për zbatimin e ligjit	7%	18%	28%	24%	24%
Shumica e oficerëve të PSH shpesh e përdorin ligjin si mjet presioni mbi qytetarët për qëllime përfitimi	7%	16%	27%	22%	28%

Tre deklaratat për të cilat shumica dërrmuese e të anketuarve kanë tendencën të bien dakord janë:

- *Oficerët meshkuj të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët femra*
- *Institucioni i PSH nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij*
- *Mosveprimi i drejtuesve të PSH për të luftuar korrupsionin dekurajon oficerët e Policisë*

Gjithashtu, shumica prej tyre nuk beson se “Oficerët e policisë janë të korrumpuar që para se të hyjnë në radhët e Policisë”. Nga ana tjetër, të anketuarit janë të ndarë në vlerësimin e tyre në lidhje me pohimin “Sa më shumë organizata policore (Polici) në vend aq më i lartë korrupsioni”. Sa i përket deklaratave të tjera, pjesa më e madhe e të anketuarve kanë tendencën të jenë dakord, por vërehet se një pjesë e mirë e tyre shfaqen neutralë.

#### 12.1.4. Përvojat me korrupsionin

Seksioni vijues i pyetësorit të hartuar për këtë anketim synon të identifikojë eksperiencat konkrete të të anketuarve lidhur me korrupsionin në Policinë e Shtetit, në mënyrë që të identifikohet shkalla e shtrirjes së tij në praktikë dhe njëherësh, balafaqimi i “perceptimit” me “përvojën” e përjetuar nga të anketuarit.

Më pak se ¼ e të anketuarve (24%) pranojnë se kanë pasur ndërveprim apo kontakt me një oficer policie gjatë 12 muajve të fundit (Janar 2013 – Janar 2014) dhe 11% të tjerë, një vit më parë ose më herët. Shumica dërmuese e tyre (69%) kanë pasur ndërveprim me Policinë e Shtetit dhe pjesa tjetër me Polici bashkiake ose tjetër.

Të pyetur nëse u ka ndodhur personalisht t’u jetë kërkuar shprehimisht ryshfet gjatë vitit të fundit, 65% e të anketuarve i përgjigjen negativisht. Nga pjesa tjetër e të anketuarve (35%) të cilët e konfirmojnë këtë përvojë, 21% deklarojnë se u është kërkuar ryshfet nga oficerë të Policisë Rrugore, 4% nga Policia Kufitare dhe Migracionit, dhe po kaq policia bashkiake / komunale. Nga ana tjetër, të pyetur nëse kanë paguar ryshfet gjatë vitit të fundit, sërisht 65% shprehen “JO”, ndërsa nga ata që kanë paguar, 23% e të anketuarve deklarojnë se kanë paguar Policinë Rrugore. Tabela e mëposhtme paraqet përgjigjet e të anketuarve që konfirmojnë kërkesën për ryshfet dhe faktin se kanë paguar ryshfet lidhur me të dy pyetjet. Shih Tabela 2.

**Tabela 2. “Më është kërkuar ryshfet” dhe “Kam paguar ryshfet”**

Institucioni	Më është kërkuar ryshfet	Kam paguar ryshfet
Policia Rrugore	21 %	23 %
Antidroga (Sektori Policisë kundër narkotikëve dhe trafiqeve)	2 %	1 %
Policia Kufitare dhe Migracionit	4 %	3 %
Policia e Rendit	2 %	2 %
Antikrimi (Sektori Policisë kundër krimeve të rënda)	-	0,5 %
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm	-	0,5 %
Administrata e Policisë së Qarkut	2 %	1 %
Administrata e Komisarariatit të policisë	1 %	1 %
Policia bashkiake / komunale	4 %	3 %
Tjetër	1 %	-

Një përqindje më e vogël e të anketuarve shprehen se gjatë vitit të fundit u është kërkuar apo kanë kryer ndonjë favor. 81% e të anketuarve shprehen se nuk u është kërkuar favor dhe 83% se nuk kanë kryer ndonjë favor për oficerë të ndryshëm të PSH. Pjesa më e madhe e përgjigje-dhënësve që i konfirmojnë këto përvoja, sërish identifikojnë Policinë Rrugore si më problematike – 10% e të anketuarve pohojnë se u është kërkuar ndonjë favor dhe 8% se kanë kryer ndonjë favor për pjesëtarë të Policisë Rrugore. Shih Tabela 3.

**Tabela 3. “Më është kërkuar favor” dhe “Kam kryer favor”**


Institucioni	Më është kërkuar favor	Kam kryer favor
Policia Rrugore	10 %	8 %
Antidroga (Sektori Policisë kundër narkotikëve dhe trafiqeve)	1 %	1 %
Policia Kufitare dhe Migracionit	1 %	2 %
Policia e Rendit	2 %	2 %

Antikrimi (Sektori Policisë kundër krimeve të rënda)	-	-
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm	1 %	-
Administrata e Policisë së Qarkut	-	-
Administrata e Komisarariatit të policisë	1 %	1 %
Policia bashkiake / komunale	3 %	3 %
Tjetër	-	-

Gjithsej janë 304 të anketuar ose 28% e totalit të kampionit të sondazhit, të cilët i janë përgjigjur pyetjes “Nëse keni paguar rryshfet ose keni kryer një favor gjatë vitit të fundit për ndonjë nga punonjësit e strukturave të mësipërme, cili ka qenë reagimi i tyre?”. Pjesa tjetër kanë zgjedhur alternativën “Nuk e di / Refuzim”. 86% e tyre deklarojnë se punonjësit e kanë pranuar rryshfetin / favorin ndërsa 14% se nuk e kanë pranuar.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (45%) nuk e dinë se ku mund të denoncojnë një akt (ose tentativë) korrupsioni nga një oficer i Policisë së Shtetit.

Nuk kam denoncuar akt/tentativë korrupsioni sepse...



Ndonëse në total 55% e qytetarëve kanë informacion se ku mund të denoncojnë një akt të tillë, vetëm 5% e të anketuarve deklarojnë se kanë denoncuar një akt / tentativë korrupsioni nga një oficer policie (91% thonë JO dhe 4% refuzim).

Të anketuarit të cilët deklarojnë se nuk kanë denoncuar asnjë akt / tentativë korrupsioni nga një oficer i PSH (91% e kampionit) janë pyetur më tej lidhur me arsyet. Shih Grafiku 13.

Përveç të anketuarve të cilët nuk janë ndeshur ndonjëherë me këtë situatë (56%) apo të cilët refuzojnë përgjigjen (12%), tek ata të cilët ofrojnë një arsye (gjithësej 32%) bie në sy fakti se shumica deklarojnë se “Nuk kanë pasur besim tek institucioni ku do të denonconin” (12%) ose se “Ka qenë më e lehtë të zgjidh problemin me anë të rryshfetit / favorit” (9%).

Përkundër 45% e të anketuarve të cilët më sipër deklarojnë për se nuk e dinë se ku mund të denoncojnë një akt (ose tentativë) korrupsioni nga një oficer i PSH, vetëm 6% e të anketuarve arsyetojnë se nuk kanë denoncuar akt/tentativë korrupsioni për këtë arsye.

### 12.1.5. Llojet dhe shkalla e korrupsionit

Sondazhi ka synuar gjithashtu të identifikojë dhe matë perceptimet e të anketuarve lidhur me llojet e ndryshme të korrupsionit dhe nivelin e tyre të përhapjes tek institucioni i Policisë së Shtetit. Lidhur me llojet e korrupsionit, të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë sa shpesh ndodhin aktet e mëposhtme në Policinë e Shtetit, në një shkallë nga “1 – Thuajse asnjëherë” në “5-Shumë shpesh”. Shih Tabela 4.

**Tabela 4. “Sa shpesh ndodhin aktet e mëposhtme në Policinë e Shtetit?”**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Thuajse asnjëherë)	2	3	4	5 (Shumë shpesh)
Rryshfeti	5%	9%	23%	27%	36%
Nderet / favoret prej të tretëve (jashtë policisë)	7%	18%	32%	26%	17%
Nderet / favoret për të tretët (nga ana e policisë)	7%	20%	32%	24%	17%
Nderet / favoret për kolegët e tyre (brenda policisë)	6%	15%	25%	26%	27%
Shpërdorimi fondeve të policisë	13%	23%	26%	18%	21%
Shpërdorimi mjeteve të policisë	15%	21%	25%	20%	19%
Manipulimi provave	12%	21%	29%	21%	26%
Përdorimi i dhunës së tepruar nga ana e policisë	16%	23%	25%	19%	18%

“Ryshfeti” dhe “Nderet / favorët për kolegët brenda policisë” janë të vetmet akte për të cilat mund të thuhet me siguri të lartë se sipas perceptimit të të anketuarve **ndodhin shpesh në Policinë e Shtetit**. Ndërkohë që në të gjitha rastet e tjera shumica e të anketuarve japin vlerësimin 3, akte apo rrethana të tjera kryesisht problematike janë “Manipulimi i provave”, “Nderet / favorët prej të tretëve (jashtë policisë)” apo “Nderet / favorët për të tretët (nga ana e policisë)”. Të anketuarit janë pyetur më tej lidhur me të tjera fenomene negative të cilat perceptohen ose janë raportuar më parë nga burime të ndryshme se janë të pranishme në Policinë e Shtetit. Shih Tabela 5.

**Tabela 5. “Sa dakord bini me këto deklaratat?”**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3 (neutral)	4	5 (Plotësisht dakord)
Oficerët e policisë bashkëpunojnë me njerëz të inkriminuar dhe / ose me organizata kriminale	13%	28%	26%	14%	19%
Oficerët e policisë janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme (si trafiqe, kontrabandë, etj.)	10%	28%	30%	15%	17%
Rekrutimi i oficerëve të policisë kryhet mbi baza korruptive	11%	24%	28%	19%	18%
Emërimet dhe gradimet në nivele të larta të policisë janë korruptive	12%	21%	26%	21%	20%
Emërimet dhe gradimet në nivele të mesme dhe të ulta të policisë janë korruptive	11%	22%	28%	21%	18%
Drejtuesit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive	9%	20%	25%	20%	26%
Drejtuesit politikë dhe oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	9%	19%	25%	21%	26%
Oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	9%	21%	28%	19%	23%
Prokurimet në polici kryhen në mënyrë korruptive	13%	25%	27%	17%	18%
Oficerët e policisë e krijojnë vetë mundësinë për përfitim nëpërmjet korrupsionit	8%	20%	27%	20%	25%

Pavarësisht se vlerësimi neutral (3) ndaj pohimeve të ndryshme mbetet në nivele të larta (25% deri në 30%) disa përfundime dalin qartë. Së pari, të anketuarit shfaqen përgjithësisht të sigurt se bashkëpunimi me organizata kriminale / njerëz të inkriminuar (pohimi i parë) apo përfshirja e oficerëve të policisë në aktivitete të kundërligjshme (pohimi i dytë) nuk përbën shqetësim. Ky konstatim në rastin e pohimit të dytë duhet marrë me rezerva jo vetëm për shkak të nivelit të lartë të vlerësimit neutral, por gjithashtu edhe për shkak të diferencës prej vetëm 5% krahasuar me përqindjen e atyre që e shohin si problematike. Mbi 40% e të anketuarve bien dakord (vlerësime 4 dhe 5) vërtetësinë e pesë pohimeve, tre prej të cilave identifikojnë “ndërhyrjen e politikës” në drejtimin dhe menaxhimin e PSH, ndërsa dy të tjerat kanë të bëjnë me vetë shërbimin. Më konkretisht:

- *Emërimet dhe gradimet në nivele të larta të policisë janë korruptive (41%)*
- *Drejtuësit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive (46%)*
- *Drejtuësit politikë dhe oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive (47%)*
- *Oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive (42%)*
- *Oficerët e policisë e krijojnë vetë mundësinë për përfitim nëpërmjet korrupsionit (45%)*

Diferenca me të anketuarit që nuk janë dakord me këto pohime është qartësisht e lartë pavarësisht se thuhetse  $\frac{1}{4}$  e të anketuarve janë neutralë. Ndërsa për 3 pohimet e mbetura – c); e) dhe i) – të anketuarit shfaqen përgjithësisht të ndarë, vlen të theksohet se situata është disi më e qartë lidhur me pohimin se “*Emërimet dhe gradimet në nivele të mesme dhe të ulta të policisë janë korruptive*” (39% e të anketuarve janë plotësisht/dakord).

### 12.1.6. Shkaqet e jashtme të korrupsionit

Të anketuarit janë pyetur se “sa i përhapur është korrupsioni” tek njëmbëdhjetë institucione të ndryshme (shtetërore ose jo), në një shkallë nga “1-Aspak” në “5-Shumë i përhapur”. Institucionet për të cilat shumica dërrmuese e përgjigje-dhënësve shprehet se **korrupsioni nuk është i përhapur** (vlerësimet 1 dhe 2) janë: Presidenti (65%), Avokati i Popullit (62%), Shoqëria civile (62%). Ndonëse në një përqindje më të ulët të vlerësimit 1 dhe 2 (total 45% e të anketuarve) dhe me përqindjen më të lartë të vlerësimit mesatar, 3 (31%), Mediat deri diku gëzojnë besimin e publikut si institucion ku korrupsioni nuk është i përhapur. (Shih Tabela 6.)

Tabela 6. “Sa i përhapur është korrupsioni?”


Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak)	2	3	4	5 (Shumë i përhapur)
Presidenti	35%	30%	16%	10%	9%
Parlamenti	16%	22%	26%	16%	21%
Këshilli Ministrave	16%	23%	22%	19%	20%
Ministria e Brendshme	15%	23%	28%	19%	15%
Prokuroria	8%	11%	22%	25%	34%
Gjykatat	5%	9%	15%	22%	49%
Kontrolli Lartë i Shtetit	11%	17%	31%	21%	20%
Inspektorati Lartë i Kontrollit & Deklarimit të Pasurive	9%	17%	26%	23%	25%
Media	16%	29%	31%	13%	11%
Shoqëria civile	29%	33%	21%	11%	6%
Avokati Popullit	33%	29%	19%	9%	10%

Institucionet për të cilat shumica dërrmuese e të anketuarve shprehet se korrupsioni është shumë / i përhapur (vlerësimet 4 dhe 5) janë Gjykatat (72%) dhe Prokuroria (59%). Inspektorati Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive-ILKDP (48%) dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit-KLSH (41%) gjithashtu perceptohen si institucione nën të njëjtën kategori, ndonëse vlerësimi mesatar (3) i të anketuarve kap shifrat e 31% në rastin e KLSH dhe 26% për ILKDP. Tre institucionet për të cilat të anketuarit shfaqen të ndarë në vlerësimet e tyre janë Parlamenti (përqindjet për secilin opsion nga 1 – 5 variojnë nga 16% deri në 26% e të anketuarve), Këshilli i Ministrave (nga 16% në 23%) dhe Ministria e Brendshme (përqindjet për secilin opsion nga 1 – 5 variojnë nga 14% në 28%). Për këtë të fundit, ka një diferencë të lehtë në favor të vlerësimeve 1 dhe 2 (37%) krahasuar me vlerësimet 4 dhe 5 (34%).

Të anketuarit janë pyetur se “sa të efektshme kanë qenë në luftën kundër korrupsionit në policinë e shtetit” institucione dhe aktorë të tjerë me ndikim në vend, në një shkallë nga “1-Aspak të efektshme” në “5-Shumë të efektshme”. Shih Grafiku me poshte.



Sa të efektshëm në luftën anti-korrupsion në PSH...?



Siç vërehet edhe nga Grafiku me lart tre aktorët më shumë të efektshëm në luftën kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit sipas perceptimit të përgjigje-dhënësve janë Ndërkombëtarët (BE, SHBA, OSBE), Media dhe Shoqëria civile. Më pak të efektshme shfaqen Partitë politike, Presidenti dhe Parlamenti.

Pozitiviteti i të anketuarve lidhur rolin e ndërkombëtarëve në luftën anti-korrupsion në PSH vërehet edhe nga përgjigjet për pyetjen pasardhëse – “A mendoni se ndihma ndërkombëtare dhe e BE ka ndihmuar në zvogëlimin e korrupsionit në polici?”. 67% e tyre shprehen se PO dhe vetëm 25% mendojnë të kundërtën. Megjithatë, përgjigje-dhënësit shfaqen disi të dyzuar kur pyeten – “Nëse anëtarësimi në NATO ka ndihmuar në zvogëlimin e korrupsionit në polici”. Kështu, 48% e tyre i përgjigjen pozitivisht pyetjes, përkundër 35% që thonë JO dhe 16% “Nuk e di”.

### 12.1.7. Shkaqet e brendshme të korrupsionit

“Pagat e ulëta” kanë shumë ndikim tek shkalla e korrupsionit në Policinë e Shtetit sipas 60% e të anketuarve. Thuajse gjysma e tyre mendojnë të njëjtën gjë për “Trajnimin e dobët” dhe “ndikimin politik”. Siç vërehet nga të dhënat e mëposhtme në Tabelën 6, “kultura e korrupsionit në shoqërinë shqiptare” konsiderohet me shumë ndikim nga më shumë të anketuar krahasuar me “kulturën e punës së PSH si faktor”. Shih Tabela 7.


Tabela 7. “Sa ndikojnë tek shkalla e korrupsionit në PSH...?”

Faktorët	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak ndikim)	2	3	4	5 (Shumë ndikim)
Pagat e ulëta	4%	4%	13%	19%	60%
Trajnim i dobët	3%	7%	18%	25%	48%
Ndikimi politik	3%	5%	17%	25%	49%
Kultura e punës në institucionin e policisë	4%	7%	25%	28%	36%
Kultura e korrupsionit në shoqërinë shqiptare në përgjithësi	4%	8%	22%	27%	39%

Të pyetur në lidhje me kushtet e punës së Policisë së Shtetit, shumica e të anketuarve (44%) i konsiderojnë “të pranueshme”, 18% të mira dhe vetëm 3% shumë të mira. 26% e përgjigje-dhënësve i konsiderojnë “të këqija” ndërsa 9% nuk kanë mendim për këtë çështje.

### 12.1.8. Toleranca ndaj korrupsionit

Akte, sjellje dhe (mos)veprime të caktuara nga zyrtarë shtetërorë perceptohen në mënyra të ndryshme nga qytetarët. Të pyetur në lidhje me disa akte / veprime të tilla nga oficerë të policisë (Grafiku 15) të anketuarit në një masë të konsiderueshme i shohin si akte korruptive.



Megjithatë, bie në sy fakti se një pjesë e të anketuarve nuk i konsiderojnë si të tilla dhe më konkretisht – 18% në rastin kur oficeri i policisë “pranon shërbime falas nga subjekte private”; 10% kur “ndihmon dikë për të përfituar 1 shërbim pa radhë”; 9% në rastin e “manipulimit të provave” dhe 8% kur “shkel rregullat e trafikut rrugor jashtë shërbimit dhe nuk ndëshkohet”. Shumica e të anketuarve (70%) mendojnë se një oficer policie duhet të largohet nga PSH në rast se konstatohet përfshirja e tij në aktivitete të kundërligjshme apo bashkëpunon me njerëz të inkriminuar / organizata kriminale. Masa alternative ndaj tij sipas mendimit të përgjigje-dhënësve janë – “Vërejtje / paralajmërim për largim nga puna” (10%) apo “Transferimi në detyrë tjetër” (5%), ndërsa 6% e të anketuarve nuk kanë opinion dhe 9% sugjerojnë masë “Tjetër”.

Së fundi, (mos)toleranca e të anketuarve ndaj korrupsionit në policinë e shtetit është testuar edhe në lidhje me disa akte ose pritshmëri të tjera nga oficerët e policisë. Tabela 8 (më poshtë) paraqet qëndrimet e të anketuarve ndaj pohimeve të ndryshme, në një shkallë nga “1-Aspak dakord” në “5-Plotësisht dakord”.

**Tabela 8. “Toleranca ndaj korrupsionit – akte & pritshmëri”**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3	4	5 (Plotësisht dakord)
Është e drejtë që oficerët e PSH të kryejnë punë tjetër jashtë orarit të punës	43%	14%	17%	9%	17%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në marrje ryshfeti	4%	6%	8%	15%	67%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në dhënie e informacioneve policore personave / organizatave kriminale	4%	5%	6%	13%	72%
Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në organizata kriminale	3%	4%	4%	11%	78%
Disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës	25%	16%	21%	15%	23%
Kryerja e një pune të dytë jashtë orarit të punës nga oficerët e PSH ndikon negativisht në përmbushjen e detyrës në polici	20%	14%	17%	14%	35%

Tre deklaratat për të cilat shumica e të anketuarve bien plotësisht dakord me përqindje mjaft të vogla të atyre që nuk bien dakord janë:

- *Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në marrje rryshfeti*
- *Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në dhënien e informacioneve policore personave / organizatave kriminale*
- *Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në organizata kriminale*

Një pjesë e mirë e të anketuarve (43%) nuk janë dakord me pohimin se “Është e drejtë që oficerët e PSH të kryejnë punë tjetër jashtë orarit të punës”, por vlen të theksohet se thujse 26% e tyre japin vlerësim 4 ose 5 dhe rreth 17% shfaqen neutralë.


Të dhënat e Tabelës 7 tregojnë se nuk ka konsensus mes të anketuarve lidhur me pohimin se “Disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës”, ku vlerësimet janë ndarë mes të pestë opsioneve 1-5 me vlera që variojnë nga 15% në 25%.

Së fundi, shumica e të anketuarve kanë tendencën të mbështesin opinionin se “Kryerja e një pune të dytë jashtë orarit të punës nga oficerët e PSH ndikon negativisht në përmbushjen e detyrës në polici”. Megjithatë, gjysma tjetër e të anketuarve janë të ndarë mes qëndrimit neutral (3) dhe kundërshtues (1-2).

### 12.1.9. Besimi për të luftuar korrupsionin


Përkundër këtyre qëndrimeve dhe perceptimeve mbi korrupsionin në Policinë e Shtetit të anketuarit shfaqen kryesisht pozitivë sa i përket perspektivës apo mundësive për të ulur korrupsionin. Shih Grafikët me poshte.

**A mendoni se korrupsioni në polici mund të zvogëlohet?**



39% e të anketuarve shprehen se është “Plotësisht e mundur” të zvogëlohet korrupsioni në polici dhe po aq mendojnë se PSH është e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes; 41% dhe 43% respektivisht mendojnë se është e mundur “deri në njëfarë mase”. Zvogëlimi i korrupsionit në PSH dhe aftësia e policisë për ta luftuar korrupsionin Brenda vetes shihen si mision “i pamundur” ose “Kryesisht i pamundur” nga 14% dhe 16% e të anketuarve respektivisht.

**A besoni se policia është e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes?**



Ndërkohë që të anketuarit në një masë të madhe (80%) shfaqen kryesisht me besim se Policia është e aftë të luftojë korrupsionin, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për pritshmëritë nga dhe besimin tek institucione të tjera sa i përket luftës kundër korrupsionit në Polici. Tabela 9 paraqet vlerësimet e të anketuarve lidhur me pyetjen më poshtë:

*Pyetje: Sa besim keni se do të luftojnë korrupsionin në polici. Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-aspak besim dhe 5-shumë besim.*

**Tabela 9. Besimi tek institucionet në luftën antikorrupsion në PSH**


Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak besim)	2	3	4	5 (shumë besim)
Kryeministri	13%	12%	17%	21%	37%
Ministri Brendshëm	12%	13%	19%	20%	36%
Drejtori përgjithshëm i PSH	11%	15%	24%	22%	28%
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm	11%	16%	29%	23%	21%
Prokurori përgjithshëm	18%	22%	30%	18%	12%
Avokati popullit	18%	23%	25%	17%	17%
Inspektoriat i Lartë Kontrollit & Deklarimit të Pasurisë	24%	24%	30%	13%	9%
Parlamenti	24%	22%	26%	17%	10%
Gjyqësori	36%	23%	20%	13%	8%
Prokuroria	29%	23%	23%	14%	11%
Kontrrolli i Lartë i Shtetit	16%	22%	32%	19%	11%
Partitë politike	37%	25%	19%	12%	7%
Shoqëria civile	13%	22%	25%	20%	20%
Media	7%	12%	24%	27%	30%

Siç tregohet edhe nga Tabela 8, tre institucionet kryesore për të cilët mbi gjysma e të anketuarve kanë shumë/besim se do të luftojnë korrupsionin në Polici (vlerësim 4 dhe 5) janë: Kryeministri (58%), Media (57%) dhe Ministri i brendshëm (56%). Drejtori i përgjithshëm i PSH gjithashtu e gëzon këtë besim nga 50% e të anketuarve. Tre institucionet kryesore që gëzojnë pak ose aspak besim (vlerësim 1 dhe 2) tek qytetarët për këtë sfidë janë: Partitë politike (62%), Gjyqësori (59%) dhe Prokuroria (49%).

Për të gjitha institucionet e tjera bie në sy fakti se pjesa më e madhe e të anketuarve (25% deri në 32%) zgjedhin vlerësimin mesatar (3). Gjithsesi, tendencë pozitive (më shumë besim) shfaqin vlerësimet e të anketuarve lidhur me SHKB (44%) dhe shoqërinë civile (40%), ndërkohë që më pak besim (vlerësim 1 dhe 2) gëzojnë IL-KDP (48%), Parlamenti (46%), Avokati i Popullit (41%), Prokurori i përgjithshëm (40%) dhe KLSH (38%).

Pavarësisht besimit, të anketuarit janë të ndarë sa i përket pritshmërive kohore në lidhje me rezultatet konkrete të luftës kundër korrupsionit në polici – minimizimi i këtij fenomeni.

Lufta kundër korrupsionit në PSH do të japë rezultate (minimizim i korrupsionit):



Grafiku 18: tregon pikërisht këtë “mungesë konsensusi” tek përgjigje-dhënësit.

### 12.1.10. Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave antikorrupsion

Për të kuptuar më mirë qëndrimet, perceptimet, përvojat dhe pritshmëritë e të anketuarve, dhe nga ana tjetër, për të identifikuar nivelin e njohurive dhe perceptimeve të tyre mbi kuadrin ligjor dhe të politikave antikorrupsion në fuqi, seksioni i fundit i pyetësorit fokusohet pikërisht tek opinionet dhe qëndrimet e tyre mbi këtë kuadër.


**52%** e të anketuarve deklarojnë se “**nuk kanë njohuri**” dhe **38%** se kanë “**pak njohuri**” mbi kuadrin ligjor dhe të politikave antikorrupsion në Policinë e Shtetit, ndërsa vetëm 1/10 e tyre e njohin “**mirë**” (**8%**) ose “**shumë mirë**” (**2%**).

Ky nivel i ulët i njohurive i të anketuarve shfaqet edhe në përgjigjet e tyre kur u kërkohet opinion mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor / politikave për parandalimin e korrupsionit në polici. Më konkretisht, siç vërehet edhe nga Grafiku 19, janë 40% e përgjigje-dhënësve që nuk kanë opinion për këtë çështje. Nga ana tjetër, 30% mendojnë se është “i përshtatshëm deri diku” dhe 15% “plotësisht i përshtatshëm”.

Shih Grafiku me poshte.

Thuajse e njëjta situatë shfaqet edhe kur të anketuarit pyeten lidhur me **përshtatshmërinë e kuadrit ligjor / politikave për hetimin e korrupsionit në PSH**. 39% e të anketuarve nuk kanë opinion, 29% shprehen “deri diku”, 15% plotësisht i përshtatshëm dhe pjesa tjetër “shumë pak” (13%) ose “aspak” (4%). Të anketuarit nuk shfaqen kaq uniform kur bëhet fjalë për nivelin e zbatimit të kuadrit ligjor/politikave për **parandalimin** dhe atij për **hetimin** e korrupsionit në PSH. Figurat 20 paraqet grafikisht këtë diferencë të lehtë e cila vërehet tek alternativat “shumë pak” dhe “deri diku”.

A është i përshtatshëm kuadri ligjor dhe i politikave në fuqi për të parandaluar korrupsionin në PSH?




Më shumë të anketuar (10%) mendojnë se parandalimi deri diku merr më shumë vëmendje sesa hetimi. Gjithashtu, më shumë të anketuar (34%) mendojnë se zbatohet “shumë pak” kuadri për hetimin, krahasuar me kuadrin ligjor dhe të politikave për parandalimin (26%).

Në një shkallë nga “1-aspak të efektshme” në “5-shumë të efektshme” të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë SHKB, Inspektimet dhe Auditin e brendshëm:

*Pyetje: Sipas mendimit tuaj, sa të efektshme janë institucionet e mëposhtme për të hetuar korrupsionin në polici?*




Me një devijim standard prej 1.18, të anketuarit vlerësojnë më shumë SHKB (3,34) dhe Inspektimi (3.18), ndërsa auditi i brendshëm merr një vlerësim mesatar prej 3.04.



Grafiku 21: efektshmeria e masave anti-korrupsion

Së fundi, sondazhi ka tentuar të identifikojë edhe vlerësimin e të anketuarve për masa konkrete antikorrupsion në PSH. Shih Grafiku me poshte.



*Pyetje: Sa të efektshme janë masat e mëposhtme në luftën kundër korrupsionit në Policinë e shtetit? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-aspak te efektshme dhe 5-shumë të efektshme.*

Tre masat për të cilat të anketuarit shfaqen dukshëm skeptikë janë:

- *Zëvendësimi i drejtuesve të PSH*
- *Kontrolli më i mirë nga parlamenti*
- *Kontroll më i mirë i konfliktit të interesit*

Tre preferencat më të larta të të anketuarve lidhur me masat e propozuara paraqesin një kombinim interesant mes “stimujve”, “kapaciteteve” dhe masës me karakter “represioni”. Më konkretisht:

- *Përmirësim i pagave*
- *Përmirësim i shkollimit / trajnimit*
- *Dënime më të ashpra*


“Përmirësim i kushteve të punës” (4,16) shfaqet gjithashtu i vlerësuar lart nga të anketuarit, ndërkohë dy masat e mbetura – “Forcimi i kuadrit ligjor/institucional” dhe “Përmirësimi i politikave antikorrupsion” – qëndrojnë diku në mes.

## **12.2. SHTOJCA 2 - Raport i detajuar i gjetjeve të anketimit me punonjësit e PSH**

*Sondazhi me punonjësit e Policisë së Shtetit është zbatuar në periudhën Shkurt – Mars 2014 në drejtoritë dhe komisariatet e PSH në të gjithë vendin. Për këtë sondazh është përzgjedhur një kampion prej 370 të anketuarish të shpërndarë në kuota përfaqësuese për secilën strukturë policore të intervistuar. Përzgjedhja e të anketuarve në secilën qendër intervistimi është bërë në mënyrë rastësore duke përfshirë oficerë policie të ndodhur në vendin e punës.*


### **12.2.1. Përshkrimi i kampionit**

Kampioni i përzgjedhur i anketimit me punonjës së policisë së shtetit, nga pikëpamja e përfaqësimit gjinor dominohet në një masë të madhe nga meshkuj me një raport prej 83% me 17% në disfavor të femrave.




Grafiku paraqet kampionin sipas grupmohave të përfaqësuara në të ku vërehet qartë se të anketuarit e grupmohës “36-45 vjeç” mbizotërojnë (39%), të ndjekur nga grupmosha “46-55 vjeç” (27%) dhe “26 – 35 vjeç” që arrin në 23% të kampionit. Shih Grafiku 1.

Nga pikëpamja e **arsimimit**, **46% e të anketuarve** deklarojnë se **arsimi i mesëm** është shkalla më e lartë që kanë kryer dhe po aq (**46%**) deklarojnë se kanë arsim **universitar**. Vetëm **7.6%** prej tyre kanë përfunduar studime **pasuniversitare** ndërkohë që 0.4% refuzojnë të përgjigjen.



Të anketuarit sipas gradave




Siç vërehet nga grafiku i cili paraqet përbërjen e plotë të kampionit sipas gradave të punonjësve të PSH të anketuar, “niveli zbatues” (Nën-inspektor, Inspektor, Krye-inspektor) dominon përbërjen e kampionit, i ndjekur nga “niveli i parë drejtues” (nën-komisar,


komisar dhe krye-komisar), ndërsa niveli i mesëm dhe i lartë drejtues zë më pak se 1% të kampionit. Të anketuar me gradën “Inspektor” (41.7%) dhe “Krye-inspektor” (26.3%) përbëjnë thuhetse 2/3 e kampionit të sondazhit. Shih Grafiku me lart. Sondazhi ka synuar gjithashtu që të fokusohet tek oficerët e Policisë së Shtetit që kanë më shumë kontakt me qytetarët. Si pasojë, shumica e të anketuarve deklarojnë se janë oficerë terreni (79%) ndërsa 21% të kundërtën. Shih Grafiku me lart.

Kampioni i përzgjedhur shfaq është shpërndarë në nivele të pranueshme sa i përket përvojës në shërbim. Kategoria më shumë e përfaqësuar janë të anketuarit me “11 deri në 20 vjet” përvojë pune në Policinë e Shtetit (39%) dhe më pak e përfaqësuar (2%) ajo e “mbi 30 vjet përvojë”. Shih Grafiku me poshte.

#### Experienca në shërbimin e PSH




Së fundi, Grafiku me poshte. Paraqet përbërjen e kampionit sipas shërbimit policor në të cilin janë të angazhuar të anketuarit. Pjesa më e madhe e kampionit (68.3%) përbëhet nga të anketuar të shërbimit të sigurisë publike (rendi, policia rrugore, parandalimi krimi etj), 14% nga shërbimi kundër krimi të organizuar dhe krimeve të rënda dhe 12.6% e të anketuarve nga Policia Kufitare & e Migracionit. Administrata/mbështetja dhe trajnimi policor janë më pak të përfaqësuara në përbërjen e kampionit. Shih grafikun me poshte.



### 12.2.2. Njohja e organizatave policore dhe korrupsioni tek to


Pyetjes se “Cila organizatë policore është më shumë e korruptuar” kanë pranuar t’i përgjigjen rreth 27.3% e të anketuarve. Grafiku 6 paraqet perceptimet e punonjësve të PSH lidhur më këtë çështje ku bie në sy se tre strukturat më shumë të korruptuara sipas tyre janë Policia Rrugore, Tatimore dhe ajo e Kufirit dhe migracionit.

Më shumë e korruptuar...




Më pak të anketuar i janë përgjigjur pyetjes se “Cila organizatë policore është më pak e korruptuar” (19.3%). Ndryshe nga pyetja pararendëse ku përgjigjet identifikojnë edhe një strukturë jashtë PSH (Pol. Tatimore), të anketuarit kanë tendencën të qëndrojnë Brenda shërbimit kur bëhet fjalë për organizatën policore më pak të korruptuar.

Më pak e korruptuar...




Siç vërehet edhe nga Grafiku me lart, më pak të korruptuara janë Rendi dhe siguria publike (27.1%), Policia e Shtetit (24.3%) dhe vend i tretë ndahet mes Policisë së kufirit dhe migracionit dhe Antikrimit me nga 8.6% secila.

A keni degjuar të flitet për korrupsionin në Polici?



Punonjësit e PSH të anketuar përdorin TV (61%) dhe internetin (20%) si mjetet kryesore të informimit për zhvillimet e përgjithshme në vend. Rrethi familjar e shoqëror (11%), Gazetat (5%), Radio (1%) dhe tjetër mjet informimi (2%) përdoren më pak prej tyre për këtë qëllim.

Nga cili burim dëgjoni me shume për korrupsionin në polici?




Shumica e të anketuarve (41%) shprehen se dëgjojnë “rrallë” për korrupsionin në

Polici dhe 3% “asnjëherë”. Nga ana tjetër, afërsisht gjysma e të anketuarve deklarojnë se dëgjojnë “shpesh” (35%) ose “thujse gjithmonë” (14%). Shih Grafiku 8.

Media mbetet gjithashtu burimi kryesor i informacionit mbi korrupsionin në polici ndërkohë që vlen të theksohet se “përvojat personale” dhe “rrethi i punës” gjithashtu raportohen si burime të tilla informacioni. Shih Grafiku me lart.

### Për oficerë policie të korruptuar dëgjoj...




Të pyetur se sa shpesh dëgjojnë ose ndeshen me informacion për oficerë policie të korruptuar shumica dërrmuese e të anketuarve shprehen se dëgjojnë “rrallë” (60%) ose “asnjëherë” (8%). Vetëm ¼ e përgjigje-dhënësve konfirmojnë dijeni të tilla ndërsa 8% refuzojnë të përgjigjen. Shih Grafiku 10.

Pavarësisht “hezimit” apo “kujdesit” në lidhje me disa prej pyetjeve të mësipërme, të anketuarit në një masë të madhe (58%) besojnë se ka oficerë të korruptuar në Policinë e Shtetit. 16% prej tyre besojnë të kundërtën dhe 26% nuk e dinë.




Në çfarë mase mendoni se korrupsioni është i përhapur në Policinë e Shtetit?



Pavarësisht këtij perceptimi, të anketuarit nuk e shohin si serioz nivelin e korrupsionit në Policinë e Shtetit. Shumica e tyre mendojnë se korrupsioni është i kufizuar në “raste të izoluar” (37.1%) ose “jo në nivele serioze” (32.6%). Rreth 12% e shohin si një fenomen të përhapur ose serioz. *Shih Grafiku me lart.*

Ndonëse me diferenca tejet të vogla, të anketuarit janë më shumë “kritikë” ndaj drejtuesve të lartë në nivel drejtorie e PSH në qark ose Drejtori e Përgjithshme e PSH dhe më positive ndaj niveleve më të ulëta të shërbimit.




**Grafiku 12.**

Paraqet grafikisht këto tendenca të cilat gjithsesi japin një vlerësim përgjithësisht pozitiv të shërbimit për veten e vet.

Të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë shkallën e korrupsionit në struktura të ndryshme të Policisë së Shtetit duke përdorur një shkallë nga 1 (nuk ekziston) në 5 (shumë i përhapur).

Ndonëse kuptueshëm punonjësit e policisë kanë tendencën për të vlerësuar pozitivisht strukturat e ndryshme të shërbimit me vlerësime që variojnë nga 1.65 në 2.74, diferencat e lehta gjithsesi ndihmojnë për të bërë disa dallime. Më konkretisht, Policia rrugore (2.74), Sektori kundër krimit financiar (2.64) dhe Policia kufitare dhe e migracionit (2.51) marrin vlerësim më negativ nga përgjigje-dhënësit.



Nga ana tjetër, strukturat e Rendit dhe sigurisë publike (1.65), Sektori kundër krimeve të rënda (1.84) dhe Administrata në drejtoritë e Policisë së Shtetit në nivel qarku dhe komisarate (1.89) shfaqin një tendencës më pozitive në vlerësimin e të anketuarve. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (SHKB) gjithashtu shfaqet pranë kësaj kategorie me një vlerësim mesatar prej 1.90. Shih Figura 13.

Sondazhi ka synuar të analizojë qëndrimet e të anketuarve punonjës së Policisë së Shtetit në lidhje me disa çështje dhe pohime mbi korrupsionin në PSH. Tabela e mëposhtme paraqet përqindjet për secilin vlerësim të pohimeve të ndryshme në një shkallë nga “1 – aspak dakord” në “5-plotësisht dakord”. Shih Tabela 1.

**Tabela 1. Sa dakord bini me pohimet e mëposhtme?**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (aspak dakord)	2	3 (neutral)	4	5 (plotësisht dakord)
a) Në radhët e PSH ka mjaft oficerë policie të pakorruptuar	24,9%	13,6%	5,5%	8,7%	47,3%
b) Oficerët e policisë janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e Policisë	54%	20,3%	13%	5,9%	6,8%
c) Sa më shumë organizata policore (Policia) në vend aq më i lartë korrupsioni	40,7%	14,1%	16,6%	6,3%	22,3%
d) Oficerët e vjetër (në moshë) të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët e rinj	47,7%	17,3%	14,1%	9,1%	11,8%
e) Oficerët meshkuj të PSH janë më të korruptuar sesa oficerët femra	40%	19,3%	15,5%	9,1%	16,1%
f) Institucioni i PSH nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij	24,9%	15,3%	9,4%	6,7%	43,7%
g) Oficerët e policisë që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyrë	46,3%	22%	17%	5%	9,7%
h) Oficerët në nivelet e larta të PSH e tolerojnë korrupsionin e vartësve të tyre	41,7%	21,9%	19,8%	8,6%	8%
i) Mosveprimi i drejtuesve të PSH për të luftuar korrupsionin dekurajon oficerët e Policisë	24%	14,5%	12,4%	10,9%	38,2%
j) Shumica e oficerëve të PSH janë të motivuar për zbatimin e ligjit	13%	6,3%	13%	11,5%	56,2%
k) Shumica e oficerëve të PSH shpesh e përdorin ligjin si mjet presioni mbi qytetarët për qëllime përfitimi	45,3%	27,3%	14,7%	6,8%	5,9%

Tre deklaratat për të cilat shumica e të anketuarve kanë tendencën të **bien dakord** janë:


1. Në radhët e PSH ka mjaft oficerë policie të pakorruptuar
2. Institucioni i PSH nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij
3. Shumica e oficerëve të PSH janë të motivuar për zbatimin e ligjit

Pavarësisht një tendencë të lehtë dakordësimi, të anketuarit shfaqen të ndarë në qëndrimet e tyre lidhur me pohimin se “Mosveprimi i drejtuesve të PSH për të luftuar korrupsionin dekurajon oficerët e Policisë”. Nga ana tjetër, për të gjitha pohimet e tjera, të anketuarit në shumicë dërrmuese (vlerësime 1 dhe 2) shprehin tendencën mos-miratuese.

### 12.2.3. Përvojat mbi korrupsionin

Në mënyrë që të analizohen më qartë dhe të përballen perceptimet me realitetin, seksioni pasues i sondazhit fokusohet tek përvojat e përgjigje-dhënësve mbi korrupsionin. Grafiku 14. (më poshtë) paraqet përvojën e të anketuarve me situata apo fenomene korruptive në punën e tyre të përditshme. Shih Grafiku me poshte.

Gjatë 12 muajve të fundit më ka ndodhur që...




Pyetje: Gjatë 12 muajve të fundit, a ju ka ndodhur JU personalisht ndonjë nga

situatat e mëposhtme? Siç vërehet nga përgjigjet e dhëna, ryshfeti apo favorët e ndryshme nuk janë një situatë e pazakontë. Gjatë 12 muajve të fundit 36% e oficerëve të policisë të intervistuar konfirmojnë se u është ofruar të paktën një herë ryshfet dhe kjo – të paktën 1 herë në 18% të rasteve, disa herë në 12% dhe pjesa tjetër deklarojnë se u është ofruar shpesh (3%) ose shumë shpesh (3%). Nderet apo favorët janë akoma më serioze – 60% e të anketuarve e konfirmojnë këtë dhe konkretisht: të paktën 1 herë sipas 31% e të anketuarve, disa herë për 19%, shpesh 5% dhe shumë shpesh sipas 5% e të anketuarve.

Pjesëtarët e PSH të anketuar nga sondazhi konfirmojnë (54%) edhe fenomenin e favorëve që kërkojnë kolegët në polici dhe kjo – 30% e tyre thonë se u ka ndodhur të paktën një herë, 17% disa herë, 3.5% shpesh dhe 3.5% shumë shpesh. Nga ana tjetër, rreth 1/3 e të anketuarve deklarojnë se u ka ndodhur që eprori t’ju ketë kërkuar të bëjnë lëshime ndaj dikujt – 20% të paktën 1 herë, 9% disa herë, 3% shpesh dhe 2% deklarojnë se kjo u ndodh shumë shpesh. ¼ e të anketuarve konfirmojnë se kanë denoncuar një qytetar për tentativë korrupsioni. Kjo shifër bie në nivelin e 5% kur bëhet fjalë për denoncimin e eprorit dhe në 8% për denoncimin për korrupsion të një kolegu, oficer policie.

Gjatë 12 muajve të fundit jam ndeshur me oficerë policie ...



Të anketuarve u është kërkuar gjithashtu të ndajnë informacion mbi situata korruprive apo akte denoncimi të korrupsionit nga ana e kolegëve të tyre të cilat ata i kanë dëshmuar personalisht. Pyetja e mësipërme dhe e mëposhtme e pyetësorit janë të ndërlidhura njëra me tjetrën pasi shërbejnë për të kontrolluar dhe krahasuar përgjigjet e

dhëna nga të anketuarit për secilën prej tyre. Qartësisht, të dhënat nxjerrin në pah disa gjetje të rëndësishme. Shih Grafiku me lart.

*Pyetje: Gjatë 12 muajve të fundit, a jeni ndeshur ndonjëherë JU personalisht me ndonjë nga situatat e mëposhtme?*

Ndërkohë që 36% e të anketuarve deklarojnë se u është ofruar ryshfet të paktën një here (shih Grafiku 14), vetëm 13% konfirmojnë se kanë parë të paktën një herë një oficer policie duke marrë ryshfet dhe 18% se kanë parë një oficer policie duke kërkuar ryshfet/favor nga qytetarit (shif Grafiku 15). Favoret që qytetarët i kërkojnë oficerëve të policisë tek Grafiku 14 janë konfirmuar nga 60% e të anketuarve, por vetëm 35% tek pyetja pasardhëse (Grafiku 15) deklarojnë se kanë parë një oficer policie t'i ofrojë favor qytetarit. Përqindjet e figurave 14 dhe 15 janë më pranë njëra tjetrës kur bëhet fjalë për favor mes kolegësh në policinë e shtetit, përkatësisht 47% (përvoja personale) dhe 45% (dëshmi e përvojave të kolegëve). Lidhur me denoncimin e akteve të korrupsionit, 32% deklarojnë se janë ndeshur të paktën një herë me situata kur një oficer policie denoncon qytetarin për tentative korrupsioni. Vetëm 11.5% e të anketuarve dëshmojnë se gjatë 12 muajve të fundit kanë parë një oficer policie të denoncojë kolegun apo eprorin.

#### 12.2.4. Llojet dhe shkalla e korrupsionit

Sondazhi ka synuar të identifikojë perceptimet e të anketuarve lidhur me llojet e ndryshme të korrupsionit dhe nivelin e tyre të përhapjes tek institucioni i Policisë së Shtetit.

**Tabela 2. “Sa shpesh ndodhin aktet e mëposhtme në Policinë e Shtetit?”**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Thuajse asnjëherë)	2	3	4	5 (Shumë shpesh)
Ryshfeti	41,4	38,5	12,2	5,8	2,1
Nderet / favoret prej të tretëve (jashtë policisë)	36.4	37	17.7	6.5	2.4
Nderet / favoret për të tretët (nga ana e policisë)	42.2	36.8	14.3	5.5	1.2
Nderet / favoret për kolegët e tyre (brenda policisë)	40.3	33.3	15.5	7.3	3.6
Shpërdorimi fondeve të policisë	45.1	22.1	12.4	9.8	10.6
Shpërdorimi mjeteve të policisë	42	23.9	15.2	8.4	10.5
Manipulimi provave	78.5	13.9	5.2	1.2	1.2
Përdorimi i dhunës së tepruar nga ana e policisë	61.2	26.8	7.6	2.9	1.5

Lidhur me llojet e korrupsionit, të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë sa

shpesh ndodhin aktet e mëposhtme në Policinë e Shtetit, në një shkallë nga “1 – Thuajse asnjëherë” në “5-Shumë shpesh”. Shih Tabela 2.

Shumica e të anketuarve kanë tendencën të jenë kategorikë në vlerësimet e tyre për llojet e mësipërme të korrupsionit. Në rastin e “manipulimit të provave” dhe “përdorimit të dhunës së tepruar” gati 2/3 e të anketuarve shprehen se nuk ndodhin thuajse asnjëherë. Nga ana tjetër, janë rreth 20% e të anketuarve të cilët deklarojnë se shpërdorimi i fondeve apo i mjeteve të policisë ndodh shpesh (4) ose shumë shpesh (5).

Të anketuarit janë pyetur më tej lidhur me vërtetësinë ose jo për të tjera fenomene negative të cilat perceptohen ose janë raportuar më parë nga media dhe të tjera burime se janë prezente në Policinë e shtetit. Shih Tabela 3.

**Tabela 3. “Sa dakord bini me këto deklarata?”**

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3 (neutral)	4	5 (Plotësisht dakord)
Oficerët e policisë bashkëpunojnë me njerëz të inkriminuar dhe / ose me organizata kriminale	60.2%	29.7%	5.8%	2.6%	1.7%
Oficerët e policisë janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme (si trafikë, kontrabandë, etj.)	58.6%	28.6%	8.5%	2%	2.3%
Rekrutimi i oficerëve të policisë kryhet mbi baza korruptive	61.9%	21.7%	9.4%	2.3%	4.7%
Emërimet dhe gradimet në nivele të larta të policisë janë korruptive	42.4%	21.8%	16.3%	7%	12.5%
Emërimet dhe gradimet në nivele të mesme dhe të ulta të policisë janë korruptive	48.1%	27.1%	11.9%	5%	7.9%
Drejtuesit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive	49.6%	20.5%	13.5%	6.4%	10%
Drejtuesit politikë dhe oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	58.2%	23.4%	7.6%	5.8%	5%
Oficerët e policisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre për qëllime korruptive	69.8%	17.7%	9.5%	1.2%	1.8%
Prokurimet në polici kryhen në mënyrë korruptive	54.1%	21.1%	9.9%	7.6%	7.3%

Oficerët e policisë e krijojnë vetë mundësinë për përfitim nëpërmjet korrupsionit	59.2%	24.6%	11.2%	1.8%	3.2%
---	-------	-------	-------	------	------

Siç vërehet edhe nga Tabela 3, të anketuarit kundërshtojnë kategorikisht edhe pohimet e mësipërme të cilat janë përmendur herë pas here nga aktorë të ndryshëm dhe media si shqetësime. Një “thyerje” të lehtë të kësaj tendence vërehet në lidhje me qëndrimet e të anketuarve ndaj tre pohimeve të mëposhtme:

1. *Emërimet dhe gradimet në nivele të larta të policisë janë korruptive*
2. *Emërimet dhe gradimet në nivele të mesme dhe të ulta të policisë janë korruptive*
3. *Drejtuësit politikë e përdorin policinë për qëllime korruptive*

Ndonëse përqindja e të anketuarve që nuk bien dakord me këto deklarata mbetet relativisht e lartë (mbi 40%), një pjesë jo e vogël të anketuarish, 10% deri në 20%, shprehen se janë dakord (4) ose plotësisht dakord (5).

### 12.2.5. Shkaqet e jashtme të korrupsionit

Të anketuarit janë pyetur se “sa i përhapur është korrupsioni” tek njëmbëdhjetë institucione të ndryshme (shtetërore ose jo), në një shkallë nga “1-Aspak” në “5-Shumë i përhapur” (dhe “3-neutral”). Shih Tabela 4.

**Tabela 4. “Sa i përhapur është korrupsioni?”**


Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak)	2	3	4	5 (Shumë i përhapur)
Presidenti	60.4	21.9	6.6	4.5	6.6
Parlamenti	45.7	22.1	15.2	6.9	10.1
Këshilli Ministrave	54.8	19.4	16.4	4.6	4.8
Ministria e Brendshme	60.2	21.5	10.5	5.7	2.1
Prokuroria	19.6	16.7	16.1	17.9	29.7
Gjykatat	14.6	12.8	13.4	16.3	42.9
Kontrolli Lartë i Shtetit	32.3	22.9	18.6	14.9	11.3
Inspektorati Lartë i Kontrollit & Deklarimit të Pasurive	26.9	21.5	17.6	14	20
Media	25.9	25.6	24.4	10.4	13.7



Shoqëria civile	41.2	30.1	15.8	6.9	6
Avokati Popullit	53.8	21.8	12.2	5.9	6.3

Më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se korrupsioni nuk është aspak i përhapur tek këto institucione: Presidenti, Këshilli Ministrave, Ministria e Brendshme dhe Avokati Popullit. Parlamenti dhe shoqëria civile pasojnë renditjen me rreth 70% të të anketuarve që japin vlerësimin 1 ose 2, të ndjekur nga KLSH (rreth 55%) dhe Media (rreth 51%). Gjykatat janë sipas shumicës së të anketuarve (42.9%) institucioni ku korrupsioni është shumë i përhapur, e ndjekur nga Prokuroria (29.7%), ndërkohë që për ILKDP të anketuarit shfaqen deri diku të ndarë në gjykimin e tyre, ndonëse tendenca për një vlerësim pozitiv (1 dhe 2) është e qartë. Të anketuarit janë pyetur se “sa të efektshme kanë qenë në luftën kundër korrupsionit në policinë e shtetit” institucione dhe aktorë të tjerë me ndikim në vend, në një shkallë nga “1-Aspak të efektshme” në “5-Shumë të efektshme”. Shih Grafiku me poshte.

Tre **institucionet më shumë** të efektshme në luftën kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit sipas të anketuarve janë Ministria e Brendshme (3.71), Policia (3.7) dhe



Ndërkombëtarët (3.6). Këshilli i Ministrave, Media dhe shoqëria civile ndjekin nga afër këtë kategori ndërkohë që institucioni më pak i efektshëm janë partitë politike (2.24), pasuar nga Presidenti dhe Gjykatat me vlerësim rreth 2.6 dhe nga Prokurori dhe Parlamenti me vlerësim mesatar rreth 2.8.

Pozitiviteti i të anketuarve lidhur rolin e ndërkombëtarëve në luftën anti-korrupsion në PSH vërehet edhe nga përgjigjet për pyetjen pasardhëse.

Pyetje: A mendoni se ndihma ndërkombëtare dhe e BE ka ndihmuar në zvogëlimin e korrupsionit në polici?

81% e tyre shprehen se PO dhe vetëm 10% mendojnë të kundërtën ndërsa 9% “Nuke e di”. E njëjta tendencë pozitive ndonëse në nivele më të ulëta vërehet edhe kur të anketuarit pyeten – “Nëse anëtarësimi në NATO ka ndihmuar në zvogëlimin e korrupsionit në polici”. Kështu, 61% e tyre i përgjigjen pozitivisht pyetjes, përkundër 23% që thonë JO dhe 16% “Nuk e di”.


### 12.2.6. Shkaqet e brendshme të korrupsionit

Duke analizuar shkaqet e brendshme të korrupsionit në Policinë e Shtetit, “pagat e ulëta” janë i vetmi faktor të cilin më shumë se gjysma e të anketuarve e shohin si shumë ndikues. Ndonëse shkaqet e tjera, siç shihet edhe nga tabela e mëposhtme, vlerësohen me “shumë ndikim” nga shumica e të anketuarve, vlerësimet 4 dhe 5 të marra së bashku në asnjë rast nuk e arrijnë shifrën e 50% e të anketuarve. Gjithsesi, nga faktorët e tjerë, “ndikimi politik” dhe “kultura e korrupsionit në shoqëri” vlerësohen relativisht lartë nga të anketuarit. Shih Tabela 5.

**Tabela 5. “Sa ndikojnë tek shkalla e korrupsionit në PSH...?”**

Faktorët	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak ndikim)	2	3	4	5 (Shumë ndikim)
Pagat e ulëta	11.5%	6.9%	13.2%	12.6%	55.8%
Trajnim i dobët	17.9%	13.9%	21.8%	17.6%	28.8%
Ndikimi politik	20.7%	12.1%	18%	15.9%	33.3%
Kultura e punës në institucionin e policisë	23%	14.4%	20.7%	17.4%	24.5%
Kultura e korrupsionit në shoqëri-në shqiptare në përgjithësi	16.3%	15.4%	20.1%	19.2%	29%

Grafiku i mëposhtëm paraqet grafikisht vlerësimin e kushteve të punës nga vetë oficerët e policisë të intervistuar. Shih Grafiku më poshtë.



Rreth 1/3 e të anketuarve i konsiderojnë të këqija kushtet e punës së oficerëve të policisë së shtetit, ndërsa pjesa më e madhe (44%) “të pranueshme.

Katër pohime të cilat kanë të bëjnë me pagat në PSH, Kodi Etikës dhe rregulloret e brendshme të shërbimit u janë parashtruar të anketuarve për vlerësim. Shih Tabela 6.

*Tabela 6. Pa/Mjaftueshmëria e instrumenteve – Pagat, Kodi i Etikës & Rregulloret e brendshme*

Deklarata	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3	4	5 (Plotësisht dakord)
Pagat e nivelit të mesëm & të ulët në PSH janë të mjaftueshme për një jetesë normale	45.5%	23.4%	15%	6.8%	9.3%
Pagat e nivelit të lartë në PSH janë të mjaftueshme për një jetesë normale	11.4%	18.1%	23.6%	15.4%	31.5%
Kodi i Etikës nuk ka ndikuar aspak për parandalimin e korrupsionit në PSH	28.9%	21.1%	15.8%	13.4%	20.8%
Rregulloret e brendshme të PSH lënë mjaft hapësirë për korrupsion	46.3%	23.2%	14.6%	6.4%	9.5%

Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë tendencën të mos bien dakord (vlerësim 1 dhe 2) lidhur me dy deklaratat:


- *Pagat e nivelit të mesëm & të ulët në PSH janë të mjaftueshme për një jetesë normale*
- *Rregulloret e brendshme të PSH lënë mjaft hapësirë për korrupsion*

Një pjesë e mirë e të intervistuarve nga ana tjetër mendojnë se “pagat e nivelit të lartë në PSH janë të mjaftueshme për një jetesë normale”. Lidhur me ndikimin e Kodit të Etikës, pavarësisht tendencës për ta vlerësuar pozitivisht nga ana e gjysma e të anketuarve, rreth 1/3 e tyre nuk mendojnë kështu (vlerësime 4 dhe 5).

### 12.2.7. Toleranca ndaj korrupsionit

Akte, sjellje dhe (mos)veprime të caktuara nga oficerët e Policisë së Shtetit perceptohen në mënyra të ndryshme nga qytetarët. Të pyetur në lidhje me disa akte / veprime të tilla të kolegëve të tyre oficerë të PSH (Grafiku 18) mbi 60% e të anketuarve i konsiderojnë si akte korruptive. Rreth ¼ e përgjigje-dhënësve mesatarisht (nga 22% në 27%) nuk i konsiderojnë si të tilla ndërsa rreth 10% nuk kanë opinion. Shih Grafikumë poshtë.

A konsiderohet akt korrupsioni nëse 1 oficer policie...?



Toleranca e të anketuarve – punonjës së Policisë së shtetit – shfaqet në pothuajse të njëjtat nivele edhe kur ata pyeten se çfarë mase duhet marrë ndaj një oficeri policie për të cilin konstatohet se është përfshirë në aktivitete të kundërligjshme apo bashkëpunon me njerëz të inkriminuar / organizata kriminale. Më konkretisht, 65% e të anketuarve shprehen se ai duhet të largohet nga radhët e PSH, 19% sugjerojnë “vërejtje / paralajmërim për largim”, 3% “transferim” dhe 6,8% “masë tjetër” (6.2% shprehen “Nuk e di”).

Së fundi, (mos)toleranca e të anketuarve ndaj korrupsionit në policinë e shtetit është testuar edhe në lidhje me disa akte ose pritshmëri të tjera nga oficerët e policisë. Tabela 7 (më poshtë) paraqet qëndrimet e të anketuarve ndaj pohimeve të ndryshme,

në një shkallë nga “1-Aspak dakord” në “5-Plotësisht dakord”.

Tabela 7. “Toleranca ndaj korrupsionit – akte & pritshmëri”

Pohimi	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak dakord)	2	3 (neutral)	4	5 (Plotësisht dakord)
a) Është e drejtë që oficerët e PSH të kryejnë punë tjetër jashtë orarit të punës	36.1%	15.2%	14.9%	8.6%	25.2%
b) Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në marrje ryshfeti	11.9%	6.8%	12.4%	10.4%	58.5%
c) Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në dhënien e informacioneve policore personave / organizatave kriminale	10.3%	5.6%	5.9%	5.3%	72.9%
d) Një oficer policie duhet të denoncojë kolegët që përfshihen në organizata kriminale	5.6%	3.9%	6.8%	5.4%	78.3%
e) Disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës	32.3%	15.4%	18.3%	11.5%	22.5%
f) Kryerja e një pune të dytë jashtë orarit të punës nga oficerët e PSH ndikon negativisht në përmbushjen e detyrës në polici	31.9%	11.7%	13.7%	11.4%	31.3%

Shpërndarja e përqindjeve në shkallët e ndryshme të vlerësimit për disa prej pohimeve të mësipërme flet për mënyra të ndryshme të kuptuari ose tolerance ndaj akteve të ndryshme apo pritshmërive prej oficerëve të policisë. Të anketuarit janë në një masë të madhe (mbi 70%) dakord me pohimet se duhen denoncuar kolegët që “përfshihen në dhënien e informacioneve policore personave / organizatave kriminale” ose që “përfshihen në organizata kriminale”. 58.% janë dakord se duhen denoncuar “kolegët që përfshihen në marrje ryshfeti” por nga ana tjetër janë rreth 19% të cilën kanë tendencën të mos bien dakord (vlerësimi 1 dhe 2).

Të intervistuarit shfaqen të ndarë në qëndrimet e tyre lidhur me pohimin e fundit – Kryerja e një pune të dytë jashtë orarit të punës nga oficerët e PSH ndikon negativisht në përmbushjen e detyrës në polici – në rreth 43% që kanë tendencën të mos bien dakord karshi rreth 42% që shfaqin tendencë të kundërt (vlerësim 4 dhe 5).


Së fundi, pavarësisht se shumica e të anketuarve nuk bien dakord, rreth 1/3 duket se i justifikojnë (vlerësime 4 dhe 5) pohimet e mëposhtme:

- Është e drejtë që oficerët e PSH të kryejnë punë tjetër jashtë orarit të punës
- *Disa rregulla edhe mund të shkelen nga oficerët e PSH për të mirën e punës*

### 12.2.8. Besimi për të luftuar korrupsionin

Grafiku i mëposhtë (shih Grafiku 19) paraqet përgjigjet e të intervistuarve lidhur me dy pyetje si vijon:


- Pyetje 1: “A mendoni se korrupsioni në Policinë e Shtetit mund të zvogëlohet?”
- Pyetje 2: “A mendoni se Policia e Shtetit është e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes?”



Shumica e të anketuarve janë optimistë për të dy pyetjet por gjithsesi me më shumë besim lidhur me pyetjen e dytë. **70.6%** besojnë se **PSH është e aftë të luftojë korrupsionin brenda vetes** (plotësisht e mundur). Ky nivel optimizmi pëson një rënie kur bëhet fjalë për rezultatin konkret – “zvogëlimi i korrupsionit

brenda PSH” – rreth 1/3 besojnë se kjo mund të ndodhë deri në një farë mase.

Sa besim keni se do luftojnë korrupsionin në PSH?



Shumica e të anketuarve duket se shfaqin më shumë besim tek drejtuesit e disa institucioneve si p.sh. Ministri i Brendshëm, Kryeministri apo Drejtori i Përgjithshëm i PSH, si edhe tek SHKB. Partitë politike dhe gjyqësori janë të vetmet institucione për të cilat përqindjet e vlerësimit “aspak besim” janë më të mëdha se vlerësimi “shumë besim. Grafiku e mëposhtme paraqet grafikisht përgjigjet “shumë besim” dhe “aspak besim” për secilin prej institucioneve për të cilët të intervistuarit janë pyetur se sa besim kanë se do të luftojnë korrupsionin në PSH. Shih Grafiku 20.

Vlerësimet e plota të të anketuarve për secilin prej institucioneve paraqiten në Tabelën 8.

*Pyetje: Sa besim keni se do të luftojnë korrupsionin në polici. Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-aspak besim dhe 5-shumë besim.*


Tabela 8. Besimi tek institucionet në luftën antikorrupsion në PSH

Institucioni	Përqindja për secilin vlerësim				
	1 (Aspak besim)	2	3	4	5 (shumë besim)
1) Kryeministri	5%	9%	11%	12%	63%
2) Ministri Brendshëm	5%	6%	10%	12%	67%
3) Drejtori përgjithshëm i PSH	4%	4%	10%	18%	64%
4) Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm	6%	10%	15%	17%	52%
5) Prokurori përgjithshëm	12%	17%	21%	15%	35%
6) Avokati popullit	12%	19%	17%	14%	38%
7) Inspektorati Lartë Kontrollit & Deklarimit të Pasurisë	17%	18%	23%	15%	27%
8) Parlamenti	15%	16%	22%	18%	29%
9) Gjyqësori	27%	17%	21%	11%	24%
10) Prokuroria	20%	17%	25%	13%	25%
11) Kontrolli Lartë i Shtetit	17%	19%	25%	14%	25%
12) Partitë politike	46%	22%	14%	5%	13%
13) Shoqëria civile	14%	14%	25%	17%	30%
14) Media	15%	12%	20%	20%	33%

Përveç katër institucioneve të para, më shumë se gjysma e të anketuarve kanë besim (4) ose shumë besim (5) tek Prokurori përgjithshëm, Avokati popullit dhe Media. Ndryshe nga rasti i drejtuesit të Prokurorisë, të anketuarit shfaqen mjaft të ndarë në lidhje me besimin që ata kanë tek institucioni i Prokurorisë, ku vlerësimet me 1 dhe 2 janë pothuajse të barabarta me përqindjet që marrin ato 4 dhe 5. I njëjti fenomen vërehet edhe në rastin e KLSH ku dallimi mes atyre që kanë besim (vlerësim 4 dhe 5) dhe atyre që nuk kanë (vlerësimi 1 dhe 2) është vetëm 3%. Parlamenti, ILDKP dhe shoqëria civile gjithashtu gëzojnë besim ndonëse në nivele më të ulëta. Vlen të theksohet gjithsesi kontradikta mes mungesës së theksuar të besimit për partitë politike (vlerësimet 1 dhe 2 në nivelet e 68%) dhe besimit që i jepet institucionet të Parlamentit (vlerësim 4 dhe 5 në nivelin e 47%), ku në fakt marrin pjesë pikërisht partitë politike.



Lufta kundër korrupsionit në PSH do të japë rezultate (minimizim i korrupsionit):




Së fundi, duket se pjesa dërrmuese e të anketuarve e lidhin suksesin e luftës anti-korrupsion në Policinë e Shtetit me mandatin qeverisës të shumicës aktuale. Siç shihet edhe nga Grafiku 21, rreth 17% e të anketuarve presin të shohin rezultate konkrete në luftën antikorrupsion brenda vitit, 35% besojnë se kjo do të ndodhë në dy vitet e ardhshme dhe rreth 17%, brenda vitit 2017. Shih Grafiku 21.

### 12.2.9. Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe të politikave antikorrupsion

Më shumë se gjysma e të anketuarve deklarojnë se e njohin “shumë mirë” (54%) ose “relativisht mirë” (46%) kuadrin ligjor dhe të politikave antikorrupsion për PSH. 31% kanë pak njohuri dhe 8% nuk e njohin.


Të anketuarit në përgjigjet e tyre bëjnë një diferencë të lehtë mes përshtatshmërisë (ose jo) të kuadrit ligjor dhe të politikave në fuqi për të “hetuar korrupsionin në PSH” dhe atij për “parandalimin”. Siç shihet edhe nga Grafiku 22. Ka më shumë të anketuar të cilët mendojnë se ky kuadër është “shumë pak ose aspak” i përshtatshëm për hetimin e korrupsionit në Polici (26%) krahasuar me kuadrin ligjor/politikave për “parandalimin” (12%). Gjithashtu janë 6% deri në 7% më pak të anketuar që e shohin si “plotësisht” apo “deri diku” të përshtatshëm për hetimin krahasuar me kuadrin për parandalimin.

Sa i përshtatshëm është kuadri ligjor/politikave?



Këto diferenca thuhetse zhduken plotësisht kur të anketuarit pyeten lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor/politikave për hetimin dhe atij për parandalimin e korrupsionit në Policinë e Shtetit. Shih Grafiku më poshtë.

Zbatimi i kuadrit ligjor/politikave antikorrupsion në PSH për...




Siç shihet nga Grafiku i mësipërm, më shumë se gjysma e të anketuarve shprehen se këto korniza ligjore dhe politikash zbatohet deri diku ndërkohë që diferenca

mes atyre që deklarojnë “pak ose aspak” dhe të anketuarve që shprehen se “zbatohen plotësisht” është rreth 5% në favor të këtyre të fundit.

Në një shkallë nga “1-aspak të efektshme” në “5-shumë të efektshme” të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë SHKB, Inspektimet dhe Auditin e brendshëm:

*Pyetje: Sipas mendimit tuaj, sa të efektshme janë institucionet e mëposhtme për të hetuar korrupsionin në polici?*



Shërbimi i Kontrollit të brendshëm vlerësohet më shumë i efektshëm (4) nga të anketuarit ndërkohë që Auditin e brendshëm (3.5) dhe Inspektimi (3.6) vlerësohen në nivele të përafërta (devijim standard=1).

Pyetja vijuese e sondazhit synon të identifikojë vlerësimet e të anketuarve lidhur me efektshmërinë e masave konkrete në luftën antikorrupsion në PSH. Shih Grafiku 24.

*Pyetje: Sa të efektshme janë masat e mëposhtme në luftën kundër korrupsionit në Policinë e shtetit? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-aspak te efektshme dhe 5-shumë të efektshme.*

Përmirësimi i “kushteve të punës”, “pagave” dhe i “shkollimit/trajnimit” vlerësohen si masat më të efektshme në luftën kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit. Të anketuarit shprehen disi më skeptikë lidhur me efektshmërinë e masave si:

- Zëvendësimi i drejtuesve të PSH

- Kontroll më i mirë nga Parlamenti


Efektshmëria e masave të tjera vlerësohet relativisht lart (mbi 4) nga oficerët e policisë të intervistuar.

## 12.3. SHTOJCA 3 - Analizë krahasimore e gjetjeve të anketimit me publikun dhe punonjës të PSH

### 12.3.1. Perceptimi mbi korrupsionin dhe organizatat policore


Qytetarët dhe punonjësit e policisë të anketuar kanë të njëjtën përgjigje për organizatën/strukturën më të korruptuar policore sot dhe ajo është Policia Rrugore. Por ata nuk ndajnë të njëjtin opinion për strukturat policore që pasojnë renditjen. Kështu, sipas publikut, pjesë e tre strukturave më të korruptuara policore përveç policisë rrugore janë edhe Rendi dhe PSH në përgjithësi. Ndërkohë, punonjësit e PSH pas Rrugores rendisin Policinë (administratën) Tatimore dhe Policinë e kufirit dhe migracionit. Shih Grafiku me poshte.

Publiku vs. Policia - Më shumë e korruptuar...




Perceptimi i publikut duket se nuk përputhet me atë të punonjësve të PSH lidhur me tre strukturat më pak të korruptuara. Siç vërehet nga Grafiku me poshtë.

Publiku vs. Policia - Më pak e korruptuar...




Për publikun ato janë Policia private, Sektori Antikrimit i PSH dhe Policia bashki-ake/komunale. Nga ana tjetër, të anketuarit nga radhët e PSH mendojnë se Rendi është struktura më pak e korruptuar, ndjekur nga PSH në përgjithësi dhe në vendin e tretë Antikrimi ndan pozicionin me Policinë e kufirit dhe migracionit. Kjo e fundit, tek figura e mësipërme rezulton të jetë struktura e tretë policore më pak e korruptuar.

Publiku vs. Policia - Dëgjoj për korrupsionin në PSH...




Ka diferenca të perceptueshme mes dy kategorive të anketuara lidhur me pyetjen sa shpesh dëgjojnë për korrupsionin në Policinë e Shtetit në përgjithësi. Përkundër më shumë të anketuarve nga radhët e policisë që dëgjojnë “rrallë ose asnjëherë” për këtë fenomen (44% kundrejt 36% nga publiku), më shumë qytetarë të anketuar shprehen se dëgjojnë shpesh ose thujtse gjithmonë (60% qytetarë kundrejt 49% oficerë policie). Grafiku me lart.




Ndryshe nga të anketuarit në Policinë e Shtetit, qytetarët e intervistuar në shumicë dërrmuese konfirmojnë se “besojnë se ka oficerë policie të korrumpuar”. Kjo përqindje është në nivelin e 58% tek të anketuarit oficerë të PSH. Grafiku ne krah.

Mungesa e dakordësisë mes opinionëve të të dy kategorive të anketuara thellohet lidhur me pyetjen se sa i përhapur është korrupsioni në Policinë e Shtetit. Siç tregohet nga Grafiku 5. rreth 51% e publikut mendojnë se është “serioz ose i përhapur konsiderueshëm”. Vetëm 12.3% e të anketuarve nga radhët e PSH ndajnë të njëjtin qëndrim. Shih Grafiku me poshte.

### Sa i përhapur është korrupsioni në PSH




### Shkalla e korrupsionit sipas rangut (1-nuk ekziston); 5- shume I perhapur)




Diferencat në vlerësimin që japin të anketuarit janë të dukshme, por nga ana tjetër analiza krahasimore fokusohet tek tendenca që shfaqin të dy kategoritë (publiku dhe Policia e Shtetit). Kështu, sipas qytetarëve korrupsioni është më shumë i përhapur tek niveli bazë i oficerëve të PSH në komisariate ndërsa sipas oficerëve të PSH të intervistuar është tek Drejtuesit e Drejtorive të PSH në qarqe. Gjithashtu, publiku mendon se niveli i lartë drejtues në Drejtorinë e përgjithshme të PSH është rangi ku korrupsioni është më pak i përhapur, ndërkohë që sipas oficerëve të policisë më pak i përhapur është tek niveli i mesëm drejtues në komisariate. Shih Grafiku me sipër.

### Shkalla e korrupsionit sipas strukturave: (1-nuk ekziston; 5-shumë i përhapur)




Policia rrugore, Antidroga dhe Antikrimi financiar janë tre strukturat policore tek të cilat korrupsioni është më shumë i përhapur sipas publikut. Thuajse të njëjtin mendim ndajnë edhe të anketuarit nga radhët e policisë, me përjashtim të vendit të tretë, të cilin e zë Policia kufitare dhe e migracionit, ndërsa Antidroga është në vend të katërt. SHKB, Rendi dhe Administrata janë tre strukturat ku korrupsioni është më pak i përhapur sipas qytetarëve. Sërish, thuajse e njëjta renditje vlen edhe për oficerët e PSH të intervistuar, me përjashtim të SHKB e cila renditet e katërta ndërsa Sektori i Krimeve të rënda futet në vend të tij tek tre strukturat më pak të korruptuara. Shih Grafiku me lart.

Plotësisht/Dakort: Publiku mbi 50% vs. Policia



Të anketuarit nga radhët e PSH janë relativisht dakord me një pjesë të pohimeve për të cilat shumica e publikut janë dakord. I vetmi përjashtim është deklarata se “Oficerët Meshkuj janë më të korruptuar sesa oficerët femra”. Ndryshe nga 68% e publikut, vetëm 25% e oficerëve të policisë janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim. Shih Grafiku me lart.

Plotësisht/Dakort: Policia mbi 50% vs. publiku






Nga ana tjetër, të vetmet deklaratat për të cilat Policia dhe publiku shprehen “plotësisht/dakord” në shumicë paraqiten tek Grafiku me lart.


Lidhur me gjashtë pohimet e tjera për të cilat është kërkuar vlerësimi i të anketuarve nga publiku dhe nga radhët e PSH, të anketuarit qëndrojnë në pozicione të kundërta. Më konkretisht, oficerët e policisë të intervistuar shprehen në një masë të madhe “aspak dakord” ose “kryesisht jo dakord” lidhur me to. Qytetarët e intervistuar nga ana tjetër shfaqin përqindje më të ulëta të këtyre vlerësimeve lidhur me të gjitha pohimet përveç deklaratës se “Oficerët e policisë janë të korruptuar që para se të hyjnë në radhët e PSH”. Shih Grafiku me poshte.

Aspak dakord/kryesisht jo dakord: Policia mbi 50% vs. Publiku




### 12.3.2. Përvojat mbi korrupsionin

Analiza krahasimore e përgjigjeve të publikut dhe të oficerëve të PSH në seksionin e “Përvojave mbi korrupsionin” nxjerr në pah gjetje interesante të cilat konfirmojnë jo vetëm fenomenin por edhe shtrirjen dhe thellësinë e tij. Grafiku e mëposhtme paraqet përqindjet e qytetarëve të cilët deklarojnë se u është kërkuar rryshfet nga policia e shtetit dhe atyre të policisë të cilët konfirmojnë se gjatë 12 muajve të fundit u është ofruar ose kanë parë të paktën një here kolegët e tyre duke kërkuar rryshfet nga qytetari në këmbim të mos-ndëshkimit. Shih Grafiku me poshte.




Rreth 1/3 e qytetarëve të intervistuar deklarojnë se kanë paguar rryshfet Policisë së Shtetit. Në mënyrë që të identifikohet perspektiva e Policisë së Shtetit lidhur me këtë përvojë, sondazhi i ky pyetur oficerët e policisë nëse ata kanë parë gjatë 12 muajve të fundit ndonjë oficer policie duke marrë rryshfet. 13% e tyre konfirmojnë se ata kanë dëshmuar të paktën një here një situatë të tillë. Shih Grafiku me poshte.



Rastet e denoncimit të korrupsionit mbeten në nivele të ulëta sipas asaj çfarë raportohet nga të dy palët, publiku dhe oficerët e policisë së shtetit të intervistuar nga sondazhet. Më konkretisht, vetëm 5% e qytetarëve konfirmojnë se kanë denoncuar të paktën një here një oficer policie për korrupsion. Nga ana tjetër, oficerët e policisë të intervistuar konfirmojnë më shpesh raste kur ata kanë denoncuar qytetarë në tentative korrupsioni (25%) të paktën një here gjatë 12 muajve të fundit. Por, kjo përqindje bie në nivele mjaft të ulëta në rastet e “denoncimit Brenda Policisë së Shtetit”. Kështu, vetëm 5% deklarojnë se kanë denoncuar eprorin dhe vetëm 8% se kanë denoncuar një oficer policie (jo epror). Shih Grafiku me poshte.

### Është denoncuar korrupsioni




### 12.3.3. Llojet e korrupsionit në PSH – Ryshfeti

Analiza krahasimore fokusohet më tej tek dallimet mes publikut dhe oficerëve të policisë lidhur me ryshfetin si akt korrupsioni. Më konkretisht të anketuarit janë pyetur sa shpesh ndodh ky fenomen në PSH. Grafiku i mëposhtëm paraqet pikërisht këto dallime tek opsionet që marrin përqindje më të lartë tek të dy kategoritë. Shih Grafiku me poshte.

Ndërkohë që 63% e publikun mendon se ryshfeti në PSH ndodh shpesh ose shumë shpesh, ky vlerësim ndahet vetëm nga 8% e oficerëve të PSH. Këta të fundit në shumicë (41%) shprehen se ryshfeti në PSH nuk ndodh thujt asnjëherë, përkundrazi 5% të qytetarëve që kanë të njëjtin mendim.


## Shpeshësia e rryshfetit: Policia vs. Publiku



## 12.3.4. Shkaqet e jashtme &amp; të brendshme të korrupsionit


Dy institucionet (jashtë PSH) tek të cilat korrupsioni është më shumë i përhapur sipas të dy kategorive të anketuara janë gjykatat dhe prokuroria. Shih Grafiku me poshte.

## Publiku vs. Policia - Korrupsioni "shumë/i përhapur" tek...




Të anketuarit nga radhët e Policisë së Shtetit kanë tendencën të jenë më kategorikë dhe përzgjedhin në masë të madhe vlerësimin “aspak i përhapur” tek një pjesë e mirë e institucioneve (jashtë PSH) për të cilat pyeten. Kjo prirje nuk vërehet tek qytetarët e anketuar. Figura 16 paraqet këtë diferencë mes dy kategorive të anketuara sidomos kur bëhet fjalë për institucione të ekzekutivit. Shih Grafiku me poshte.

Policia vs. Publiku - Korrupsioni "Aspak i përhapur" tek



Ndërkombëtarët janë një ndër tre institucionet të cilat kanë qenë më të efektshme në luftën kundër korrupsionit në PSH sipas të dy kategorive të anketuara. Dallimi mes publikut dhe Policisë së Shtetit dhe njëherësh, e përbashkëta, qëndron tek dy (nga tre) institucionet e tjera.


Tre institucionet më të efektshme në luftën antikorruption në PSH sipas:



Të dy kategoritë rendisin si pjesë e këtij grupimi (tre më të efektshmet) institucione që mund të konsiderohen si “struktura pranë tyre” – sipas Policisë ato janë PSH dhe Ministria e brendshme dhe sipas publikut, Media dhe shoqëria civile. Shih Grafiku me lart.

Lidhur me shkaqet e brendshme të korrupsionit në Policinë e Shtetit, të anketuarit e të dy kategorive (publiku dhe PSH) bien dakord në mjaft aspekte por gjithashtu shfaqin edhe dallime. Ty pyetur lidhur me ndikimin që kanë disa faktorë të brendshëm tek shkalla e korrupsionit në Polici, oficerët e PSH të intervistuar kanë prirjen të përzgjedhin në një masë të konsiderueshme vlerësimin “shumë ndikim”. Grafiku 18 paraqet grafikisht përqindjet që merr ky vlerësim tek publiku dhe policia. Shih Grafiku 18.


"Shumë ndikim" tek shkalla e korrupsionit në PSH



### 12.3.5. Toleranca ndaj korrupsionit & besimi në luftën antikorruption

Të dy kategoritë përgjithësisht i konsiderojnë akte korrupsioni disa veprime të caktuara të oficerëve të policisë së shtetit për të cilat janë pyetur nga sondazhi. Dallimet mes tyre vërehen tek përqindja e të anketuarve të cilët shprehen se “nuk janë akte korrupsioni” veprime si manipulimi i provave apo favori. Konkretisht, oficerët e policisë të anketuar duket se shfaqin një shkallë më të lartë tolerance ndaj këtyre akteve sesa publiku. Grafiku me poshte paraqet grafikisht përgjigjet “nuk konsiderohet akt korrupsioni” tek të dy kategoritë – publiku dhe policia.


Nuk konsiderohet akt korrupsioni kur oficeri i PSH




Dallimet thellohen kur të anketuarit pyeten nëse “policia është e aftë të luftojë korrupsionin Brenda vetes” dhe “nëse korrupsioni në PSH mund të zvogëlohet”. Oficerët e policisë të intervistuar janë më shumë optimistë sesa publiku për të dy pyetjet. Grafiku me poshte.

Ndonëse me dallime të dukshme në përqindje, “Kryeministri” dhe “Ministri i brendshëm” janë dy institucionet (drejtues institucionesh) për të cilët të dy kategoritë konfirmojnë se kanë më “shumë besim” se do të luftojnë korrupsionin Brenda PSH. Institucioni i tretë me nivelin më të lartë të përgjigjeve “shumë besim” është “Media” sipas publikut dhe “Drejtori i përgjithshëm i PSH” sipas të anketuarve nga policia e shtetit. Shih Grafiku me poshte.

Është "plotësisht e mundur" që...




## "Shumë besim" se do luftojnë korrupsionin në PSH



Nga ana tjetër, ekziston konsensus i plotë madje, deri diku i shprehur edhe tek niveli i përqindjeve, sa i përket institucioneve të cilat nuk gëzojnë “aspak besim” tek të dy kategoritë se do të luftojnë korrupsionin në Policinë e Shtetit. Siç shihet edhe nga Grafiku me poshte, këto institucione janë partitë politike, gjyqësori dhe prokuroria.


## "Aspak besim" se do luftojnë korrupsionin në PSH





Së fundi, të anketuarit nga radhët e policisë së shtetit kanë tendencën të lidhin pritshmëritë kohore për rezultatet konkrete në luftën antikorrupsion (minimizimi i korrupsionit) në PSH me mandatin qeverisës të shumicës aktuale. Kështu, 70% e tyre zgjedhin një prej opsioneve “deri në vitin 2017” si kohën kur këto rezultate pritet të bëhen të prekshme. Kjo përqindje nga ana tjetër është në nivelin e 45% tek qytetarët e intervistuar. Shih Grafiku me poshte.


Lufta antikorrupsion në PSH do të japë rezultate



### 12.3.6. Përshtatshmëria dhe zbatueshmëria e kuadrit ligjor/politikave antikorrupsion


Publiku shfaqet përgjithësisht më i rezervuar në gjykimin e tij mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor dhe të politikave për hetimin dhe parandalimin e korrupsionit. **Grafiku 24.** paraqet grafikisht diferencat mes publikut dhe oficerëve të policisë së shtetit të intervistuar nga sondazhi në lidhje me përshtatshmërinë e këtij kuadri për hetimin e korrupsionit. Më konkretisht, janë më shumë të intervistuar nga policia të cilët zgjedhin vlerësimin “deri diku” ose “plotësisht i përshtatshëm” sesa në rastin e sondazhit me qytetarët. Shih grafikun me poshte.

Përshtatshmëria e kuadrit ligjor/politikave për hetimin e korrupsionit në PSH




E njëjta tendencë është e pranishme edhe kur të anketuarit pyeten në lidhje me kuadrin ligjor dhe të politikave për parandalimin e korrupsionit. Shih grafikun me poshte.

Përshtatshmëria e kuadrit ligjor/politikave për parandalimin e korrupsionit në PSH



Dallimet mes dy kategorive thellohen më tej kur bëhet fjalë për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor/politikave për hetimin dhe kuadrit për parandalimin e korrupsionit në policinë e shtetit. Pjesa më e madhe e publikut shprehet se ky kuadër zbatohet pak ose aspak ndërkohë që mbi 70% e oficerëve të policisë të anketuar deklarojnë se zbatohet deri diku ose plotësisht. Një tjetër tendencë që vërehet nga Figura 26 e cila paraqet grafikisht këto rezultate, është fakti se publiku është më shumë skeptik për hetimin ndërkohë që përgjigjet e të anketuarve nga policia e shtetit tregojnë se oficerët e policisë janë më pak pozitivë lidhur me zbatueshmërisë së kuadrit për parandalimin e korrupsioni. Shih grafikun me poshte.



## 12.4. SHTOJCA 4- Pyetësori i anketimit me publikun

### 12.4.1. TË DHËNA DEMOGRAFIKE

#### 1. GJINIA

Mashkull	• 1
Femër	• 2

#### 2. Në cilin rreth banoni?

\_\_\_\_\_

#### 3. Banoni në urbane (qytet) apo rurale (fshat)

Zonë urbane	• 1
Zonë rurale	• 2

#### 4. Ciles grupmoshe i përkisni

18 – 25 vjeç	” 1
26- 35 vjeç	” 2
36 – 45 vjeç	” 3
46 – 55 vjeç	” 4
Mbi 56 vjeç	” 5

#### 5. Cili është niveli me i larte i arsimit që keni kryer?

Arsim i mesëm	” 1
Arsim universitar	” 2
Arsim pas-universitar	” 3
Refuzim	” 99

#### 6. Statusi i punësimit

I/E punësuar	” 1
I/E papunë	” 2

Student	” 3
Pensionist	” 4
Tjetër (Specifiko) _____	” 5
Refuzim	” 99

#### 12.4.2. NJOHJA E ORGANIZATAVE POLICORE

7. Përveç Policisë së Shtetit, sa organizata të tjera policore (Polici) dini se vepronë në Shqipëri?

Edhe një tjetër	” 1
Edhe dy të tjera	” 2
Deri në katër të tjera	” 3
Më shumë se 5 të tjera	” 4
Nuk e di	” 99

8. Përveç Policisë së Shtetit, sa organizata të tjera policore (Polici) dini se vepronë në Shqipëri?

Edhe një tjetër	” 1
Edhe dy të tjera	” 2
Deri në katër të tjera	” 3
Më shumë se 5 të tjera	” 4
Nuk e di	” 99

9. Sipas mendimit tuaj, cila organizate policore (Polici) është më shumë e korruptuar?

\_\_\_\_\_

10. Sipas mendimit tuaj, cila organizate policore (Polici) është më pak e korruptuar?

\_\_\_\_\_

11. Aktualisht, kush është Ministër i Brendshëm?

Damian Gjijnuri	” 1
Flamur Noka	” 2
Pjerin Ndreu	” 3
Saimir Tahiri	” 4

Nuk e di	” 99
----------	------

12. Kush ishte Ministri i Brendshëm i mëparshëm?

Bujar Nishani	” 1
Flamur Noka	” 2
Gent Strazimiri	” 3
Saimir Tahiri	” 4
Nuk e di / Refuzim	” 99

13. Kush është aktualisht Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit?

Ahmet Premçi	” 1
Agron Kuliçi	” 2
Artur Didi	” 3
Hysni Burgaj	” 4
Nuk e di	” 99

14. Kush ishte Drejtori i Përgjithshëm i mëparshëm i Policisë së Shtetit?

Ahmet Premçi	” 1
Agron Kulici	” 2
Artur Didi	” 3
Hysni Burgaj	” 4
Nuk e di	” 99

15. A keni informacion se kush është Drejtori i Policisë së Qarkut ku banoni?

Po	” 1
Jo	” 2

16. A keni informacion se kush është Drejtori i Policisë së Qytetit/Komisariatit ku banoni?

Po	” 1
Jo	” 2

17. A keni informacion se kush është polici i lagjes/fshatit/ zonës suaj?

Po	” 1
Jo	” 2

18. A keni informacion se cili është numri i emergjencës i Policisë së Shtetit?

Po	” 1
Jo	” 2

19. A keni kërkuar ndonjëherë ndihmën e policisë?

Jo asnjëherë	” 1
PO, gjate 3 muajve të fundit	” 2
PO, gjate 6 muajve të fundit	” 3
PO, gjate 12 muajve të fundit	” 4
Nuk e mbaj mend	” 5

### 12.4.3. INFORMIMI MBI KORRUPSIONIN

20. Cilat janë mjetet tuaja kryesore të informimit për zhvillimet e përgjithshme në vend:

TV	” 1
Gazetat	” 2
Interneti	” 3
Radio	” 4
Miqtë / shokët / familja	” 5
Tjetër. Specifikoni _____	” 6

21. A keni dëgjuar të flitet për korrupsionin në Polici?

Thuajse gjithmonë	” 1
Shpesh	” 2
Rrallë	” 3
Asnjëherë	” 4
Refuzim	” 99

22. Nga cili burim dëgjoni më shumë për korrupsionin në polici?

Media (TV, Gazeta, Radio etj.)	” 1
Përvoja personale	” 2
Rrethi shoqëror / familjar	” 3
Tjetër. Specifikoni _____	” 5
Refuzim	” 99

23. Sa shpesh dëgjoni ose ndesheni me informacion për oficerë policie të korrumpuar?

Thuajse gjithmonë	” 1
Shpesh	” 2
Rrallë	” 3
Asnjëherë	” 4
Nuk e di / refuzim	” 99

#### 12.4.4. PERCEPTIMET MBI KORRUPSIONIT

24. A mendoni se ka oficerë të korrumpuar në Policinë e Shtetit?

Po	” 1
Jo	” 2
Nuk e di / refuzim	” 99

25. Në çfarë mase mendoni se korrupsioni është i përhapur në Policinë e Shtetit?

Nuk ekziston	” 1
Pak, raste të izoluara	” 2
Ekziston, por nuk është në nivele serioze	” 3
Eshte i përhapur në një masë të konsiderueshme	” 4
Eshte mjaft i përhapur dhe serioz	” 5
Nuk e di / refuzim	” 99

26. Vlerësoni shkallën e korrupsionit në nivelet e ndryshme të Policisë së Shtetit. Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-nuk ekziston dhe 5-shumë i përhapur.

Nivele drejtimi në Policinë e Shtetit	Shkalla e korrupsionit				
Nivelet e larta drejtuese të “Drejtorisë së përgjithshme të Policisë së Shtetit”	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5
Nivelet e larta drejtuese te “Drejtorive te Policise se Shtetit ne nivel Qarku”	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5
Drejtes te Komisariateve te Policise se Shtetit	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5
Nivelet e mesme drejtuese ne komisariate	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5
Niveli baze i oficerëve Policise se shtetit ne komisariate	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5

27. Vlerësoni shkallën e korrupsionit në struktura të ndryshme të Policisë së



Shtetit. Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-nuk ekziston dhe 5-shumë i përhapur.

Strukturat e Policisë së Shtetit	Shkalla e korrupsionit				
Policia Rrugore	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Spektori kundër narkotikëve dhe trafikeve (Antidroga)	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Policia Kufitare dhe Migracionit	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Spektori për hetimin dhe parandalimin e krimeve	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Spektori për Rendin dhe sigurinë publike (Rendi)	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Spektori kundër krimit financiar	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Spektori kundër krimeve të rënda	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Administrata në drejtoritë e Policisë së qarkut dhe komisaritate	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5

28. Sa dakord bini me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1-aspak dakord dhe 5-plotësisht dakord.

Deklarata	Vlerësimi				
Në radhet e Policisë së Shtetit ka mjaft oficerë policie të pakorruptuar	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Oficerët e policisë janë të korruptuar që para së të hyjnë në radhet e Policisë	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Sa më shumë organizata policore (Policia) në vend aq më i lartë korrupsioni	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Oficerët e vjetër (në moshë) të policisë janë më të korruptuar sesa oficerët e rinj	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Oficerët meshkuj të policisë janë më të korruptuar sesa oficerët femra	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Institucioni i Policisë nuk është i korruptuar, por të korruptuar janë vetëm individë të caktuar brenda tij	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Oficerët e policisë që punojnë në terren janë më të korruptuar se ata që punojnë në zyra	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Oficerët në nivelet e larta të policisë e tolerojnë korrupsionin e vartësve të tyre	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5
Mosveprimi i drejtuesve të Policisë së Shtetit për të luftuar korrupsionin dekurajon oficerët e policisë	" 1	" 2	" 3	" 4	" 5

Shumica e oficerëve të policisë janë të motivuar për zbatimin e ligjit	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5
Shumica e oficerëve të policisë shpesh e përdorin ligjin si mjet presioni mbi qytetarët për qëllime përfitimi	” 1	” 2	” 3	” 4	” 5

### 12.4.5. PËRVOJAT MBI KORRUPSIONIN

29. Hera e fundit që keni pasur kontakt/ndërveprim me ndonjë oficer policie ka qenë:

Gjatë 6 muajve të fundit	” 1
Gjatë 6-12 muajve të fundit	” 2
1 vit më parë ose më herët	” 3
Nuk kam pasur ndonjëherë	” 4
Nuk e di / refuzim	” 99

30. Nëse keni pasur kontakt / ndërveprim, me cilën polici/organizatë policore?  
(Mundet më shumë sesa një opsion)

Policia e Shtetit	” 1
Policia Bashkiake / Komunale	” 2
Tjetër (Specifiko): _____	” 3
Nuk e di / refuzim	” 99

